



STERIO SPASSE

SOKROLESHA

BIBLIOTEKA E MIKUT TË LIBRIT

STERJO SPASSE

SOKOLESHA

(LEGJENDA PËR TË RINJ)

Piktor : DOLLI GJINALI

2327

~~40431~~

BIBLIOTEKA E MIKUT TË LIBRIT
GJURGENE

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

E BUKURA E PRESPËS

PO VOZITNIM brigjeve të liqenit të Prespës bashkë me disa të mësuar, të ardhur dëllëngthi nga Universiteti Shtetëror i Tiranës për të studjuar vlerën e Shpellave-eremite të këtyre anëve. Na magjepste bukuria përrallore e liqenit, por, më fort se çdo gjë tjetër, na magjepsi legjenda, që na tregoi njëri nga ata të mësuarit e Tiranës, duket bir i këtyre vendeve. Sa na doli përpara Shpella-eremite — SHPELLA E ZEZË, pranë Gllomboçit, ai na tërhoqi vëmendjen:

— Pa shikoni, ç'bukuri: natyrë, ç'madhëri arkitekturë! — na tha dhe zgjati dorën përppjetë. Barka u ndal dhe ne ngritëm sytë lart: Mbi dyzet metra lartësi, midis shkëmbinjve të thepisur thikë, ishte ngritur Shpella-eremite. një arkitekturë e çuditëshme, që luftoi me shekuj pa u prishur fare. Nga buza e liqenit gjarpëronte një shkallë, e ndërtuar me dru dëllinje, e kohëve tona, por e ndërtuar me mjeshtëri.

Pasi hipëm një nga një nëpër ato shkallë, e pamë tërë atë ndërtim të vakëfit brenda në atë shpellë shkëmbi, e pasi soditëm tërë atë pamje të madhërishe, të liqenit, që na shtrihej përpara, ne, tërë kërshëri, e rrethuam të mësuarin e Tiranës të na e thoshte legjendën e kësaj Shpelle-eremite. Dhe ai filloi:

...Një natë përsëri u dëgjuan të shtëna pushke nga kulla e beut aty në të dalë të fshatit. Fshatarët u strukën më shumë pranë kllanikëve. Teta Lena e Shushatura, tani e thinjur dhe e drobitur, nga pleqëria e nga vuajtjet, nuk lëvizi fare nga stroma. Por Marisë nuk iu durua: u ngrit, hapi kanatën e dritares dhe hodhi vështrimin nga liqeni: ehe, ehe, në thellësitë e ujërave llamburisnin gjuhëra të zjarrta! Sa bukur! Dallgët perçeshkumë ishin skuqur gjak! Liqeni dukej sikur digjej flakë! Kurrë s'kishte parë një pamje të tillë të çuditëshme, të mrekullishme, tamam si në përralla! Për një copë herë e humbi dhe mbeti mëdysh. Pastaj me kujdes hapi derën dhe zgjati kokën nga fshati: — Ehe, ehe, andej nga kulla e beut ngriheshin në qiell shtëllunga tymi e gjuhëra të zjarrta. «Me siguri ja paskan marrë të keqen beut hangaret dhe plevicat e tij» — mendoi ajo. Por sakaq në vathë dhitë u trembën dhe asaj iu bë sikur dikush, njeri a egërsirë, kërceu brenda. U drodh dhe i vuri llozin derës. Mbajti vesh dhe... përsëri dëgjoi dhitë të tremben duke shkuar nga njëra anë e vathës në tjetrën.

«Me siguri do të jetë ndonjë egërsirë». — mendoi Maria. Por qeni nuk jepte asnjë shenjë. Ndezi pishën, mori sakaturen, hoqi llozin e me të druajtur dolli: Larg gjuhërat e zjarrta dhe shtëllungat e tymit vazhdonin të vallëzonin me dallgët e liqenit e të qiellit, kurse këtej kishte vetëm errësirë, errësirë dhe heshtje varri.

«Me siguri më bënë veshët» — mendoi. Për ndërkaq, pa pandehur, dikush i shoqti pishën dhe një dorë e fortë e shtrëngoi pas krahut. Njëkohësisht dëgjoi një zë të ulët, por urdhëronjës:

«— Mos u tremb! Eja pas meje! —
Për çudi ajo nuk u tremb; si manare e ndje-

llur me thërmiza buke, i vajti pas e u ulën aty në korie. Përsëri dëgjoi zërin e pakët, por urdhëronjës të të panjohurit:

«— Mos u tremb! S'jam njeri i lig. A ke njerëz të tjerë në shtëpi? Jam i plagosur. —

«— Aaa!» — klithi ajo e llahtaritur.

«— Mos, mos! Nuk jam njeri i lig! — përsëriti ai, kësaj here si me të lutur. — Jam i plagosur dhe duhet të ndërroj plagën.

Asaj iu dhimbs ky i panjohur: e kapi përdore dhe e tërhoqi pas vetes. E futi në shtëpi dhe mbylli derën me lloz. Ndezi pishën në prushin e vatrës dhe atëhere pa përpara saj një burrë shtatmadh e shpatull gjerë, me mustaqe gjer te veshi, me mjekër krela-krela, me gunë krahëve, me dogra shtrënguar në dorë, me kobure e me kamë ngulur në siljah e me një jatagan të madh, që i varej në brez. Për çudi kësaj here, jo vetëm që nuk u tremb, por mori zemër e sesi i erdhi kur pa një trim të tillë, si ai i përrallave, që luftonte me kuçedrën. Pa dashur ja bëri tërë ngashërim:

— Ti na qënke si hajduti i tmershëm Shkamb Sokoli!

Ai buzëqeshi, por në atë hie — dritë të rënduar, ajo nuk e vuri re. Veçse u kujtua se ai i pat thënë që ishte plagosur.

Teta Lena e Shushatura, sa dëgjoi zërin e burrit të panjohur, u ngrit me përtesë:

— Ç'është kështu, moj Marie?

— Ssst! — ja bëri e bija, duke vënë gishtin në buzë. — Është një trim i plagosur.

— I plagosur?! Po pse më rri ashtu e shushatur. Ja aty në atë sèpeten e vogël ke një këmishë; grise e lidhja plagën — e urdhëroi plaka.

Në atë dritë — hie të pishës shquhej gjithmonë më qartë buzëqeshja e dhimsur e të panjohurit.

E ulën në buxhak, ja ndezën zjarrin dhe në llamburimën e flakëve, u duk fytyra e tij e zbetë, sytë e zes balli i gjërë, mustaqet gjer te veshi edhe mjekrëza katran e zezë mbirë nëpër faqet. Maries përsëri iu duk madhështor, i pashëm, trim përmbi trim, tamam si ai i përrallave.

— Ti qënke vërtet si hajduti i tmershëm Shkëmb Sokoli! — përsëriti ajo e habitur.

— A e ke parë ti hajdutin Shkëmb Sokoli? — pyeti ai duke treguar një sërë dhëmbësh si fildishi.

— Jo, po ashtu thonë. Këtej nga fshati ynë rralle ka ardhur ai. Pastaj në këtë kasollen tonë s'ka asnjë punë. As para kemi, as mall, as... Ai u bie në qafë afendikonjve e agallarëve, se ne, fukarenjtë, veç morrave, s'kemi ç't'i japim! — Buzëqeshi vajza dhe vazhdoi t'i lidhte plagën sipas këshillave të s'ëmës.

«— Ha-ha-ha! — qeshi i plagosuri i panjohur.

«— Mos qesh! Kështu është! — ja preu ajo shkurt. — Më shikon mua? Çfarë do të marrë prej meje, veç këtyre leckave, që kam veshur.

«— Më jep pak ujë! — iu lut ai.

«— Jo, jo! Ujë mos pi, bir i nënës! Kështu na thoshte nëna, ndjesë pastë: Të plagosurit mos i jepni ujë! — ndërhyri plaka e thyer si drapër. — Duro dhe ça, sa të të pushojë gjaku. —

Fytyra e të panjohurit u zbe akoma, dhe, ashtu si ishte, me fjalën përgjysmë, ra në stromë pa ndjenja.

* * *

Kur u gdhi, në fshat u përhap fjala, dhe kjo fjalë arriti gjer te veshi i çobankës sonë, — se atë

tmeruan, por i plagosuri i panjohur vetëm buzëqeshi pa lëvizur nga vëndi.

«— Gati je? — e pyetën ata.

«— Po, gati jam! — u përgjegj ai dhe tinës i hodhi një vështrim plot kuptim Marisë. —

Sa çel e mbyll sytë, ai u gjënd në këmbë me gunën në krahë, me dogranë në dorë, me kobure e me kamë në silah, me jatagan në brez!

Marinë sikur e kafshoi diçka në kraharor, kurse teta Lena ja bëri:

«— Oi, oi, po ku na le neve?! —

I plagosuri u përul, i mori dorën, ja afroi në buzë dhe ja puthi:

«— Teta Lena, falem nderit shumë. Këtë të mirë nuk do të ta harroj kurrë, kurrë! Ti më shpëtove jetën.

«— O bir, të pastë nëna! Po na e shëmton shtëpinë! — belbëzoi ajo me lot në sy.

I panjohuri i plagosur iu kthye Marisë:

«— Të falem nderit me gjithë zemër, Mari. T'u bëftë krah hajduti Shkëmb Sokoli, — i tha dhe i shtrëngoi dorën fort e fort si të donte t'ja këpuste e ta merrte me vehte.

«— Udha e mbarë! Udha e mbarë! — ... — munda të pëshpërisë ajo duke mbajtur me zor nga shërimin dhe iu duk sikur iu shkëput diçka nga kraharori. —

Vanë e shkuan edhe të katër burrat me gunë e me dogra hedhur krahëve në atë errësirë pus.

«— Oi, oi, po ku na le neve, mor bir! — u dëgjua përsëri ofshama e mbytur e teta Lenës.

* * *

Një muaj e gjysmë më vonë në atë vetëmi e varfëri të tmershme një mesnatë dikush trokiti të

dera e kasolles. Të ndrojtura e me pishë në dorë
ëmë e bijë hapën derën: U dolli përpara një burrë
me gunë, me një mushkë ngarkuar. Nuk e kuptuan
në kishte mjekër apo jo, se edhe fytyrën e kishte
pështjellë me një vinarkë.

— Mos banon këtu teta Lena? — pyeti ai.

Kur u sigurua se plaka ishte vetë teta Lena
me të bijën, shkarkoi mushkën dhe u tha:

«— Kini të fala nga hajduti i tmershëm Shkëmb
Sokoli. Këto jua dërgon dhuratë. Në këto hejbe
është paja e Marisë. Ditën e Shënpetrit hajduti
Shkëmb Sokoli me çetën e vet do të zbresë në fshat.
Do të mblidhen gjithë fshatarët. Më porositi të
zbrisni edhe ju në shesh të fshatit të veshura me
rrobat, që ju dërgon. —

Kaq tha i panjohuri me gunë e me dogra dhe
u bë erë me gjithë mushkë.

Të dy gratë shtangën një copë herë. Ku e dinte
hajduti i tmershëm shtëpinë e tyre? Emrat e tyre?
Hallin e tyre? Fët u shkoi mëndja te ai i panjohuri
me gunë e me dogra, të cilin e patën mbajtur tri
javë të tëra fshehur në shtëpi duke e mjekuar, e
që u thoshte se quhej Gjini, vetëm Gjini. Mos vallë
ky Gjini t'ja kishte qarë hallin hajdutit të tmershëm
Shkëmb Sokolit e ky, për mëshirë, si gjithë vaj-
zave të tjera të varfëra, po i dërgonte dhe Marisë
fajën e martesës? Po pse t'u besonte hajduti i tmer-
shëm e t'i lajmëronte që tani të bëheshin gati për të
marrë pjesë në sheshin e Manave, nisur e stolisur
me plaçkat e dhuruara? Si ishte e mundur që hajduti,
i cili tmeronte bejlerët, agallarët, afendikonjtë dhe
nizamët, të mendonte për këto dy varfanjake të për-
buzura? Marisë, sidomos Marisë çdo gjë i duk, si
ëndër: i dukej e pabesueshme që të kishte qëndruar
tri javë fshehur në shtëpi të saj ai trimi guzëdhirtë

e me dogra e ajo t'i kishte shërbyer e ndruar plagët; i dukej e pabesueshme që të dy ata — ai dhe ajo — të kishin gudulisur njeri tjetrin duke kryqëzuar vështrimet e tyre, dhe me atë psherëtimën e tij të këndëshme e të dhimbëshme: Mari! Mari! Mari!

Ëndër i dukej edhe kjo dhuratë e zbritur nga qielli. I shpunë të dy thasët në shtëpi. E çfarë nuk kishte aty! Miell, sheqer, oriz, kripë, sapun, sa për të jetuar të dyja një vit të tërë. Hapi hejbetë dhe mbeti e habitur: nxori prej tyre një palë rroba nusërie tërë hoja e qendisma. Rroba të tilla s'kishte as e bija e afendikoit të fshatit, të Ogurziut. Uuu, pa shih, pa shih: edhe futë prej kadifeje me push të kuq, edhe grykore prej atlasit ngjyrë qielli; edhe brez prej sërimi me toka floriri; edhe vëthë me sumbulla të kuqe, që shkëlqenin si flakë. Pupu, edhe gjerdhan prej tri rrathë mahmudiesh! Oi, oi, oi! Një pasuri përrallore, që me siguri nuk do ta kishte as e bija e Pashajt të Ohrit, as e bija e valiut.

Tërë atë javë nuk e zuri gjumi fare: ëndëronte ditët, që kishte kaluar duke mjekuar të plagosurin e panjohur me gunë e dogra; ëndëronte edhe takimin, që duhej të bënte me hajdutin e tmershëm Shkëmb Sokoli. Dhe ja, ajo e diel mbrëma erdhi:

«— Si të bëjmë, nëno?»

«— Si të bëjmë, bijëzo? — pyetën me dyshim njëra tjetrën. —

Aty nga Sheshi i Manave filluan të dëgjohen gajde, gërneta e timpane.

«— Kanë zbritur, nëno!»

«— Kanë zbritur, bijëzo! — përsëri i pëshpëritën njëra tjetrës.

Në këtë kohë një e trokitur u dëgjua në derë; dy, tri të trokitura dhe një zë i fortë:

«— Shpejt, shpejt vishuni dhe dilni te Sheshi

i Manave. Atje ju pret hajduti i tmershëm Shkëmb Sokoli.

Pastaj heshtje.

«— Vishu, bijëzo, të shkojmë!

«— Po vishem, nëno! Vishu edhe ti.

Të ndrojtura, me hap të ngadalshëm; me kokë ulur të dy gratë vajtën në Shesh të Manave. Atje s'kishe ku të hidhje mollën; gra e burra, pleq e të rinj, edhe fëmijë, si të ishte dasmë, si të ishin Pashkët! Nënë e bijë, pa rënë në sy, u strukën prapa dy plakave. Maria me habi pa në anën e burrave disa vetë me guna krahëve; me dogra në duar, me mustaqe e me mjekra. Midis tyre dalloi një fytyrë të njohur, tamam si të atij që e kishin mbajtur tri javë në shtëpi. Ishte e mundur?! Po kush ishte hajduti i tmershëm Shkëmb Sokoli? Me siguri ai më i moçmi, me atë mjekër të bardhë gjer në brez e me ato mustaqe si dy shtëllunga lesh rudeje.

Por ai i njohuri, Gjini, u veçua nga burrat, doli pak përpara e foli me zë të lartë:

«— Vëllezër, motra! Beut ja dogjëm hangaret e plevicat, ja përzumë qahjallarët! Po të guxojnë të vijnë edhe një herë, ja, kjo i pret! — dhe ngriti lart jataganin. — Ju tani të filloni të korrni e të shini dhe drithin ta hidhni në hambaret tuaja pa frikë! —

Fshatarët hoqën kapat dhe i tundën në ajr; gravet iu çel fytyra; vajzat hoqën lahuritë dhe i derdhën gërshetat supeve.

«— Ai është!

«— Ai! — pëshpëritën ëmë e bijë.

«— Po cili se?

«— Tani u bini gajdave, u bini gërnetave! Ta festojmë këtë fitore, — u dëgjua përsëri zëri i fortë i atij njeriu me gunë të dhirtë e me jatagan në

dorë. Duke iu drejtuar afendikoit të fshatit, Ogurziut, shtoi: — Gostiti të gjithë këta me nga një pllloskë verë. I paguaj unë!

Vera filloi të derdhet si uji në gërmazin e etuar të fshatarëve; hareja filloi të zotërojë mbi heshtjen e mbi llahtarinë.

Gërnetë, gajde, valle!

«— Hidhni valle, o të çliruar nga Xhavit beu! Mbaroi Xhavit beu! — thirri ai përsëri, por kësaj here vështronte nga gratë, sikur kërkonte dikë. Hajdutët filluan vallen hajduçe me jataganë zveshur; pastaj filloi devollicja me ritme, herë të ngadalëshme herë të shpejta, herë fluturimthi. Oho! Oho!

Vera vazhdonte të derdhej, fshatarët po merrnin vehten: filloi t'u këndojë zemra, filluan të hidhen e të dridhen; filloi pastaj ajo vallja e madhe e pertritëve, ku u përziën fshatarë e hajdutë, gra e burra, sipas zakonit të vjetër të Shëngjergjit. Kjo përzjerje zhduku çdo frikë e çdo druajtje.

«— Ai është!

«— Ai! — pëshpëritën kushedi për të satën herë ëmë e bijë dhe Marisë tëk tëk i hidhej zemra në kraharor si një zog, që kërkonte të fluturonte.

Ndërsa po soditnin këtë gëzim të fshatarëve e të hajdutëve, gratë vunë re se ai më azgani, që pat folur e që pat paguar verën, u shkëput nga vallja dhe me jatagan në dorë u drejtua nga grumbulli i grave, që shihnin të shushatura. Sa u afrua ai, ato lëvizën e u tundën si një dallgë në furtunë.

«— E zuri vera! Do të bëjë ndonjë të pabërë! — klithën ato dhe u shtytën praptas. Në radhë të parë duallën ëmë e bijë, të cilat s'kishin lëvizur fare nga vendi. Për çudi të të gjithëve, fshatarët panë se si hajduti i tërbuar u bë qingj: u përul përpara

plakës e i puthi dorën, u përul përpara vajzës dhe i shtrëngoi dorën.

«— Jam hajduti i tmershëm Shkëmb Sokoli — u paraqit.

Ëmë e bijë shtangën nga habia.

«— O biro! — klithi ajo dhe e përqafoi.

«— O Gjin! — psherëtimi me ngashërim Maria dhe u pështet në krahërorin e tij, që të mos rrëzohej.

Fshatarët, që s'e patën vënë re ardhjen e plakës, tani shtangën në vend, kur panë të përqafohej e të puthej me të hajduti i tmershëm Shkëmb Sokoli. Ç'i kishte ai? Ku i pat njohur ai, teta Lenën e shushatur dhe atë çobankën e lënur, Marinë?

«— E Bukura Sykaltra ime! — i pëshpëriti ai. — Sonte këtu do të shpallim fejesën tonë. A pranon?

Asaj faqet iu bënë gjak, sytë iu ndezën tërë hare, kraharori zuri t'i hidhej bam - bam, më shumë se timpanet aty përballë.

«— Je vajza më e bukur në të parë e në shpirt! Je e Bukura Sykaltra e Prespës! — i mëshoi ai zërit dhe e shtrëngoi për dore. Pastaj e tërhoqi mu në mes të Sheshit të Manave.

«— Dëgjoni! E Bukura Sykaltra e Prespës po bëhet e fejuara ime! Nusja ime! Prandaj pini, këndon, hiqni valle! — thirri hajduti i tmershëm Shkëmb Sokoli dhe i pari, me të fejuarën e vet, nisi vallen famëmadhe të petritëve të Shëngjergjit: një burrë e një grua, një djalë e një vajzë, hopa; hopa, e disa — hiassasan!

U mahnit i madh e i vogël.

Ooo, ajo që më rrinte kurdoherë e veshur në lecka e me kërrabë në dorë, na qënka bërë tani... lere mos e nga: perri e shkuar përrisë! Mirë kishte thënë hajduti i tmershëm; ishte tamam vetë e Bukura Sy-

kaltra e Prespës: kindat e shumta të këmishës me xixinat e arta e me kllapodanin i bënin fësh - fësh, nën grykoren prej atllazi ngjyrë qielli i hidhej kraharori; në qafë i llamburitnin tri sërë mahmudish, mollëzat e faqeve i kishte prush të ndezura; ndërsa me sytë e saj të mëdhej ngjyrë qielli përkëdhelte tërë gëzim e hir hajdutin e tmershëm, që mbante ison e valles.

Nga na dolli kjo perri?

«— Ku ishte fshehur kjo bukuri, që të le pa mend e ne të mos e dinim fare? Është e mundur të jetë Maria, baresha e leckosur? Apo mos është ndonjë shtojzavalle zbritur nga pyjet ose dalë nga thellë-sirat e ujërave të liqenit, ndonjë perri e vërtetë e brigjeve të shkëmbenjve? — Të gjithë fshatarët, sidomos të rinjtë, këto pyetje bënin.

Mirëpo gjithë tiparet ishin të bareshës së varfër e të përbuzur, të asaj bareshe, që s'kishte zbritur kurrë në Shesh të Manave, ose, në kishte zbritur, ishte strukur e tulatur më ndonjë qoshe, që të mos binte në sy me mjerimin e saj; kurse tani? Tani ishte më e bukura perri e Prespës dhe e fejuara e hajdutit të tmershëm Shkëmb Sokolit!

Gjer natën vonë vazhdoi gëzimi në Shesh të Manave. Pastaj fshatarët u shpërndanë me një gëzim të pandjerë e me një habi të paparë kurrë: së pari beu me qehajallarët ishin shporrur dhe ata mund të fillonin të korrnin e të shinin lirisht për vete; së dyti ajo baresha jetime dhe e përbuzur na u bë nusja e Shkëmb Sokolit, hajdutit më të tmershëm, që kishte parë ato vende!

* * *

Fshatarët u turrën si të zijosur nëpër arat dhe filluan të korrat: korr e bart duaj, shi e hidh vrahun dhe, për herë të parë në jetën e tyre, i mbushën hambarët plot me drithë. U gjallërua fshati, u shtuan shpresat, hyri gëzimi në çdo shtëpi e në çdo kaso-
lle.

«— Kemi krahë hajdutin e tmershëm Shkëmb Sokoli!

«— Krimbi i hëngërt bejlerët e qehajallarët.

Uronin e mallëkonin fshatarët në zhegun e vapës, duke korrur nëpër ara ose duke shirë nëpër lëmenj. Vetëm afendikoi, Ogurziu, që mbante qilarët plot me fuçi me verë, me zamzane me raki e me thasë me sheqer e oriz, kripë e sapun për tregëti, i pëshpëriste njerit e tjetrit:

«— More, po mos dëgjoni ç'thotë hajduti! Zoti ka thënë beu të jetë bej, e rajeja raje! Mos ngrini dorë kundra beut, kundra Dovletit, se do t'ju zërë buka! —

Por fshatarët vazhduan punën e tyre në arat e tyre, në lëmenjtë e tyre me shpresa të dyfishuara, sepse e bukura Sykaltra e Prespës, edhe pse ishte bërë nuse e hajdutit të tmershëm Shkëmb Sokoli, vazhdonte, si fshatarët, të jetonte majë shkëmbit të Shpellës së Zezë. Vetëm se tani nuk shkonte me bravaren. Atë ua kishte falur hajdutëve dhe ata i kishin pjekur në hell, diku korieve, pranë burimeve, në vend të gostisë së martesës të bashhajdutit të tyre. E Bukura e Prespës herë-herë zbriste në fshat; kalonte rrëzë shtëpive e lëmenjve, e larë dhe e krehur, përshëndeste buzëgas njerin e tjetrin fshatar dhe shkonte nga dyqani i afendikoi

Ogurzi. Me një shenjë, me një fjalë merrte ç'i duhesh, mbushte strajcën, e pyeste:

«— Sa bëjnë, xha Ogurzi?»

«— Asnjë grosh, nuse e bashhajdutit! Të gjitha i ka paguar ai! — ja bënte afendikoi, duke i bërë temena gjer përdhe. —

Ajo buzëqeshte me ironi. Hidhte në banak aq grosh sa i bënin plaçkat dhe kthehej përsëri atje majë shkëmbit.

Fshatarët nuk e dinin se nga kishte shkuar hajduti me çetën e vet. As vetë e Bukura e Prespës nuk e dinte me siguri. Veçse dy herë në javë i kish trokitur dikush natën në derë. Kur e kish hapur, kjo, në vend të njeriut, kish gjetur hejbe plot me ushqime ose me plaçka.

Në këtë ankth pune e në këtë ankth pritjeje kaluan muajt e verës. Çfarë do të ngjante vallë? As hajdutët nuk zbrisnin nga malet, as qehajallarët me asqerët nuk dukeshin nga rruga.

Por gjersa vetë e Bukura e Prespës banonte ende majë shkëmbit, me siguri edhe hajdutët ishin atje diku nëpër korie, — mendonin fshatarët. Me këtë besim në vetvete punuan natë e ditë si asnjë herë tjetër në jetën e tyre. Mbushën hambaret plot e përplot dhe bënë ashtu si i pat porositur vetë bashhajduti: pjesën më të madhe të bereqetit e fshehën, kurse nëpër hambaret e tyre hodhën nga ndonjë kullë sa për të thënë, në rast nevojë, se të korrat nuk ishin fare keq.

* * *

Një mëngjes herët nga rruga e Manastirit, si një mjegullnajë, u duk një asqer i madh dhe pllakosi kodrën e Belit. U pa puna: Dovleti kishte ngrihur ushtri në këmbë për të kapur gjallë a vdekur hajdutin e tmershëm Shkëmb Sokoli.

Fshatarët sikur pinë bucele me farmak.

«— Po tani? — pyetën njeri tjetrin me dyshim. Ndërsa afendikoi Ogurzi i binte gjoksit me grusht:

«— A s'ju thosha unë: «mos ja vini veshin hajdutit të pashtëpi?» Tani shkoni jepni hesap! —

Asqeri turk ngrihi çadëret nëpër ara, preu pyjet e mezhdat për dru zjarri e për strehime dhe ndënjoi atje sikur s'i bëhej vonë për asgjë. Fshatarët, në ankth, pritën një ditë, dy, tri. Ditën e katërt panë suvari, që u shkëputën nga kampi i çadëreve e muarën rrugën drejt fshatit. I mblodhën fshatarët mu në Shesh të Manave dhe një zabit u foli fare shkurt:

«— Dëgjoni, jezitë: në kemi ardhur të kapim gjallë a vdekur hajdutin e tmershëm Shkëmb Sokoli me çetën e tij: Ju e kini fshehur, ju ta gjeni. Gjersa të rrimë këtu, ju do të mbani tërë asqerin me bukë e me mish. Një kjo! E dyta: Ja ku e kini të birin e të ndyerit Xhavit bej, bejçen Nuredin. T'i jepni tërë të drejtat, që i takojnë si bej. Mos bëni çerç-mërç, se kjo ju pret! — i dha fund fjalës duke i kërcënuar me jataganin.

Pastaj fshatarët panë të ngrihej bejçejja Nuredin, një djalosh me feste të kuqe në kokë e me faqe të kuqe si piperka kokosharka, i rritur në pupla në Stamboll.

«— Do t'i paguani shtrenjtë hangaret e kullat, që dogjët bashkë me hajdutët, e për qehajallarët që përzutë! Sa të dorëzohen hajdutët, ju do të ngrini

kullën e hangaret e do të dorëzoni tërë bereqetin dhe tërë haraçin tjetër, — i mëshoi zërit rëndë-rëndë.

Fshatarët fërkuan zverkun me buzë të plasur, duke vështruar tokën: «Ja ku doli fjala e afendikoit. Hajduti na gënjeu e na la!» — menduan shumë vetë.

Dhe filloi ajo jetë plot travaje: bagëtitë po pakësoheshin, bereqeti po pakësohej, fshatarët, si skllëvër të mbrehur, po grumbullonin lëndën e parë për të ndërtuar kullën e hangaret e beut. Asqeri ja kishte shtruar këmbëkryq pa guxuar të kërkonte hajdutin me çetën nëpër male. Prisinin të dorëzohej vetë.

Ndër këto ditë e Bukura Sykaltër, nusja e hajdutit të tmershëm, sa mori vesh të tëra këto të zeza, që hiqnin fshatarët, hodhi torbën në krah e furkën në dorë dhe mori monopatin përtpjetë Malizonjës. Eci e eci, pa u vënë re nga asnjeri. Ecë e çlodhu, ecë e çlodhu. Mu në Pusin e Hajdutëve u ndal dhe pa rrapin degëgjërë në mes të lëndinkës — rrethuar me korie. Rrezet e diellit atje nuk depërtonin dot. Vuri veshin: veç fëshfërimës së gjetheve, asgjë nuk ndihej: Vuri të dy pëllëmbët e duarve anës së gojës dhe zgjati buzët e fryu me të gjithë forcën:

«— Auuu! Auuu! Auuu! —

Këtë thirrje e përsëriti tri herë. Befas, si përgjegje, u dëgjua nga diku:

«— Auuu! Auuuu! Auuuu! —

Atëhere nusja nxori shaminë e bardhë nga gjiri dhe e tundi në ajër. Pas pak u dëgjua lhirrma e dytë, pastaj e treta, e cila oshëtiu në mes të korieve.

«— E Bukura ime! —

Çobanka e dëgjoi, papandehur, fare pranë saj këtë zë aq të ëmbël, aq të dashur.

«— Gjini im! — dhe të dy ranë në krahët e njëri tjetrit.

«— Pse u mundove gjer këtu? Ti e dije se unë

do të vija nesër mbrëma, — i tha ai sikur po i tërhiqte vrejtnjen.

Ajo në fillim nuk ishte e zonja të hapte gojën: e tulatur në kraharorin e tij, i dukej sikur po e humbiste njeriun më të dashur, që kishte në këtë botë.

«— Ne i dimë të gjitha. Po ti duhet të jesh më trime. Ç'është kjo e dihatur, kjo e dridhur, sikur të kanë zënë ethet e vjeshtës!

Ajo ngriti kokën, sytë e kaltërt, si të zhytur në vesë mëngjesi, dhe i foli:

«— Pa ty jeta nuk më duhet mua! Veçse sot erdha me aq ngutësi, sepse ... —

Dhe ajo i tregoi të gjitha ato që po vuanin fshatarët, të tërë atë zemëratë, që shfrynin kundra tij.

«— Të gjitha i di. Ti shko dhe jeto midis tyre. Po ike edhe ti, ata do ta humbasin fare. Ne po përgatitemi t'ja punojmë qindin asqerit. Bejçen në hell do ta shkoj!

Së Bukurës së Prespës vetëm tani iu kujtua se ajo s'ishte e shoqja e Gjinit, por e hajdutit të tmer-shëm Shkëmb Sokoli. Ja sa ashpër, sa pa mëshirë fliste hajduti i saj! Ngriti sytë dhe pa, jo me vështrimin aq të dashur e të ëmbël por vështrimin si vetëtimë të hajdutit, hien e tij të rëndë, ballin e mvrejtur. Padashur u ngrit dhe, si fajtores, ja bëri:

«— Të shkoj?

«— Të shkosh patjetër! Atje e ke vendin. Jepu zemër. Mos rri duarkryq. Të ndihet se aty banon gruaja ime, — i mëshoi zërit përsëri hajduti.

Ajo nuk guxoi ta përqafonte.

«— Mirë, po shkoj, — tha dhe bëri dy hapa tute. —

Ai rendi pas saj:

«— Harrove Gjnin tënd! — dhe u përqaftuan për lamtumirë.

Ajo mori tatëpjetë korieve me zemër të përtërirë. Si gruaja e dashur e hajdutit të tmershëm Shkëmb Sokoli, e ndjente vehtën krenare, si bashkëpunëtore e hajdutëve për të mirën e fukarenjve, e ndjente vehtën edhe trime e krenare bashkë.

Herë e veshur si bijë pashai, herë leckamane, filloi të shkonte shtëpi më shtëpi, të takohej me njërin e me tjetrin. U jepte zemër, i qërtonte, i ngushëllonte, i ndihmonte edhe i nxiste të mos punonin për beun. Fshatarët së pari i kishin frikën, pastaj ë deshën aq shumë, saqë, po të mos u fliste, ose po të mos u kalonte pranë shtëpive, nuk u vinte aspak mirë. Jo vetëm kaq por nuk e ndjenin veten të sigurt; kur nuk e shihnin, u dukej sikur u mungonte edhe krahu mbrojtës i hajdutit të tmershëm.

E Bukura Sykaltër një ditë ra në sy të zabitit e të bejçes. Sidomos bejçëja, sa e pa rastësisht përpara, të veshur aq mirë e me atë bukuri të mahnitëshme, iu duk sikur kishte rënë enkas nga qielli vetëm për lumtërinë e tij. E ndali dhe i hodhi vështrimin: e humbi fare, kur ndeshi sytë e saj të mëdhenj të kaltër, që flakëronin si me magji! Sy që shponin, sy që ndiznin, sy që vrisnin, sy që krijonin jetë e vdekje njëkohësisht. Sy të tillë s'kishte parë bejçja as në haremet e Stambollit.

«— Ti qenke perri, moj! — dihati maramendsh.

«— Jo! Jam fshatare! A kishe gjë për të thënë? — i foli ajo serbes.

«— Të desha të vije në çadëre e në... Stamboll! — belbëzoi bejçëja duke lëpirë buzët.

«— Pfu, i mallëkuar! Unë jam nusë e martuar, unë kam burrin tim! Pfu! — e pështyu ajo për të dytën herë dhe shkoi tutje me kryen lart dhe me hap krenar.

Fshatarët, që u ndodhën atje, u tmeruan dhe

prisnin të ngjante hataja. Por bejçejja mbeti si i ngrirë dhe tundte kokën. Pastaj iu afrua afendikoi duke tundur trespinë në dorë.

«— Afendiko, e kujt është ajo bushtër-perri? — e pyeti.

Afendikoi fërkoj zverkun e u përtyp një copë herë:

«— Ajo... ajo...

«— E dé, ajo, folë! Apo edhe ti je me hajdutët! Folë! — i bërtiti bejçejja me inat.

«— Ajo... ajo... është gruaja e hajdutit të tmershëm... Shkëmb Sokolit!

«— E... hajdutit të tmershëm Shkëmb Sokoli!... — belbëzoi bejçejja tërë llahtari, sikur ta kishte kafshuar një gjarpër mu në mëlçi, ndërsa zabiti, që sapo kishte arritur, i hoqi vrejrtjen afendikoi:

«— Këtu banoka e shoqja e bashhajdutit dhe ju s'na kini thënë asgjë? Ç'është kjo? — dhe tundi jaganin e brezit.

«— Ajo është fshatare dhe e ka pëlqyer e e ka marrë për grua. Ne kujtonim se këtë gjë ju e dinit, — filloi të çfajësohej afendikoi.

Si t'ja bënë?

Të dy, komandanti dhe bejçejja, e menduan punën hollë-hollë, dhe vendosën që të mos e trazonin hë për hë, por ta ruanin ditë e natë, sidomos natën ta përgjonin, se mos e fusnin, kështu, në kurth hajdutit e tmershëm. Gjallë a vdekur, ai do t'u binte në dorë.

Kështu menduan atë ditë, kur e kishte pështyrë bejçen mu në surrat e Bukura e Prespës, por në mesnatë një llahtari klithmash, ulërimash, të lebetiturash mbushën fshatin dhe, përsëri, thellësisht e ujërave sikur u ndezën tym e flakë: fshatarët panë të bëhen shkumb çadëret e kampit të asqerit.

12 Të nesërmen u muar vesh gjithçka: Hajduti i tmershëm Shkëmb Sokoli me çetën e vet i kishte rënë kampit si rrufe, saqë ushtarët e kishin humbur fare, se shumica kishin qenë në gjumë, kurse rojet kishin kafshuar dhenë. Midis shumë të vrarëve, kish gjetur vdekjen edhe komandanti bashkë me bejçen e Xhavit beut. Fshatarët nga frika muarën malet. Kjo i hutoi fare turqit. Ata, të mbetur pa krrerët e tyre, ikën me bisht ndër shalë dhe u duk sikur shpëtoi fshati nga kjo murtajë. Atë natë hajdutët zbritën në fshat dhe përsëri u bë një festë e madhe: këngë e valle tërë natën. Bashhajduti kërcëu në krye të valles bashkë me të shoqen, me të Bukurën e Prespës, e cila, siç thoshnin, ja hëngri kokën bejçes e komandantit të asqerit turk. Madje flitej se ajo, me dorën e saj, i kishte prerë kokën bejçes për të vënë nderin në vend.

Perri e bukur, trime, shqiponjë! Ky ishte mendimi i gjithë fshatarëve.

Fshatarët, të dërmuar nga ato fasha të rënda, që ua kishte hequr bejçejë me asqerin turk, sikur e muarën veten dhe ja filluan zjafetit. Por kur e shihnin përpara afendikonë Ogurzi, u prishej gjaku: kujtonin se si puthej e përqafohej me bejçen e me turqit, se si pasurohej në kurriz të fukarenjve, kurse tani shtirej sikur i kishte hequr tërë të zezat.

Sa pa marrë fund hareja, u dëgjua zëri i ashpër i bashhajdutit Shkëmb Sokoli:

— O ti, afendiko Ogurzi, për të larë të këqiat, që u sjell fshatarëve, të urdhëroj që nesër të na blesh në qytet dhjetë barrë barut dhe tetë barrë saçma e dinamit; të tjerat ua kemi marrë halldupëve.

Fshatarët ndalën frymën, Ogurziu shtangu në vend:

— Të paçim sa malet, bashhajdut! S'kam para...
— belbëzoi afendikoi.

Bashhajduti tundi jataganin, e vështroi në sy, si ta përpinte, e skrofetiti:

«— Kjo është fjala ime. Rrugë tjetër, veç kësaj, s'ka! — dhe i tregoi jataganin.
Afendikoi u bë grusht.

* * *

Erdhi vjeshta dhe gjethet e korieve e të pyjeve filluan të skuqen e të zverdhen. Vetëm dëllinjat shekullore me gjelbërimin e përhershëm mbetën të pandryshuara. Fshatarët muarën veten dhe vazhduan punët e stinës; afendikoi, si i pat dhënë çetës së hajdutëve barutin dhe dinamitin e kërkuar, e mori vehten mirë me gjithë se sikur rrinte mbi gjëmba. E Bukura Sykaltër shkante shtëpi më shtëpi takohej me fshatarët, qeshte me njerin, i jepte zemër tjetrit, ndihmonte ndonjë plakë a ndonjë plak; fliste fjalë të mira për hajdutët dhe villte vrer kundra bejlerëve e qehallarëve. Herë-herë zhdukej dy-tri ditë nga fshati. Atëhere fshatarët e merrnin me mend se asaj do t'i kishte vajtur hajduti i tmershëm Shkëmb Sokoli atje majë shkëmbit në atë shtëpi, që nuk ishte më kasolle, po shtëpi me mure si një kala e vogël.

Vërtetë bashhajduti zbriste shpesh herë dhe e kalonte natën bashkë me të shoqen e me teta Lenën. Veçse, më të shumtën e herës, ishte e Bukura e Prespës që shkante në limerin e hajdutëve, të cilin e dinte vetëm ajo. Atje nuk e kishte për gjë t'u lante rrobat hajdutëve, t'i arnonte, t'i këshillonte ose t'i qërtonte, sipas rastit, t'u gatuante edhe gjellë shtëpie, me gjithë se ata s'ishin mësuar fare me gjëra

të tilla. Herë - herë qeshte me njerin e me tjetrin, u fliste me hoka. Aq fort u kishte hyrë në zemër hajdutëve, sa që ata e quanin si motër, si pjesëtare të çetës së tyre. Sa keq kishin menduar më parë, kur kishin marrë vesh se bashhajduti i tyre do të mar-tohej! Si o, të mar-tohej hajduti e sidomos bash hajduti?! Ai i shkelte kanunet e hajdullëkut! E xheç e braktisën. Por Shkëmb Sokoli, njeri me katërqind dërhem mend, ua mbushi mendjen e më në fund ata pranuan. Por tani, që e njohën të Bukurën Sykaltër prej së afërmi, linin kokën për të. Por edhe e Bukura e Prespës ua mësoi zakonet e kur ishte midis tyre, nuk donte të dallohej se ishte femër. Prandaj atje mësoi të përdorte martinën dhe jataganin, të hante edhe mish gjysmë të pjekur, të pinte edhe gjakun e freskët të bagëtive me grusht, ose t'u hiqte plumbin hajdutëve të plagosur, duke i rënë plagës me plumb.

«— Pse je kaq e mirë dhe kaq trimë, moj e Bukura jonë Sykaltër? pyesnin shpesh herë hajdutët me të qeshur. Në vend të saj, përgjigjej hajduti plak Goro:

«— E si të mos jetë trimë dhe e mirë, mor vëllezër? Babanë e nënën ja vranë turqit, ajo u rrit me të zezat e fukarasë, e përbuzur, e lënë, e mjerë! Fatkeqë midis fatkeqëve! Ajo duhet të hakmerret për tërë të zezat që ka hequr në jetën e saj; duhet të hakmerret për tërë sojin e njerëzinë e saj! Hakmarrja e bën trimë! Urrejtja e bën trimë! — i mëshonte zërit hajduti plak Goro dhe fërkonte mjekrën e thinjur, që i zgiatej gjer në brez si një shtëllungë e bardhë lesh rudeje e ngatërruar.

«— Tamam, hakmarrja dhe urrejtja na kanë bërë të gjithëve trima! — shtonin hajdutët e tjerë dhe secili kujtonte me sy të ndezur e me zemër të

përvëluar shkaqet për se ishin bërë ata vetë hajdutë maleve, e gërxheve, si bishat e shpellave! Në atë limer, rreth zjarreve të mëdhenj, strukur në fshehtësinë më të madhe të pyllit, hajdutët sikur hapnin një nga një tefterat e hesapeve të vjetra:

...Shikoni Goro hajdutin, tani plak shtatëdhjetë e ca vjeç, pak i kërrusur, por me syrin pishë, me zemrën çelik, me kraharorin të mbushur plot urrejtje. Për kë thoni? Për të gjithë ata që janë në fuqi, për të gjithë ata që kanë pasuri, për të gjithë ata që pa mëshirë u heqin fasha fukarenjve. Ai më shumë se gjysmën e jetës e kishte kaluar hajdut maleve me dogra në dorë, me jatagan në brez. E përse do të pyesni? Fillin e hajdutillekut e ka te padrejtësia e te fukarallëku: në lulen e rinisë shërbeu pesë vjet nizam në shkretëtirat e Arabisë. Kur ishte liruar, u kthye gjysmënjeri. Më e keqja ishte se gjeti edhe shtëpinë të shkatërruar fare: babanë ja kishte vrarë agai i fshatit, dy vëllezërit e vegjël kishin vdekur nga uria, gomari i kishte ngordhur; ato dhjetë dhi të zgjebosura ja kishin vjedhur, selishten, të vetmen pronë që kishte, ja kishte rrëmbyer agai. Nënë e gjeti gjysmë të verbër me shpirt ndër dhëmbë. Sa shkeli në shtëpi, e ëma në mes lotësh të dhimbshëm ja rrëfeu të gjitha. Sa zbrazi vrerin, që e kishte mbledhur në kraharor, dha shpirt. Ç'rrugë të mirrte tani Goroja? «Hakmarrje! Hakmarrje!» — i regëtinte diçka rëndë-rëndë përbrenda vehtes. «Hakmarrje! Hakmarrje!» sikur rëgëtinin të gjitha rreth e rrotull. Nuk duroi më: mori kosorin dhe e përgjoi aganë mu të qoshja e sarajit të tij, kur kthehej fodull-fodull në shtëpi me tespi në dorë dhe... tak, i preu kokën, e mori malet, u bë hajdut. Hajdut nga e keqja! Të bijtë e agait mblodhën koshadhe bashibozukësh e asqerësh dhe e ndoqën në çdo brimë, por

nuk e zunë dot. Një ditë edhe të birit të madh të
agait ja preu kokën! Përsëri u hakmuar!

Vinte vjeshta; kallingjtë e artë varnin kryet në-
për arë dhe fusha dukej si një det — det i verdhë!
Por sakaq, kur bëheshin gati djemtë e agait të vinin
drapërin në mëngjes herët jepej alarmi: po digje-
shin të lashtat e agait! Edhe atëhere hajdut Gorua
hakmerrej! I kapi lemeria gjithë agallarët, gjithë
afendikonjtë nga hajdut Gorua, nga Goro Kuçedra,
si filluan ta quanin! E kërkonin në qiell e në tokë,
por nuk ja gjenin dot gjurmën. Megjithatë ai bënte
jetë të vështirë, plot travaje, jetë qeni, egërsirash
e kurdoherë me kokë në torbë.

Poshtë e lart për të tilla shkaqe kishin marrë
malet edhe ata hajdutët e tjerë, tani vëllezër të pan-
darë të Goros. Ata ishin shumë më të rinj se Gorua,
por njësoj ishin të vrerosur si ai, të prekur në nder
si ai, të plagosur në zemër si ai.

Për shkaqe të tilla kishte dalë malit edhe bash-
hajduti Shkëmb Sokoli. Vrerin e këtij hajduti s'e
mban as dheu! Vetë ai ishte fshatar i varfër. Gjini
si e quanin atëhere. Na u fejua me vajzën më të bukur
të fshatit, me Doruntinën. Më thonj e me dhëmbë
bëri gati harxhet e dasmës e më në fund caktuan
ditën e martesës. Ai u bë dhëndër, ajo nuse. Prapa
tyre shkonin dasmorët me këngë e me valle. Kalonin
përmes fshatit në drejtim të shtëpisë së tij. Kur...
fët, rrugën ua preu Turhan beu me një tabor sejme-
nësh dhe qehallarësh. Duke shtërnguar kamxhikun
në dorë e duke tundur mbi ballë xhufkën e festes
së kuqe, ndaloi dasmorët në rrugë dhe i hodhi një
vështrim përpinjës nuses. Të gjithë heshtën me
ankth, pritën me ankth se ç'do të bëhej. Beu, pa një
pa dy, i hoqi duvakun:

«— Ua! Ua! S'ditkam se në çiflikun tim paskam hanëmen më të bukur! — u mahnit dhe u zileps për bukurinë e Doruntinës.

Të gjithë shtangën në vend.

«— Ajo, së pari, do jetë imja! Merreni! — u dha urdhër sejmenvë e qehallarëve.

«— Jo, jo! kjo nuk mund të bëhet, nuk mund të bëhet në asnjë mënyrë! — ulëriti si një shqiponjë e plagosur për vdekje Gjini dhe e shtrëngoi nusen pranë vetes për ta mbrojtur. Por një kondak, dy kondakë, tre, katër kokës dhe e. . rrëzuan përdhe. Sejmenët e rrëmbyen nusen e dasmorët u shpërndanë të llahtaritur.

Të nesërmen nusja Doruntinë u gjend e mbytur në lumin e fshatit. Disa thoshin se e kishte mbytur beu vetë me që ajo nuk i jepej. Të tjerë thoshin se ajo i kishte shpëtuar beut nga duart dhe natën ishte hedhur nga dritarja në lumë.

Sidoqoftë, ajo vdiq për të mbrojtur nderin e saj, nderin e fukarasë. Gjini vetë nuk mund të harronte as turpin e madh, as fatkeqësinë e tij, as fatkeqësinë e trimërinë e nusës së tij. Që atë natë, sa erdhi në vete, u zhduk nga fshati.

Ku vajti? Ç'u bë? Mos kishte vrarë edhe ai vehten si Doruntina? Apo mos e kishin zhdukur edhe atë beu me sejmenët? Asnjë fshatar nuk dinte gjë.

Veçse pas një viti ja dëgjuan zërin: maleve kishite dalë një çetë hajdutësh. Kjo çetë hajdutësh vriste e priste vetëm bejlerë, agallarë, afendikonj, qehallarë, zaptije, natyrisht njerëz të këqinj. Kurse fukarenjve u falte drithërat nga hambaret e pasanikëve, u dërgonte vajzave të varfëra pajë për t'u martuar e këto pajë ua rrëmbente vajzave të të pasurve; ku e ku pajtonte grindjet midis varfanjakëve. Bejlerët, agallarët e afendikonjtë e këqinj nuk gjenin

vrinë ku të futeshin. Kështu vinin lajmet nga Gora, nga Mokra, nga Devolli, nga Rrëza e Malit të Thatë. As Turhan beu vrinë nuk gjente ku të futej. Por i mori gjithë masat: një bylyk suvarinjsh e shoqëronin kudo që shkonte. Por ja, një natë, ndërsa po bënte ziafet, se hanëmja i kishte lindur trashëgimtarin e katërt mashkull dhe që nga Stambolli Porta e Lartë i kishte dërguar edhe një rytbe më të madhe për shërbimet e tija të çmuara, që ia kishte bërë Dovletit, ja rrethuan kullën disa të panjohur dhe, sa çel e mbyll sytë, munë konak; përpara tij, u paraqitën dy veta me mjekra e me guna, me dogra e me jaganë:

«— Mos lëvizni nga buxhaku! Të gjithë jeni në dorën tonë! — i urdhëruan. Dhe beu me miqtë e tij panë sikur mbinë nga të katër qoshet e konakut njerëz të tillë me mjekra e me guna, e me tytat e dograve drejtuar nga ata.

«— Hajdutë! — mezi belbëzoi Turhan beu.

«— Po, po, hajdutë, or qen bir qeni! Hajdutë! A të kujtohet dasma e Gjinit? A të kujtohet nusja Doruntinë? — i shkrofëti hajduti më i ri. — Tani do të më paguash për vehte e për të gjitha të zezat e tjera, që u ke punuar fukarenjve.

Ngriti jataganin dhe koka e beut aty për aty u rrukullis mbi tepsinë e florinjte të mezeve.

Disa nga «miqtë» pësuan fatin e beut, të tjerët ku sytë këmbët! Po atë natë fshatarët panë të dilte nga kullat e beut tym e flakë!

Që atëhere mori dhenë lajmi se hajduti i tmer-shëm Shkëmb Sokoli bënte kërdrinë mbi bejlerët, mbi agallarët e mbi afendikonjtë e këqinj. Asnjë s'e dinte, veç Turhan beu i vrarë, se ky hajdut i tmer-shëm nuk ishte tjetër, veç fshatarit të varfër Gjini, të cilit

i kishte rrëmbyer e vrarë nusen mu në ditën e martesës duke e turpëruar në sytë e gjithë botës!

Gjini, ky djalë i zoti e i zgjuar nga natyra, pasi kish dalë maleve, kish kërkuar në qiell e në tokë hajdutët e tjerë të vetëmuar e të shpërndarë, kish kuvënduar e ish miqësuar me ta, kish fituar besimin e tyre dhe kish krijuar atë çetë hajdutësh prej së cilës u dridheshin leqet pashaitë të Ohrit e valiut të Manastirit!

* * *

Një ndajnatë, u duk një kallauz. Ai lajmëroi se Xhavit beu, bashkë me pashanë e Ohrit ish ngritur në këmbë me një ushtri të madhe dhe po i drejtoshesh fshatit Gurrë për t'u hakmarrë për bejçen, për zabitin edhe për të gjitha ato, që u kishin punuar hajdutët.

Bashhajduti vrëri vetullat e ra në mendime. Të gjithë hajdutët e tjerë vunë duart mbi silahet ngarkuar me kobure e me vezme saçmash dhe baruti. E Bukura Sykaltër priti në ankth.

Më në fund bashhajduti i bëri shenjë së shoqes. Ajo i vajti pranë. Ai se ç'i foli në vesh. Pastaj u dëgjua zëri i saj:

— Vëllezër, unë po shkoj! Ju uroj të fitoni! Lamtumirë!

Hajdutëve sikur iu shkëput diçka nga kraharori. E përshëndetën me sy. Vetëm hajduti plak Goro nuk u përmbajt: hapi krahët dhe e përqafoi.

Ajo me sy i përkëdheli të gjithë edhe një herë, pastaj tundi shaminë e bardhë, që mbante në gj, dhe u zhduk përmes ahishteve.

Llahtari e madhe në fshatin Gurrë e në fshatrat rrotull: asqeri ishte shpërndarë fushës si një re karkalecash, që shkatërron çdo gjë. Në krye të Kodrës së Belit Pashai i Ohrit me Xhavit beun kish ngritur çadëret e tyre. Aty thirrën parinë e fshatit dhe vetë afendikonë e u vunë të dy këmbët në një opingë: ja të dorëzonin hajdutin e tmershëm Shkëmb Sokoli, ja të hapnin varret me duart e tyre!

Ata, të tmeruar, mblodhën supet dhe me sy u treguan Malin e Thatë, ku kishin foletë e tyre hajdutët. Por Mali i Thatë ishte i madh. Atje kishte qindra korie e pyje, qindra çuka, gërxhe, lugina, shpella e kthepa! Prandaj as Pashait e as Xhavit beut nuk u vinte mirë, që të futeshin në mes të atyre pyjeve e kthepave.

— Ne s'jemi hajdutë t'i ndjekim në pyll. Ne duam të na dorëzohen dhe këtë e kërkojmë në emër të Padishahut tonë të madh! — shkumëzonin të dy turçelinjtë, dhe kur zinin në gojë emrin e Padishahut të tyre, puthnin tri herë tokën e bënin tri herë temena!

— Ju paçim sa malet, ju puthim këmbë e duar! Ne nuk dimë gjë se ku e kanë follenë! Kini mëshirë për ne! — guxoi e foli më në fund afendikoi, me zë të dridhur dhe lutës. Pastaj vazhdoi më me guxim: — Ç'na merrni në qafë, ne të shkretët! **Ne jemi tuajt. I jemi lutur natë e ditë Allahut, që të na shpëtojë nga hajdutët. Ç'doni nga ne? Ju këtu në fshat kini ujkun; ç'veni e kërkonin gjurmët e tij? — përfundoi afendikoi duke e hedhur fjalën për Marinë.**

Pashai dha urdhër të thirret sa më parë e shoqja e bashhajdutit.

E Bukura e Prespës, e veshur si jo më mirë, me një lahuri të bardhë të mëndafshtë hedhur mi krye, kaloi në mes të fshatit e rrethuar nga një togë asqerësh. Ajo ecte me hap të sigurt, me kryet lart, e duke përshëndetur buzëgas fshatarët, që gjente rrugës. Fshatarkat, të strukura prapa gjerdheve ose prapa kanateve të dritareve ose prapa dyerve, e vështronin ashtu të rrethuar nga asqerët e në vend që të frikësoheshin, sikur merrnin guxim prej ecjes së saj krenare e prej bukurisë shortare.

E futën në çadëren e pashait. Ajo përshëndeti me dorë në zemër dhe qëndroi si shtatore, duke i ngulur sytë e kaltërt pashait, që rrinte këmbëkryq mi sixhadetë persiane, e me atë vështrim sikur e pyeti:

«— Ja ku më ke! Ç'kërkon prej meje?»

Pashai, sa e pa, fërkoj mjekrën dhe vështrimi i saj sikur ja lbyri sytë që, pa dashur, i uli. Pranë tij Xhavit beu filloi të kafshojë me dhëmbë qimet e mustaqeve e të lëpijë gjuhën.

Pashai i Ohrit i ngriti përsëri sytë dhe e vështrroi që nga koka gjer te këmbët, sikur po i numëronte një nga një ato alltanet e gushës, ato xixina ari të grykores së kraharorit, ato hojna e ato kinda të këmishës. Pastaj, duke hequr me një frymë të thellë nargjilenë, pyeti:

«— Ti je gruaja e bashhajdutit të tmershëm Shkëmb Sokoli?»

«— Po, unë jam! — u përgjegj ajo pa drojë e zëri i saj kumboi në çadëre.

«— Burri yt i ka bërë zullume të mëdha Dovelit. Të na kallëzosh ku është!»

«— Ja ku është! Shkoni kapeni! — fët e fët ua dha përgjigjen ajo, duke drejtuar dorën nga Mali i Thatë.

«— Po s'e dorëzove, ne do të të vrasim ty! — iu kërcënua pashaj, duke shtrënguar kamxhikun gati për ta qëlluar. Pastaj kafshoi buzët: «Një bukuri e tillë a mund të vritet?!!» mendoi.

«— Ja ku më kini, vramëni! Zati ju kini dalë të vrisni gratë e fëmijët pa mbrojtje, se s'jua mban të mateni me ata të malit! — iu shkreh ajo dhe ja nguli përsëri sytë e kaltërt. Pashanë dhe beun sikur i shpoi një shigjetë.

«— Heshhtë, pis miletkë, se ta këputa kokën si të zogut! — vrëri vetullat, zgurdhulloi sytë, i ra dyshe-mesë me kamxhik.

Ajo ja mbërtheu sytë edhe një herë. Fërkoj mje-krën, hoqi çallmën dhe dha urdhër:

«— Nxirreni jashtë! —

Ai dhe beu mbetën vetëm.

«— More, sikur na magjepsi me atë vështrimin e saj! Bubu, bukuri të tillë s'kam parë në jetën time! Asaj i ka hie të jetë sulltaneshë e jo grua hajduti! — foli pashai.

Ndërsa Xhavit beu, kishte harruar bejçen e tij të vrrarë, kishte harruar gjakun dhe i binte kokës me gisht: — Hëhë, budallaj unë, më të bukurën pëllumbeshë e paskam pasur në çiflikun tim, dhe s'e paskam ditur! Ec e merru vesh tani me pashanë e me valiun!

Pashai e gjeti të udhës ta merrte vetë në pyetje dhe e mori:

«— Ti, moj hanëme, je më e bukura femër që kam parë në këtë dynja! Tregomë ku është fshehur bashhajduti; pastaj unë do të të shpie në haremin e Padishaut tonë të madh e të jetosh si sulltaneshë! — i foli kësaj here me zë të butë, sikur t'i kullonte mjaltë nga goja.

«— Ha-ha-ha! Do të më bësh hanëme, sulltane, a? Oi, oi, sa bukur, për besë! S'ka ku të vejë më mirë!

Unë... sulltaneshë! — qeshi e Bukura e Prespës dhe sytë i ndritën nga djallëzia.

Pashai u shkri fare.

«— Kapeni ju vetë, ja tek e kini në Mal të Thatë. E po e kapët, unë bëhem jo e Padishahut, por jotja! — shtoi kësaj here hierëndë.

Pashait i qeshi fytyra:

«— Askushum të qoftë! — ja bëri dhe hoqi margjilenë me shije të madhe.

Atij i vinte ta rrëmbente, t'ja priste kokën e ta pinte në kupët, si i thonë fjalës. Kaq fort ja mori mendjen ajo me bukurinë e saj! Këtë gjë e kishte në dorë ta bënte. E merrte skllave e puna kish mbaruar. Por mendoi gjëra më të mëdha: «Ajo, në mos sot nesër, do të bëhej patjetër e tija! E kapnin, s'e kapnin bashhajdutin, ajo do të ishte e tija! Tani donte ta përdorte si mjet për ta kapur bashhajdutin me çetën e tij. Mendo, pastaj, pasi të kishte jetuar me të, t'ja dërgonte dhuratë Padishahut atje në Stamboll me gjithë kokën e bashhajdutit... oho, oho, sa rytbe do t'i dërgonte ai si shpërblim! Se pashai ishte i sigurt që as Padishahu nuk do të kishte një bukuri të tillë në atë haremin e tij të madh! Prandaj dha urdhër ta lironin fshatarkën — perri e të mos i prekej asnjë qime floku. Veçse dha edhe një urdhër tjetër: ta përgjonin shtëpinë e saj, se mos zbriste papandehur bashhajduti e ta kapnin gjallë a vdekur. Të përgjonin edhe çdo gjurmë të saj ditën e natën. Por... me fshehtësinë më të madhe; ajo duhej të pandehte se ishte krejt e lirë!

E Bukura e Prespës, përsëri krenare, dolli nga çadërja e pashait dhe i ra kampit mes për mes pa u shoqëruar nga ndonjë ushtar. Sytë pishë përgjonin lëvizjet e asqerit, depot, natyrën e vendit, numrin e rojeve, hyrjet e daljet e kampit. E buzëqeshur,

kaloj edhe përmes fshatit. Të gjithë e uruan me gjithë zemër, që kishte shpëtuar.

Shtëpia e saj andej majë shkëmbit u rrethua me fshehtësinë më të madhe nga asqerët, të cilët përgjonin kush hynte e kush dilte, ose sa herë hynte e sa herë dilte ajo vetë, ose nga shkonte e me kë takohej. Natë e ditë, ditë e natë! Ajo sikur ta dinte që e përgjonin: rrallë dilte nga shtëpia e atëhere dilte e shkonte nga fshati kinse për të blerë ndonjë gjë te dyqani i afendikoit. Veçse ajo dukej në fshat për t'u dhënë zemër fshatarëve, dhe nga ana tjetër për të marrë vesh ndonjë plan të asqerit.

Asqeri nuk luante nga vendi: si një re karkalecash, filloi të shkatërrojë çdo gjë, duke ngrënë e duke pirë në kurriz të fshatarëve. Në kampin e tyre mbanin peng edhe shumë fshatarë, me përjashtim të afendikoit, që e kishin liruar.

Filluan ditë të rënda zie, urie e sëmundjeje. Në fshat sikur kishte rënë kolera. Por edhe ushtarët filluan të mërzhiteshin nga ajo pritje pa kuptim. Në vend që të vdisnin duke luftuar ose duke plaçkitur, filluan të vdisnin nga epidemia. Pashai vetëm priste. Por çfarë priste, kë priste?

Priste që fshatarët të lodheshin, të humbisnin shpresat, e ta dorëzonin vetë bashhajdutin me gjithë çetën e vet. Priste të vinte dimri, të zvizheshin pyjet: atëhere dashur pa dashur hajdutët do të dorëzoheshin o gjallë, o vdekur.

Fshatarët vërtet vuanin nga uria e nga sëmundjet që po i grinin si me kosë, por asnjë nuk dilte të tradhëtonte bashhajdutin. Kurse Xhavit beu u bë bishë: kaq muaj dhe ende s'po hakmerrej dot për të birin, për pasurinë që i kishin grabitur fshatarët, për çiflikun e tij! Ai dimrit nuk i besonte. As urisë nuk i besonte. U hëngër me pashanë. Më në

fund pashai i dha nën komandë dy tabore të ndiqte hajdutët në mal. U nisën taborët me bori, me zurna e tambura. Ranë trumbetat fort e fort, dërsyen zagaret përmes pyjeve sikur kërkonin gjahun. Hë këtu, hë atje, u futën në thellësi të Malit të Thatë. Zagaret ndiqnin lepujt, ujqërit e derrat në strofkat e tyre dhe asqeri ngatërronte gjurmat e drejtimin. Zagaret çanë grykën e Gollaçukës dhe lehnin sikur të kishin gjetur gjah ose njerëz! Taborët me beun në krye ndoqën zagaret nëpër atë grykë të ngushtë në të dy anët tërë kthepa-kthepa e dëllenja. Papandehur «pam-pam-pam» u dëgjua nga ato kthepa e dëllenja dhe Xhavit beu ra pikë e përdhé që nga kali. Ushtarët u tromaksën dhe e humbën: Plumbat e shishanetë u vinin nga katër anët! Por njerëz nuk shihnin gjëkundi. Shumë ushtarë kafshuan dhenë, të tjerët u dhanë këmbëve e u kthyen të llahtaritur në kamp.

«Hajdutët vranë beun! Hajdutët vranë ushtarët!»

Lajmi mori dhenë dhe fshatarëve sikur iu lehtësua ai ankth i zi, që u rëndonte në zemër gjatë atyre muajve.

Pashait s'para i erdhi keq: beu e kishte kërkuar vetë vdekjen! Atij iu mbush mendja se taktika më e mirë ishte ajo që përdorte ai: t'i varroste të gjallë fshatarët pa lëvizur nga vendi. Pastaj patjetër do të dorëzoheshin hajdutët.

Dhe lufta e pritjes vazhdoi: Fshatarëve përveç urisë iu shtua edhe të ftohtit, se nuk i linin të prisnin asnjë kleçkë dru për zjarr. S'kishte ku shkonte më keq!

Së Bukurës së Prespës sikur po i shkulej mëlçia çika-çika, kur shihte atë varr të hapur të fshatarëve. Net të tëra nuk e zinte gjumi nga merak. Më në fund nuk iu durua: Ishte errët pus dhe frynte një

erë e tërbuar. Dallgët e liqenit kërcenin përpjetë e përplaseshin me furi mbi shkëmb e që nga shkëmbi fasha stërkalash hidheshin gjer te muret e gjer te çatia e shtëpisë dhe i spërkatnin si breshërimë. Në atë kohë, natën, ajo u vesh si fshatare e varfër, ngjeshi në brez një kamë, u mbështuall me një gunë dhe me shumë e shumë kujdes hapi derën e, si një fantomë, rrëshqiti në errësirën e zhurmëshme përpjetë maleve. Rojet dridheshin nga të ftohtit e nga pagjumësia dhe në atë natë të tërbuar nuk mundën të pikasnin as zhurmën më të vogël të asaj, që e ruanin fshehurazi.

Pas një udhëtimi shumë të lodhshëm në mes monopatesh e shtigjesh të panjohur, në mes të errësirës si pus, mezi arriti te limeri i hajdutëve krejt e rras-kapitur. Sa u përshëndet e sa mori pakëz veten, ajo u tërhoq mënjanë me bashhajdutin e me hajdutin plak Goro. Atyre u kallëzoi fije e për pe tërë të zezat, që po hiqnin fshatarët. Hajduti plak Goro nxori një psherëtimë të dhimbëshme:

«— Oh, o qeni turk, ja hëngre shpirtin fukarasë! —

Bashhajduti vrëri vetullat e shtrëngoi grushtet:

«— Për ne nuk ka rrugë tjetër, veç vdekjes me jatagan në dorë. Të vdesim ne, që të shpëtojë fukaraja! — tha me zemërim të madh. Së Bukurës së Prespës për herë të parë i rrëshqitën lot përmes faqeve. Mendimi i të shoqit, bashhajdutit, e theri mu në zemër: ajo në lule të rinisë, ai në lule të rinisë! Krijuan një familje të ngrohtë dhe ajo e dashuroi aq fort jetën, dashuroi aq fort njerëzit e varfër u bë aqë trime, sepse edhe bashkëshorti i saj, edhe pse ish hajdut maleve, e donte shumë jetën, i donte shumë fukarenjtë prej gjirit të të cilëve kishte dalë, i donte shumë njerëzit e mirë dhe ishte trim përmbi

trima. Tani e mira e fukarasë e donte që të vdisnin me jatagan në dorë! Trim me fletë ishte bashhajduti, edhe këtë do ta bënte me siguri!

Hajduti plak Goro hodhi sytë në qiell, pastaj rreth e rotull maleve me një grahamë të pikëlluar dhe i mbërtheu sytë bashhajdutit të tij dhe së Bukurës Sykaltër:

«— Unë u plaka tani! Nderi im e do të vdes me këtë në dorë. — dhe tregoi jataganin. — Edhe ty, si burrë, ajo vdekje të ka hie. Edhe vëllezërve atje përtej një vdekje e tillë u ka hie, megjithëse janë të rinj. Por . . . nuses jo! Ajo duhet të rrojë, se në barkun e saj ka disa muaj që rron Shkëmb Sokoli i ri. Ai mund të jetë më trim, më ugurmirë: ai mund të arrijë të udhëheqë jo një çetë hajdutësh, si ti sot, por një taborr të tërë prej fshatarësh! Nusja të rrojë, që të rrojë ai, të rrojë. . .

Hajduti plak Goro heshti, por me atë heshtje sikur vazhdonte të fliste plot shpresa për një të ardhme të mirë të fukarasë.

Këto mendime ua thanë edhe hajdutëve të tjerë: bash-hajduti Shkëmb Sokoli u hodhi secilit nga një vështrim depërtonjës: te asnjë hajdut nuk vuri re asnjë pikë dyshimi, asnjë kundërshtim.

«— Ju jini të lirë të zgjidhni: ja të vdisni me jatagan në dorë për të shpëtuar fukaranë, ja të vazhdoni maleve si hajdutë! Jini të lirë. Mos na shikoni mua dhe hajdutin Goro! — u tha.

Por heshtja e tyre, qëndrimi i tyre burrëror, vështrimi i tyre i gjallë tregonte se këta hajdutë, edhe pse ishin të rinj, nuk kishin frikë të vdisnin me jataganin në dorë për të mirën e fukarasë. Atëhere kryqëzuan jataganët njëri mbi tjetrin dhe bënë betimin.

Në mugëtirën e mbrëmjes çeta e vogël e hajdu-tëve, e përbërë nga nëntë veta, u la lamtumirën ma-leve, shpellave, thepave e korieve të dashura, ku kish gjetur prehje e ngushëllim nga mizoritë e qenit turk e të bejlerëve, dhe mori rrugën tatëpjetë për në Gurrë.

* * *

Natën në kampin e armikut, te Kodra e Belit u dëgjuan të shtëna martinash e dogrash, ulërima e të lebetitura, klithma dhe alarme trumbetash borish e zurnash.

Fshatarët u tmeruan: Ç'po ngjante vallë? Po ç'ishin gjithë ato klithma alarme e të lebetitura të llahtarëshme? Kampi i ushtarëve sikur po digjej e po tundej që nga themeli: tërë natën vazhduan luf-time të ashpëra, tërë natën u dëgjuan të shtëna, tërë natën vringëlluan jataganët dhe shishanet çanë qiellin!

Në mëngjes, sa shkrep dielli, me urdhër të pa-shait, u spastruan ushtarët e vrrarë. Pastaj pashai, i rrethuar nga shtabi i tij, i shpuri fshatarët që kishin mbajtur peng në sheshin ku ishte zhvilluar ky luf-tim aq i ashpër. Fshatarët panë nëntë kufoma të shtrira, të gjitha me mjekra, të gjitha me plagë të rënda në trup e në fytyrë, të gjitha me sy të hapur, sikur përgjonin armikun.

«— Pa na thoni, a janë këta hajdutët tuaj? —
i pyeti pashai me ironi.

Fshatarët i vështruan sa i vështruan, pastaj bel-bëzuan me grahmë:

«— Po, këta janë! —

Ndërsa afendikoi, që ishte thirrur dallëngthi, duke prekur me këmbë e me përbuzje njerën nga kufomat, shtoi:

«— Ky këtu është bashhajduti Shkëmb Sokoli! —

Pashai, i tmeruar, i nguli sytë kufomës: një ballë i gjërë, një hundë shqiponje, një mjekër e zezë krela-krela, flokë të gjata kaçurrela lëshuar mbi supe e përzjerë me gjak, sy të mëdhenj të zez. Një vigan i vrarë me plagë, që s'ja numëroje dot, — ja si na qënkish bashhajduti i tmershëm Shkëmb Sokoli! Pranë tij, me dorë të zgjatur sa çikte supin e bashhajdutit, ishte shtrirë një kufomë tjetër, — me mjekër të gjatë gjer në brez e si shtëllungë e bardhë e ngatërruar, me njerin sy të nxjerrë.

«— Ky është hajduti plak Goro! — psherëtiti njeri nga fshatarët.

Pastaj pashai, edhe pse kishte dhënë kaq viktima nga ushtria e tij, i kënaqur se e kishte asgjësuar të tërë çetën, dha urdhër të bëheshin ato zakone që bëheshin për trofetë e luftës: Kufomat i varrosën, ndërsa kokat e prera të hajdutëve, shkuar mbi hunj të mëdhenj, i ngulën mu në Sheshin e Manave për të tmeruar fshatarët, që të mos guxonin më të ngrinin dorë kundra Dovletit e kundra pasanikëve.

Fshatarët, me tmer e dhëmbje, tri ditë me radhë, panë në Sheshin e tyre kokat e hajdutëve; ndërsa, përballë tyre, në një mur jo të lartë, valvitej mbi një shtizë flamuri me gjysmë hënë i Dovletit.

Në mbrëmjen e ditës së tretë fshatarët nga vrimëzat e gjerdheve e nga plasarimat e dyerve panë të Bukurën Sykaltër të Prespës, nisur e stolisur si nuse, si bijë pashai e shkuar asaj, tamam si atë ditë, kur ishte shpallur fejesa e saj me bashhajdutin. Ajo u ndezi nga një llambadhë secilit hajdut duke bërë kryq. Pastaj shkoi tutje nga Kodra e Belit krenare dhe e bukur perri, sikur të mos kishte ngjarë gjë.

Asnjë ushtar nuk e trazoi, as roja nuk e ndali. Ishte dhënë urdhëri me kohë që ajo të mos prekej, e as të mos ndalej sa herë të hynte ose të dilte nga kampi.

Kampi ishte në trazirë, se pashai kishte dhënë urdhër që të përgatitesh asqeri, se të nesërmen do të iknin për në Ohër e Bitoljë duke marrë me vehte edhe të nëntë kokat e hajdutëve shkuar në hunj.

E Bukura Sykaltërt i kërkoi rojes të takohet me pashanë. Sa lajmëroi ai, dyert u hapën. Ajo eci me hap të sigurt e të matur, me trupin drejt si selvi, me kokën lart e me vështrimin të mbërthyer mbi çadëren e pashait. Të gjithë që e panë, mbetën me gojë hapur: u dukej se kjo hanëme, nën lahurin e bardhë prej mëndafshi, shpërndante rreze drite, që ua lbyrte sytë! Lum pashai i tyre!

«— Sipas fjalës që të dhashë, ja ku të erdha, pasha! Jam jotja! — i tha ajo duke i bërë temena.

Pashai fërkoj mjekrën, fërkoj duart, zgërdhiu dhëmbët sikur nuk e nxinte vendi nga gëzimi.

«— Qënke vërtet e besës, kurse unë po mendoja të të dërgoja asqerin që të të sillte me zor këtu! — buzëqeshi ai dhe zgjati duart që ta rrëmbente në krahët e tij.

Të nesërmen herët ajo doli nga çadëreja e pashait qetë-qetë me një bohçe plaçkash në duar.

Rojës, që ruante jashtë çadëres, i tha:

«— Ssstt! Pashai është i lodhur e po fle. Këto janë dhurata, që m'i dha për nënën. Unë shpejt do të kthehem. —

Rojës iu kujtua urdhëri i prerë i pashait për ta lënë të lirë, ditën e natën, dhe e la.

Ajo doli nga kampi duke ecur kurdoherë me trupin drejt, me kokën lart, me vështrim herë të dallgëzuar, herë të qetë. Sa vajti te Sheshi i Manave, u ndal pranë murit, ku valavitej flamuri me gjysmë

hënë. Shpejt e shpejt hipi mbi mur, lëshoi litarin me gjithë flamur dhe, pas pak, në shtizën e flamurit u ngrit një kokë me mjekër! Pastaj, si vetëtimë, ajo mori drejtimin e Kosornikut e të Shpellës së Zezë, aty, në shtëpinë e saj majë shkëmbit.

Kur vajti togu i ushtarëve të merрте të nëntë kokat e hajdutëve për t'i shpënë në Ohër e në Bitolje, ç'të shihnin! Në shtizën e flamurit me gjysmë hënë ishte shkuar koka e... pashait të tyre!

Alarm' an'e mbanë kampit, anembanë fshatit:

— E Bukura e Prespës vrau pashanë! —

Ushtria u turr nga të gjitha anët për të kërkuar vrasësen — perri. Kur arritën pranë Kosornikut e Shpellës së Zezë, ajo, hipur majë shkëmbit, u valaviti shaminë e bardhë, që mbante kurdoherë në gji e me të cilën i jepte shenjë bash-hajdutit të saj, dhe thirri disa herë:

— Unë me dorën time vrava pashanë tuaj! Unë mora hakun e Shkëmb Sokolit dhe të shokëve të tij! —

Kur iu afruan asqerët ta kapnin, ajo u hodh nga shkëmbi dhe... humbi në ujërat e dallgëzuara të liqenit!

* * *

Pasi u shporrën ushtarët turq e pasi u qetësua vendi, teta Lena e Shushatura vajti shtëpi më shtëpi dhe u la nga një qese me flori «për shpirt të hajdutëve e të Marisë», si u thoshte ajo. Këto para ishin nga thesari hajdutëve; para se të niseshin ata për vdekjen heroike, tërë thesarin ja besuan së Bukurës së Prespës për ta përdorur si të donte ajo, sidomos për të rritur edhe Shkëmb Sokolin e ri, që do të lindte. E Bukura e Prespës, e vendosur për të vdekur

edhe ajo heroikisht, duke u hakmarrë për të shoqin e për hajdutët e tjerë, thesarin ja besoi s'ëmës me porosi, që po t'i ngjante asaj ndonjë e keqe, florinj të t'ua shpërndante fshatarëve të varfër. Dhe teta Lena e Shushatura ashtu bëri.

Fshatarët, për të kujtuar trimërinë e bashhajdu-tit Shkëmb Sokoli e të hajdutëve të tjerë e sidomos për të kujtuar edhe trimërinë e së Bukurës së Prespës, për mirënjohje, mu në shkëmbin nga u hodh ajo në liqen, ngritën vakëfin-shpellë, që është edhe sot. Gjatë shekujve vajzat, gratë e fëmijët e fshatit, për të shpëtuar nga sulmet e asqerit turk, shpesh herë kanë shpëtuar jetën e nderin duke u fshehur në atë shpellë-vakëf, kurdoherë me besim të plotë se po i mbronte e Bukura Sykaltër Shënmëri, ose «e Bukura e Prespës».

SOKOLESHA

Një ditë më shpuri e mira në Malësi. Bashkë me shumë pionerë e të rinj i ramë vendit pash më pash. Atje u njohëm edhe me Ded Dragobinë, një malësor plak, i gjatë sa një lis, me flokët borë, me mustaqet gjer te veshi, me vështrim shqiponje.

Ai na tregoi mjaft ngjarje rreth luftës së brigadave partizane, kur marshonin drejt Veriut e drejt Jugosllavisë, duke ndjekur armikun këmba-këmbës. Pastaj, kur dëgjoi këngët partizane e të trimërisë, që zunë të këndonin një grup të rejash, ai vuri dorën në silah e ja bëri:

— Hej, këto malet tona edhe në kohët më të lashta kanë mëndur jo vetëm sokola, por edhe sokolesha, ja, si këto sokolesha, që na magjepsën me këngët e tyre!

Të rejat kënduan edhe dy-tri këngë trimërie për hir të tij. Pastaj iu lutën t'u tregonte ngjarjen e ndonjë sokoleshe të këtyre anëve.

Malësori Ded Dragobia nuk ngurroi: ngriti dorën, shënoi majtas e djathtas dhe foli:

«— Ja katundi ynë! Kurse andej larg, përtej atyre çukave, përtej atyre majave, një ditë fluturim shqiponje, është deti ynë Adriatiku!

Shiheni katundin tonë: Aty në çukë, mbi sarajet e reja, që ka ngritur Partia, dikur, ka qenë një kullë

e vjetër, e vjetër sa s'mbahet mend. Ajo ishte kulla e Shpend Malokut. Ai kishte vetëm një vajzë që e quanin Sokoleshë. Vajzë më të bukur s'kishte parë kjo Malësia jonë. Llamburiste kulla, llamburiste katundi, llamburiste gjithë malësia, kur dukej ajo.

U rrit e u rrit e t'u bë në moshë martese. Sa trima ja kërkuan, sa sokola u lektisën pas asaj, por veç njeri prej tyre e pat fat: ky ishte Gjon Shigjeta, një trim mbi trima, që u kishte prerë kokën kushedi sa e sa jeniçerëve! E vërteta është se ai s'ishte nga Malësia jonë, por fama i kishte ardhur gjer tek ne. Dërgoi shkesë dhe puna u mbarua: Sokolesha jonë u fejua me Gjon Shigjetën!

Mirëpo në atë kohë, në çdo hap, mbinte një e keqe, në çdo çukë ishte një pritë armiku. Një herë, një lajm i keq mori dhenë: Bajloz Anadollaku na e paskish ngritur sarajin me gjithë haremin në buzë të detit Adriatik! dhe kishte filluar t'u bënte zullume e të këqia malësive tona. Rrëmbente vajzat më të bukura e djemtë më të pashëm, — i mbante sa i mbante në sarajet e veta e pastaj ja dërgonte në Stamboll e në Edrene dhuratë Sulltanit dhe sadrazemëve. Këtij Bajloz Anadollakut i kishte rënë në vesh se Shpend Maloku na paskish vajzën më të bukur të Malësisë. I kishin thënë se Sokolesha na gënkej e bukur si dielli, syrin na e paskej të ndritur si yll, shtatin lastar, flokët e zeza, fytyrën të pastër qehlibar! Bajloz Anadollaku u çmend për Sokoleshën, pa e parë fare. «Këtë vajzë nuk do t'ja dërgoj Sulltanit, por do ta mbaj për vete në haremin tim!» mendoi.

Pa humbur kohë, dërgoi një tabor jeniçerësh në Malësi:

«— O i zoti i shtëpisë, o Shpend Maloku, urdhër i prerë nga zoti ynë, nga Bajloz Anadollaku: ke një

muaj kohë të nisësh si duhet Sokoleshën, e t'ja sjellësh në sarajet e tij buzë detit! Po kundërshtove, ai me dorën e vet do t'i bëjë shkumb e hi këto kulla, kokën do të ta bëjë fërtele me jatagan, gjithë bagëtinë do të ta shkojë në hell, arat me të lashtat do t'i bëjë kullota për hergjelenë dhe çikën do ta marrë se do ta marrë! —

Shpend Maloku mbeti ngushtë. Ai ish plak njeri, nuk kish fuqi të matej me Bajloz Anadollakun! Nga t'ja mbante? Të kishte fat, do të ishte gëzuar edhe me një djalë, por, e keqja ishte se kishte vetëm një fëmijë, edhe atë vajzë.

Plakun e gJORë nuk e zinte vendi. Si t'ja bënte? Si t'ja jepte Sokoleshën e shpirtit atij anadollaku? A s'kishte jetuar Shpend Maloku tërë jetën me bukë e kripë, veçse për një nder?

Sokolesha, vajzë tetëmbëdhjetë vjeçe, sa dëgjoi gjëmën e anadollakëve, rrëmbeu jataganin dhe vajti drejt e te i ati:

«— Mos u trëmb, baba i dashur, mos u tremb! Premtou se do të më shpiesh vetë në sarajet e katilit! Dhe të betohem për këtë tokë dhe për atë qiell, se kokën e bajlozit mu këtu do të ta sjell! —

Shpend Maloku me guxim të përtërirë nga fjalët e së bijës, u shfry që nga frëngjia me një shpoti të hollë:

«— Të fala me shëndet Bajloz Anadollakut e i thoni se pas një muaji Shpend Maloku do t'ja sjellë Sokoleshën të nisur e të stolisur, që ta gëzojë e ta trashëgojë! —

Hordhia e jeniçerëve u ra trumbetave e burive dhe u kthye e gëzuar buzë detit, që t'i jepte siharin Bajloz Anadollakut.

Sokolesha, vajzë për kokë të vajzës, tha dhe e bëri. Një muaj të tërë u përgatit, ushtroi krahun,

ushtroi syrin, rrëzoi me jatagan korieve mjaft filiza edhe boriga qindvjeçare. Me gjokun kapërcente për-pjetë e tatëpjetë gjithë ato prozhme, gjithë ato koda, gjithë ata thepa. Krahu iu forcua, syri iu bë pishë dhe qëndronte kaluar mbi gjokun si një trim me fletë.

«Sokolesha nuk i dorëzohet Anadollakut! Sokolesha nuk e tradhëton Gjon Shigjetën! Sokolesha nuk e korit Malësinë!» Sa e sa herë i përsëriste këto fjallë, sa e sa herë betohej e shtërbetohej me vete ajo vajzë e re.

Erdhi edhe dita e caktuar. Tëk-tëk! — i bënte zemra plakut Shpend Maloku. Tëk-tëk! — i bënte zemra edhe nënës plakë dhe u dukej sikur vate e shkoi Sokolesha e tyre, u dukej se vate e shkoi jeta e tyre, nderi i oxhakut të tyre!

Tëk-tëk! — i bënte zemra edhe Sokoleshës nga ankthi e nga urrejtja kundra Anadollakut, që kapardisej si zot në trojet tona!

4.

U përgatit për udhë, u përgatit për betejë. Pas tri javësh do të bëhej nuse! Nuse?! As që duhej të mendonte tani për dasmën, po për luftën që e priste! Nxori nga arka e nusërisë rrobet, që i kishte përgatitur t'ja shpinte dhëndërit si dhuratë, i vështroi e i kaloi nëpër duar një e nga një, pastaj po një e nga një i veshi: veshi më parë këmishën prej pëlhere të bardhë me mëngë të gjera. Mbi të vuri jelekun prej shajaku të bardhë të zbukuruar me gajtan të zi dhe shtrëngoi mirë gjoksin, që të mos binte në sy. Pastaj mbathi çekçiret prej shajaku të bardhë me vija të zeza e me rrathë prej gajtani të zi dhe i shtrëngoi mirë në pulpat e këmbëve. Mbathi shputat me lule

të kuqe dhe opingat me gjithë ato ravijëzime retnash të stërholla. Rrotulloi rreth mesit brezin e gjatë e të kuq dhe e shtrëngoi belin mirë e mirë. Flokët e zez si pendë korbi i mbështolli me shaminë e kuqe, që e lidhi rrotull kokës si sokolat dhe mbi krye ngjeshi qeleshen e bardhë. Vërtet iu duk vetja sokol, sokol malësie, veçse shumë i freskët: as qimet e mustaqeve nuk i kishin djersirë! Pastaj nguli në brez pisqollat dhe thikat një nga një; mbathi kalin me patkonj të rinj, kapi jataganin dhe «fërr!» u gjënd majë gjokut, e drejtë si selvia, kryelartë, me syrin pishë dhe me urrejtje të papërmbajtur në kraharor.

Plakut Shpend Maloku i qeshi nuri: «Zot, o Zot, unë kujtoja se isha koritë pa djalë, por Sokolesha më qënka djalë e shkuar djalit, sokol e shkuar sokolit! Paska Zot edhe kjo kulla ime.

«— Pa ule kokën pakëz, moj bijë, të të puthim e të të urojmë udhë të mbarë, të zbardhtë faqen Ora! —

Sokolesha u përul e ndjeu në ballë e në faqet ngrohtësinë e buzëve të prindëve të saj, ndjeu në kraharor afshin e bekimit e të krenarisë së tyre.

«— Mos harro, moj bijë, ke një ditë rrugë gjer te Gjon Shigjeta. Që andej, të nesërmen, arrin në breg të detit. Më parë shko fill e te Gjoni, se s'ke ku fle sonte, — i dha këshillat e fundit i ati. —

Rrezet e diellit ende nuk kishin puthur majat e çukave të katundit, kur mori vrapin Sokolesha. Trak-e-trok, gjoku i saj kapërcente përrenj e korie, prozhme e çuka! Tak-e-tak i rrihte zemra asaj tek po i linte lamtumirën katundit, kullës, dhenve e vathës, korieve e çukave aq të njohura, aq të dashura.

Nata e zuri në katundin e të fejuarit të saj.

Tak-tak! Tak-tak! — trokiti në derë.

Tëk-tëk! Tëk-tëk! — i trokiti edhe zemra.

Pas pak, u gjënd përballë një malësori të ri, shtatgjatë, të pashëm. E njohu nga tiparet: ai ishte dora vetë; Gjon Shigjeta, i fejuari i saj. Por... nuk e dha veten.

«— A doni miq? — pyeti ajo me një zë burrëror.

«— Mirë se të pruri e mira! — E ftoi ai me fisnikëri dhe, pa pritur përgjegje, ja mori gjokun, ja lidhi në shtallë, dhe sakaq, të dy, krah për krah, ngjiten shkallët e u gjendën lart në konak.

Aty i priti me buzë në gaz nëna plakë e Gjonit dhe mikun e panjohur e vunë në krye të vendit.

«— Nga na vjen kështu, o trim? — e pyeti plaka me një dyshim të tulatur, sepse sa e kishte parë, i ishte dukur tamam vajzë e veshur si djalë.

«— Nga Malësia e Veriut, nënë! — iu përgjegj miku i panjohur, duke u munduar të ndryshonte zërin e hollë dhe tiparet e njoma prej femre.

«— Nga Malësia e Veriut a? — Përsëriti pyetjen edhe Gjon Shigjeta me dyshim të tulatur, sepse edhe atij i kishin rënë në sy tiparet prej femre, mëdje tipare të një femre shumë të bukur, me një bukuri, që kurrë s'e kishte parë e dëgjuar!

Kur vajti në dhomën tjetër për të sjellë kafënë, i tha s'ëmës:

«— Moj nënë, nuk e di se si, por shpirti ma thotë se ky djalë, djalë nuk është! Fytyrën e ka krejt si femër!

Ajo iu përgjegj:

«— Djemtë nuk njihen vetëm nga fytyra, po edhe nga zanati edhe nga tekat. Ky shpatën e gjokun i ka zanat! Kjo duket sheshit. Të shohim tani se çfarë teka ka! Ti ke në dhomë lahuta e çifteli, e fyej e gërnetë; ke furka e shtiza, penjë e gjëlpëra, kllapodan e gajtan! Ja trego të gjitha edhe prit se

çfarë do t'i pëlqejë më shumë. Po mori çiftelinë e lahutën, kuptohet që do të jetë djalë! Po mori furkën e qëndismat, kuptohet që do të jetë vajzë.

Dhe ashtu bëri:

«— Natë e gjatë kjo, o mik! — i tha Gjoni. Si të pëlqen ta kalojmë? I kam të gjitha: Pa shih, kam lahutë e çifteli, fyej e gërnetë, po... edhe furka e shtiza!

Sokolesha qeshi. Ja kuptoi djallëzinë. Ndërsa plakja shtronte sofrën me gjithë të mirat, medje edhe me verë të kuqe të ëmbël, miku i panjohur mori lahutën e i ra, i ra e këndoi fort bukur për trima, që kanë luftuar heroikisht kundra armikut, që u ka shkelur nderin e trojet e tyre, për dragonj që kanë zveshur shpatën — flakë dhe për vëllamë luftëtarë, që i kanë lidhur plagët njëri-tjetrit me këmishët e trupit.

7

Pastaj i ra fyellit e ndolli aq bukur zilkat e grigjeve tatëpjetë gërxheve, bjeshkëve dhe lëndinave, gurgullimën e përrenjve, të burimeve, fëshfërimën e pyjeve, të lehurat e qenve, blegërimën e shqerrave dhe sokëllimën krenare të barinjve: Orrr, ooorrr!

«— Të lumtë, o mik! S'kam ndeshur sokol kaq të dashur, kaq të matur, kaq të pashëm e që t'i bjerë kaq bukur fyellit e lahutës! Ma do zemra të bëhemi vëllamë! — i tha tërë gaz e hare, e brom ja bënë me gërxhakët plot verë të kuqe.

Miku i panjohur ja hapi zemrën, por diti ta fshehë vehten:

«— Mik i dashur, edhe mua më pëlqen shumë fisnikëria dhe burrëria jote! Mirëpo sot... nuk bëhemi dot vëllamë. Mua më pret një detyrë e madhe dhe e rëndë: Bajloz Anadollaku në breg të detit na ka marrë nderin! Në paça fat, do t'ja pres kokën në

shesh të burrave, që të ve nderin në vend, të shpëtojnë edhe Malësinë, Pastaj — eh, pastaj, — pas tri javësh, unë do të vij këtu që të bëhemi vëllamë!

Çokitën edhe një herë gërzhakët të dy sokolët; uroi edhe një herë nëna plakë; çukërmoi dhe hingëlloi edhe një herë gjoku në qilar.

Çokitën edhe të dytën herë, edhe të tretën herë! Të katërtën herë u ngrit më këmbë Gjon Shigjeta i ndezur prush:

«— Pas tri javësh unë të ftoj të vish në martësen time me çikën më të bukur të Malësisë! Kurse vëllamëria jonë do të pagëzohet me gjakun, që do të derdhim bashkë, duke luftuar të njëjtin armik. Edhe unë do të vij me ty për të vrrarë Bajloz Anadollakun! —

U tha dhe u bë!

Të nesërmen herët i lanë shëndetin plakës dhe të dy sokolat majë gjokëve muarën fluturim tatëpjetë bjeshkëve, tatëpjetë pyjeve dhe lëndinave, tatëpjetë korieve e çukave dhe, sa pa lindur dielli, ja behën buzë Adriatikut.

«— Oh, oh! — U ranë përmes valëve të vogla dhe stërkalat, që u ngritën nga këmbët e kuajve, spërkatën të dy kalorësit.

«— Oho! Oho! Ç'vend i mrekullueshëm! — brohoriti Sokolesha.

Dhe të dy pranë e pranë, kaluar, soditën detin e pafund me brigjet ranore e shkëmbore, në atë mugëtirë, që grisej dalngadalë si një tis i hollë. Rrezet e diellit depërtuan, deti ndriti, toka çeli dhe pallati i Bajloz Anadollakut shkëlqeu aty përballë buzës së detit.

Të dy sokolat u ndalën, përsiatën një copë herë, ndërsa gjokët nën ta po çukërmonin rënishtet me ngulm. Me sytë e mprehtë matën vendin, me krahun

e fortë provuan jataganët, me shkathtësinë e trupit u mbërthyen mbi shalët e kuajve.

«— Do t'ja dalim! Patjetër do t'ja dalim! — i dhanë zemër vetes me besim të madh dhe nganë doritë tutje.


Sarajet e Bajloz Anadollakut u dualën përpara me tërë bukurinë e madhërishme, krejt ornamente e ravijëzime lulesh, hardhish e shatërvanesh — skalitur e pikturuar me ngjyra të forta, sikur çdo gjë atje buzë detit ishte ngritur nga një mjeshtër i mrekullueshëm, që dinte ta krijonte çdo gjë të bukur e tërë gjallëri, sikur ta ketë krijuar vetë natyra! Dhe shumica e atyre zbukurimeve e atyre pamjeve të kujtonin Malësinë, Dibrën, Krujën, bregdetin shqiptar! Paskish pasur të drejtë ai që kish thënë se atë mrekulli të mrekullive e paskishin bërë mjeshtërit dibranë, të cilët, kur ishte puna për art, harronin kërbaçin, që u rrinte mbi krye!

Të dy kalorësit hodhën vështrimin në katet e sipërme: Njëpër dritare kishin dalë robinjat e haremit që, të kthyera nga dielli, kriheshin dhe flokët e tyre gështenjë, të verdhë a të zez si pendë korbi të lidhur gërshehta ose të derdhura mbi supe, i lagnin me lotët e syve të tyre, të atyre syve, që pasqyronin ngjyrën e dallgëve të Adriatikut a gjelbërimin e errët të lëndinave në pranverë. Syri i qiellit qeshte, por atyre u dukej nursëz! Kurse në konakun e vet Bajloz Anadollaku po nisej e po spillosej, që të priste vajzën më të bukur të Malësisë, Sokoleshën e Shpend Malokut, që t'ja pasuronte haremin me më të hijëshmen perri të Arnautistanit!

«— Hej, Bajloz i Anadollit, pa dil në mejdan, se kam një amanet nga vajza e Malësisë! — thirri Sokolesha me sa fuqi që kishte.

Sakaq, te dera ja pat vetë Anadollaku. Për një cast të dy vëllamët e humbën: përpara tyre qën-

11-12



dronte një ari veshur me benevrekë e dolloma prej cohe të kuqe ngarkuar me kllapodan, me sërma e gajtan, me qostekë të kryqëzuar në kraharor, me pisqolla e thika të ngulura në silah, me mustaqe bërë spic gjer rrëzë veshit e me një kokë sa një shinik!

«— Çfarë amaneti më ka dërguar bukuroshja e Malësisë? Kur arrin këtu? Ne jemi në festë për ta pritur — tha Anadollaku rëndë-rëndë duke lëpirë buzët e duke përdredhur mustaqet.

«— Ky është amaneti i saj! — klithi me zë të ashpër vajza dhe ngriti jataganin me krahun e saj të stërvitur. Anadollakut nuk iu dha të futej në konak, po mori sheshin përpara.

«— Kështu i presim ne katilët e Anadollit! — shfryu trimëresha dhe ngau gjokun drejt tij. Kështu bëri edhe Gjoni duke vërtitur jataganin në ajr, sikur po i printe një ushtrie të tërë.

Gjoku i Sokoleshës, si veriu, e arriti dhe ja hodhi mbi shpinë këmbët e para, ndërsa çika ngriti krahun dhe i ra rëndë me shpatë:

Bam! — një herë dhe ja këputi krahun e djathtë!

Bam! — një herë tjetër (po kësaj here i ra Gjoni Shigjeta) dhe Anadollakut iu këput si një degë e prerë krahu i majtë.

Sokolesha ngriti dhe uli vetëtimthi krahun dhe «bam» — ja çau kokën më dysh. Nga trupi i Anadollakut, që u shtri sa gjërë gjatë midis steresë e detit, ja dhanë tri fiskaja gjaku, që skuqën ujin e Adriatikut.

— Ua! Ua! Ua! — klithën robinjat e haremit, që mbetën të tmeruara e njëkohësisht të gëzuara në dritare me krehëret në dorë e me flokë të lëshuara mbi supe.

«— Ju bëjnë të fala vajzat e Malësisë! Thyeni dyert e dilni jashtë në liri! Bisha e Anadollit mbaroi! — dha kushtrimin Sokolesha majë kalit. Këtë

kushtrim e përsëriti edhe Gjon Shigjeta, i cili njëkohësisht vuri re se nga jatagani i mikut të panjohur rrëshqiti gjaku pika-pika dhe bëri dy vija të trasha të kuqe mbi çekçiret e bardhë.

Dhe para se jeniçerët të mblidhnin veten e t'i ndiqnin për t'i kapur, dy kalorësit vringëlluan jataganët, që pikonin akoma gjak të ngrohtë e ja dhanë me të katra: Vrap e vrap, e trok e trok; vrap e vrap, e trok e trok ikën tërë ditën e tërë natën! Në kufi të trojeve të Gjon Shigjetës u përqaftuan e i shtrënguan duart njeri tjetrit fort e fort si vëllezër të pagëzuar me gjakun e armikut dhe dhanë fjalën e nderit që gostinë e vllamërisë ta bënin pas tri javësh, ditën e martesës së Gjonit me perrinë e Malësisë, me Sokoleshën e Shpend Malokut.

Vajza kalorëse përsëri vrap e vrap dhe trokthitrokthi arriti në kullën e saj e u doli përpara prindëve:

«— Mos u bëni merak, baba e nënë, se Anadolakut ja preva kokën dhe, si më shihni, u ktheva shëndoshë e mirë! —

Nënë e babë me lot në sy e përqaftuan dhe e shtrënguan në gji.

«— Ditë më të bukur e më të lumtur se sot kurrë s'kam parë! — psherëtimi me ngashërim Shpend Maloku. «— Lum babai që të ka sokol mbi sokola! —

Aty për aty i dërgoi fjalë Gjon Shigjetës, që të vinte të merrte nusen pas tri javësh, ashtu si e kishin lënë fjalën.

Ranë lahutat e çiftelitë, gjëmuan gërnetat e fyajt, u tund e tërë Malësia! Sokolesha zveshi xhubletën e bardhë të çupërisë dhe veshi xhubletën e zezë rrathë-rrathë me atë fund të gjërë si shatorre e hapur, nën të me një qëndismë të bardhë. Ngjeshi kraharorin me krohlin me ato pala-pala e me ato qin-

dizma të zeza e me supe tërë ravijëzime, vuri gryk-sën e bardhë mbuloi gjirin, ngjeshi belin me postavën, tërë qëndizma e pulla metalike e, mbi postavë, lidhi dy zinxhirka: në njerën mbante një thikë të vogël, shënjë kjo e amvisës së mirë, dhe në tjetrën kish-te varur një mashë të vogël, që sa herë të donte krushku të dridhte cigaren, kjo, si nuse, të ishte gati t'i jepte thëngjill me atë mashë të vogël. Vuri përpara pështjellëkun, një futë kadifeje, mbathi shpu-tet tërë hoje të kuqe dhe kallcet ngjyrë gushëpë-llumbi, që ja mbuluan kërcinjte gjer në gju. Mbësh-tolli flokët me degërminë, tërë tantella e mbi të ngje-shi dallfesin e bardhë të zbukuruar me pare! Pas-taj... vuri duvakun!

Përsëri ranë lahutat e çiftelitë! Përsëri gjëmu-an gërnetat e fyejt! Përsëri u tund Malësia e tërë! Gjon Shigjeta dërgoi njëqind dasmorë për të marrë nusen.

Sa shkeli nusja, llamburiti kulla e dhëndërit, por zemra e Gjonit ishte ndarë më dysh: një merak i madh i rëndonte në kraharor.

Sokolesha ja vuri re dhe e pyeti:

«— Qofsh shëndoshë, o zoti im! Pse më rri i mvrejtur dhe i pikëlluar në këtë ditë të madhe? Mos të kam koritur? Mos nuk të kam nderuar dasmorët, apo mos nuk të kam nderuar nënën plakë? —

Gjon Shigjeta buzëqeshi me hidhërim dhe i hapi zemrën:

«— Ti për mua je vajza më e bukur e Malësisë! Prindët e tu i kanë pritur sa s'ka më mirë dasmorët e mi! Ti e ke nderuar shumë nënën time! Me gjithë këtë, zemrën e kam vrer, sepse vëllami im më i mirë, më besnik e më trim, nuk më erdhi në dasmë, sipas fjalës që kishim lënë. Vëllamërinë tonë e kemi pa-gëzuar me gjakun e armikut dhe gostinë e kësaj vë-

llamërie do ta bënim ditën e martesës sime! Mirëpo... —

Dhe i tregoi se si i kishte vajtur në shtëpi, se sa i zoti ishte në jatagan e në lahutë, në çifteli e në fyell dhe se si e kishin vrrarë bashkë Bajloz Anadollakun.

Nuses i hipi një nur më i madh: i ndritën sytë si yjtë në qiell, i qeshi buza si gonxheja majë gjëmbit, iu çel fytyra si lulbore. Ajo iu afrua arkës së nusërisë, të zbukuruar me lule e me hardhi. Ngriti kapakun dhe nxori dhuratën, që kishte sjellë për dhëndërin. Në prani të të gjithë dasmorëve edhe të vetë nënës plakë, nusja me të dy krahët e shtrira ja vuri këtë dhuratë dhëndërit në prehër. Të gjithë u patakën: dhurata e nuses ishte një palë rroba burri me çakçire me dy vija të thella gjaku edhe mbi to me një jatagan me gjak të përtharë!

Shtangën të gjithë!

Por... nuk shtangu Gjon Shigjeta: Ai, si rrufe, brofi në këmbë:

«— A vërtet ti ishte vëllami im? — pyeti tërë ankth e tërë ngashërim. —

Buzëgazi i nuses, nuri i saj, vështrimi i saj ja pohuan të gjitha dhe ai të gjitha këto ua tregoi fill e për pe dasmorëve të tij.

Këta të njëqind dasmorë u bënë njëqind kasnecë, që dhanë lajmin anëmbanë e t'u shkul e tërë Malësia, i madh e i vogël, për të nderuar Sokolëshën e tyre, që i kishte shpëtuar nga Bajloz Anadollaku dhe t'u bë një dasmë që kurrë s'e kishin parë e s'e kishin dëgjuar ato anë!»

SOKOL TORVIOLLI

SHKËMBI I PISHKASIT po uturinte nga pistoletat e minatorëve, që ishin kredhur në zemrën e malit për t'i marrë mineralin e çmuar, kromin. Teksa tej qyteza industriale e Domosdovës zbardhonte me ato ndërtesa të bukura, që oshëtinin nga zhurmat e fëmijëve çapkenë. Edhe pse ishte mesi i verës, flladi e flladiste pa pushim atë fushëzë dhe të kënaqej shpirti duke soditur rrjedhjet e ujërave mespërmes gjelbërimit të barishteve, që u ngjanin grivës së kujave të hazdisur.

— Kjo luginë sot gëzon lavdinë e punës, ndërsa më parë ka gëzuar edhe lavdinë e shpatës! — thotë Mentor Agimi, një mësues plak në pension, që e dinte historinë e çdo pëllëmbë toke të këtij vëndi. — A ju kujtohet lufta e famëshme e Torviollit, ku Skënderbeu me ushtrinë e vet i sulmoi turqit si shigjetë mes për mes dhe i bëri fërtele? Ja, thuhet se kjo fushëzë e Domosdovës quhej atëhere Torvioll!

Mësuesi na ftoi t'i shkonim pas. Iu ngjitëm bregores dhe vajtëm gjer atje ku mbaronte bjeshka e fillonte një pyll, pyll i tërë prej borigash.

— I shihni këto gërmadha? — na pyeti. — Këto janë gurë, që janë përkëdhelur nga duart e Sokol Torviollit e të nënës së tij, Mrikës. Janë gurë që janë larë kushedi sa herë me gjakun e qenit turk. Janë të vetëmit dëshimtarë të gjallë të trimërive dhe të

heroizmave të Sokol Torviollit me shokë. Ndofta një dëshmimtar i vërtetë është edhe ai lisi atje në thellësi. Ndofta, ndofta!

Ne bëmë veshët pipëz. Mësuesi i nderuar vazhdoi:

— ...Ka qenë mesi i vjeshtës së vitit 1478. Në Krujën e Skënderbeut kishte hyrë turku dhe, sipas porosisë së Sulltan Mehmetit II, jeniçerët e kishin bërë shkumb e hi qytetin, ndërsa krutanët i kishin vënë në satër: burrat që kishin zënë, i kishin therur pa mëshirë, kurse gratë e fëmijët sërë-sërë dhe varg e varg, të lidhur me zinxhirë, i kishin nisur tutje andej, nga piqej buka në diell.

Një ditë vjeshte tri sërë robërish, të lidhur me vargonj të rëndë, ecnin njeri pas tjetrit nëpër shtigjet e nëpër monopatet e malësisë së Krujës e të Matit, të Tiranës e të Elbasanit, të lodhur, të uritur, të zvetënuar. Njëri varg ishte vetëm prej vajzash, në lule të rinisë, gjashtëmbëdhjetë-njëzetvjeçare, të bukura që t'i pije në kupë. Çdo hap që hidhnin, çdo «ah» që nxirrnin, ishte një mallëkim për turkun qen, që i zvariste tutje tej në dhe të huaj duke i ndarë nga gjiri i prindërvet, nga prehëri i të dashurve, nga puna e tyre e përditëshme, nga avlëmendet, ku endnin rrobot e nusërisë, nga gjilpërat e nga shtizat e tyre, me të cilat mpleksin dhe qëndisnin pajën e tyre! Kush do t'i gëzonte tani ato?

Përbri tyre ecte vargu i dytë i përbërë vetëm nga nuse të sapomartuara, nuse që t'ua prisje kryet e të merrje malet! Ato mallkonin bishat turke duke mvrejtur vetullat e duke derdhur lot e vrer, sepse i kishin ndarë nga trimat e tyre e nga foshnjat e tyre, të cilat, çdo mëngjes, sa t'u delte gjumi, do të fillonin të qanin me ngashërim e në mes lotve, me

miturinë e tyre do të pyesnin: «Ku është mëma? Pse s'po vjen akoma? Më mori malli shumë!»

Kurse vargu i tretë ishte përbërë vetëm nga lulla e rinisë, nga djem katërmbëdhjetë-gjashtëmbëdhjetëvjeçarë, të cilëve u ishin vrarë etërit ndër beteja, kurse nënat u ishin therur nëpër praqet e shtëpiave.

Në krye të vargut të nuseve shkonte një e bukur e nisur dhe e stolisur si nuse, ndërsa në krye të djemve shkonte një trim, që kishte vënë brisk në faqet për herë të parë, se që të dy këta ishin përgatitur të martoheshin atë natë, por. . . i përfshiu shtërgata!

Në ballë të vargut të nuseve ecte Mrika, një perri e vërtetë e maleve tona. Ishte shtatzënë, në të nëndin muaj. Ecte e rënduar nga vargonjtë, e rënduar nga barra; e rënduar edhe nga mundimet e rrugës përmes atyre shtigjeve, shkrepave, honeve e skërkave të pafund.

Të tri radhët e robërve ecnin me hap të rëndë e të këputur. Tringëllima e llahtarshëm i zinxhirëve të rëndë tretej me rënkimin edhe më të rëndë të robërve, rënkim ky që u gufonte nga thellësia e shpirtit të tyre.

«— Hajt, përpara arnautë! Në Anadoll! Në Anadoll! . . . Hanëme! Jeniçerë! — Këto fjalë i përsërisnin jeniçerët duke u vërvitur mi krye kamxhikun. Me këto fjalë ata kinse u jepnin zemër. Sa të venin në Anadoll, në xhenetin e tyre të mrekullishëm, fatkeqësitë e këtyre arnautëve të rinj do të mbaronin një herë e mirë: djemtë do të bëheshin jeniçerë si ata vetë, bisha të plotfuqishme e besnikë të Padishahut të madh, do të sulmonin popujt e lirë e do t'ua rrëmbenin lirinë e begatinë, do të vrisnin e do të prisnin sa të ngopeshin me gjak, do të rrëmbenin gra e

vajza të bukura. Kurse ato arnautkat e bukura ishin lidhur tani në ata vargonj të rëndë, e që ecnin me këmbë të zbirthura e të gjakosura, sa të venin në Anadoll, do të bëheshin hanëme nëpër haremët e pashallarëvet. Ndofta ndonjëra prej tyre mund të kishte fatin të bëhej edhe e zgjedhura e Padishahut, e hies së perëndisë në tokë!

«— Jashasën Padishah! Jashasën! — Rroftë Padishahu ynë! Rroftë! Allah! Allah! — faleshin jeniçerët në kohët e caktuara të ditës dhe vetëm atëhere çlodheshin robërit një copë herë. Por lutjet e jeniçerëve mplekseshin me psherëtimat plot mallëkim të robërve!

Mrika - perri vuante më shumë dhe i pengonte të tri sërët e robërve, të cilët ishin lidhur njeri me tjetrin me nga një zinxhir në dorën e majtë e me nga një zinxhir në këmbën e djathtë.

Bylykbashi, që i shoqëronte robërit, ja kishte vënë syrin Mrikës. Ai ecte kaluar vetëm pranë saj, çlodhej e hante bukë vetëm pranë saj. Largohej vetëm kur i falej Padishahut dhe Allahut!

«— Eh, moj arnautkë! Hanëme do të të bëj në sarajin tim atje në Anadoll. Pashai im patjetër do të ma bëjë këtë të mirë! Hajde, hajde, tundu, shko përpara! — e nxiste duke përdredhur mustaqet e duke u kapardisur.

Bylykbashit i ishte mbushur tutka se nuk e kapte asnjë plumb e asnjë majë shpate, sepse në qafë kishite varur një hajmali të madhe trekëndëshe, të mbështjellë me një copë meshini e me një cohë mëndafshi të kuq. Të gjithëve ua kishte treguar të fshehtën e kësaj hajmalie: Ai ishte një nga të lumturit, që kishin hapur varrin e Skënderbeut. Me urdhër të vetë pashait eshtrat e Skënderbeut zulmëmadh, të cilin nuk e kishte prekur as plumbi e as shpata e osman-

llinjve, iu genë shpërndarë si hajmali më trimave të ushtrisë turke, sidomos zabitëve.

Ecnin e ecnin! Ecnin e ecnin! Shllap-shllup nëpër baltovinat! Shtrak-shtruk nëpër shtigjet e monopattet dhe vazhdimisht i shoqëronte vrring-vrringu i vrazhdë e i rëndë i vargonjve.

«— Vramëni këtu! Çap nuk hedh më tutje! — klithi Mrika një herë e dy, një orë e dy! Liromëni! — lutej e rënkonte e mbytur në djersë të ftohtë dhe në ankth.

«— Fusha e Torviollit! — pëshpëriti me një farë llahtarie Bylykbashi.

«— Fusha e Torviollit! Fusha e Torviollit! — u përsërit ky emër si një emër i shenjtë, si një lutje, si një shpresë, që shkrepri papandehur në zemra rrobërve.

Vërtet kishin arritur në fushën e Torviollit, ku për herë të parë kishte vënë krahë lavdia e Skënderbeut, lavdia shqiptare! Midis robërve kishte nipër e mbesa, medje edhe bija të atyre ushtarëve të Skënderbeut, që kishin marrë pjesë në atë betejë të lavdishme.

«— Torvioll! Torvioll! Lavdi e shqipëtarve!

«— Torvioll! Torvioll! Varr i qenit turk!

Mrika ishte e bija e njerit prej të njëqind ushtarëve, që i kishte zënë robër trashëtari Ballaban Pasha në betejën e Vajkalit në prillin e vitit 1465 bashkë me të tetë oficerët famëmëdhenj të Skënderbeut. Mrika dhe shumë shoqe të saja e mbanin mend mirë kur ishte dhënë mandata anëmbanë Shqipërisë se sulltani i kishte rjepur të gjallë, i kishte prerë copëcopë dhe ua kishte hedhur qenve që t'i hanin, sepse asnjëri prej tyre nuk desh të mohonte sisën e nënës, nuk desh të mohonte Shqipërinë mëmë, si pat bërë Ballaban trashëtari nga Badera e Matit!

Kjo fushë e Torviollit me kujtimin e betejës së famëshme edhe kujtimi i masakrës çnjerëzore që u qe bërë etërve të tyre u dhanë zemër Mrikës dhe vajzave e nuseve e pinjollave me buzët me qumësht.

Mrika nguli këmbë që të ndalej. Jeniçerët u detyruan të qëndronin. Liruan Mrikën nga prangat e ajo u fut në atë koriye.

Pas ca kohe u dëgjuan të virra fëmije: Mrika kishte lindur djalë.

«— Lindi trashëgimtari i lavdisë së Torviollit! — pëshpëritën krenarë djelmoshët gjashtëmbëdhjetëvjeçarë.

«— Në fushën e Torviollit lindi nipi i Skënderbeut! S'ka ugur më të mirë! — përgëzuan nuset njëra tjetrën.

«— Ugur i mirë! Ugur i mirë! — thirrën plot shpresa edhe virgjëreshat.

Nëna e re e lau foshnjën me lotët e saj dhe e mëndi me kujtimin e betejave të Torviollit e të Vajkalit. Pastaj me foshnjën në prehër ajo dolli përpara vajzave, nuseve e djemve shqiptarë e përpara jeniçerëve.

Të gjithë shqiptarët i uruan fat të bardhë, të gjithë vunë buzën në gaz. Ish hera e parë që buzëqeshën ata robër! Ndërsa foshnja qante: Ua! Ua! Ua!


«— Sokol! Sokol! — t'ja vemë emrin! — tha dikush nga të rinjtë.

«— Si Sokol t'u bjerë kokës këtyre qenve! — uruan vashat e nuset! Ashtu uroi edhe Mrika.

«— Sokol! Sokol! Sokol! — brohoritën të tjerët: Dhe koriet, malet, bjeshkët e Torviollit dhe kjo luginë këtu oshëtinë nga ky emër: Sokol!

Mirëpo Bylykbashi u tërbua:

«— Hidhe foshnjën, se s'ja kemi ngenë të mbaj-



më me vete edhe krimba të tillë! Hidhe, se ndryshe ta vrava mu në prehër! — iu kërcënuua.

«— Vramë mua, por jo atë! — lebetitej nëna fatkeqe.

«— Ty nuk të vras! Ty as nuk të rrah! Bukuria jote më duhet mua! Hidhe foshnjën, se ndryshe ta vrava mu në prehër! — përsëriti i tërbuar Bylykbashi dhe nxori jataganin.

Mrika klithi me lemeri duke shtrënguar Sokolin në gji.

«— Nuk e shqit foshnjën nga gjiri im! Vramë mua, mua, ja, këtu, mu në fushën e Torviollit! Vramë! —

Bylykbashi ngriti jataganin, dhe...

«— Aman jo, jo foshnjën! Jo Sokolin! Do ta le ja, këtu në pyll! Ndofta ka fat e gjen ndonjë dhe e rrit! Ndofta... —

Mrika e lahtaritur vajti rëzë pyllit. Me ndihmën e dy shoqeve djepin ja bëri nga degët e ahut e të borigës, poveskën, ja bëri nga barishtet e gjata, duke i gërshetuar njera me tjetrën, ndërsa pelenat më gjethe bari të gjera e me fier; pastaj kryqëzoi disa degë të borigës dhe aty e vendosi djepin si në shtrat.

E i këndoi, i këndoi ninullën e parë, ninullën e fundit: Kur të frynte veriu i hollë, të kujtonte se po e përkundte nënë-zeza; kur të binte shi të kujtonte se nëna po e lante, kur t'i kalonin pranë Sorkadhet, të kujtonte se po i vinte e ëma që t'i jepte sisë! Veçse kur të frynte shakullina majë maleve, të dinte se shqiptarët sulmonin qenin turk, të prirë nga zulma e të madhit Skënderbe! Dhe në këto sulme merrnin pjesë edhe shpirtërat e shqiptarëve të rënë në beteja me shpatën në dorë, merrte pjesë edhe baba-gjyshi që Sulltani ua hodhi qenve, edhe ati Petrika,

që ish arratisur diku maleve me jatagan në dorë e me kraharor të ndezur për hakmarrje.

«— Mjaft dërdëllise! Lere, se ta vrava! — iu kanos përsëri Bylykbashi dhe e shkundi rëndë pas krahut.

Mrika e shtrëngoi foshnjën në gji për herë të fundit, e puthi për herë të fundit, e përkundi për herë të fundit:

«— Era e Torviollit të bëftë trim si Skënderbeu, o bir, dhe ardhsh në Anadoll e shpëtofshtë nënën tënde nga skllavëria! Ora e Shqipërisë të qoftë kurdoherë pranë! —

Të tri vargjet e robërve muarën rrugën përsëri dhe e lanë prapa fushën e Torviollit. Që nga larg dallonin rrëzë pyllit e rrëzë fushës së Torviollit, mbi degët e borigës, djepin e Sokolit që e përkundte era.

Filloi të vesojë dhe të fryjë një suferinë. Por robërve shqipëtarë u dukej se ajo erë ishte psherëtima e nënës së re dhe ato pika shiu ishin lotët e Mrikës dhe të foshnjës së saj, të Sokolit të braktisur!



Sokolit vërtet nuk iu nda kurrë Ora e Shqipërisë: Aty më tej, fshehur midis degëve gjetheshumë të një lisi shekullor, një plak shqiptar, i arratisur nga turqit, i kishte parë të gjitha, i kishte dëgjuar të gjitha. Kishte parë nënën, që lindi foshnjën, kishte dëgjuar kujt e shpresat e saja, kishte dëgjuar urimet që i dha foshnjës dhe emrin, që i vunë, Sokol.

Sa ishin larguar jeniçerët me vargjet e robërve shqiptarë, plaku Gjini Kthjella kishte zbritur nga lisi, e kishte marrë foshnjën dhe e kishte shpënë thellë në pyll, në një shpellë. Atje kishte ngritur follenë e re me të shoqen e me të dy nipërit jetimë. I biri u

ishte vrarë duke luftuar në radhët e ushtrisë së Skënderbeut. E vetmja pasuri e plakut ishte një dhi. Me qumështin e asaj dhie edhe me ajrin e pastër e të lirë të këtyre maleve e bjeshkave u rrit Sokoli, u rrit e t'u bë një djalosh i pashëm, shtatgjatë, e shpatullgjerë si një lis. Kur filloi Sokoli të kuptonte, plaku ja tregoi se si e se ku kishte lindur.

Ja mbajti emrin e vërtetë, që ja kishte vënë e ëma me robërit e tjerë dhe i vuri si llagap emrin e vendit ku lindi: Torvioll! — Sokol Torvioll!

Skllavëria turke shëtiste skutë më skutë nëpër Shqipëri, edhe skutë më skutë ndeshej me shpatën e përgjakëshme shqipëtare!

Sokol Torvioll më vonë u bë i tmershëm për turqit. Si shokë lufte kishte të dy nipërit e Gjin Kthjellës. Çeta e tyre shtohet dita ditës. Dita ditës shtohet edhe tmeri i qenit turk!

Që në fëmëni atij pareshtur i oshëtinin në vesh fjalët e nënës, fjalë që ja kishte përsëritur aq shpesh plaku zemërbardhë:

«Era e Torviollit të bëftë trim si Skënderbeu, o bir, dhe ardhsh në Anadoll e shpëtofshe nënën tënde nga skllavëria!»

Edhe kur flinte, edhe kur çlodhej, edhe kur endej pyjeve e shkrepave me jatagan në dorë, edhe kur sulmonte jeniçerët shtigjeve e grykave, Sokol Torvioll sikur dëgjonte zërin e nënës, psherëtimën e saj të dhimbëshme:

«Shpëtomë, Sokol, nga skllavëria!»

Që sa mbushi gjashtëmbëdhjetë vjeç, vendosi të merrte rrugën e gjatë të Anadollit për të çliruar t'ëmën. As fytyrën ja njihte, as emrin ja dinte, as vendin se ku ishte degdisur nuk e kishte dëgjuar!

Megjithatë vendosi ta çlironte!

Sokol Torviolli nuk ishte rritur me sisën e shtojzavalleve, nuk kishte as shtatin e viganëve, as forcën e dragonjvet! Ai ishte si gjithë moshatarët e vet, veçse më i pashëm, më shtathedhur, më i shëndoshë, më i vendosur, më trim se shumë të tjerë. Në kraharonin djaloshtar kishte zjarrin e hakmarrjes për nënën e skllavëruar, për babanë, që s'e njihte fare, për tërë ato të zeza, që u punonin osmanllinjte shqiptarëve, vëllezërve të tij.

Me këtë urrejtje në gjoks mori rrugën e Anadolllit e veproi ashtu si e pat këshilluar plaku i urtë e zemërbardhë Gjini Kthjella: mësoi disa fjalë turçe sa për nevojat e veta, u vesh si pramatar turk dhe u fal me Shqipërinë.

Eci, eci, eci!

Anadulli i largët! Anadulli i madh!

Ku ishte e ëma? Si do ta gjente?

I ra pash më pash Edrenesë, Izmirit e pastaj Stambollit me ditë e me javë, me muaj e me vjete! Në këtë ecë e jakë të pafund — veç fjalëve turçe, që dinte, përdorte orë e çast edhe një thirrme që tingëlonte si melodi:

«— Jam nga Torviolli! Jam Sokol Torviolli! —

Këto ishin fjalët magjike, me të cilat shpresonte të gjente nënën e panjohur; këto ishin fjalët magjike, që e përtërinin orë e çast, që i shtonin forcat e shpresat për të duruar mundimet e urisë, të vetëmisë, të përbuzies e të mallit, që e zhuriste për «mëmën» Shqipëri. Herë-herë ulej qosheve, sofave ose mejdaneve dhe ja merrte këngës pleqërishte: Përpara syve të tij shkonin radhë radhë pyje e korie, bjeshka e male, fusha e lugina me kasolle e me kulla haliemëdha, por krenare, të etura për liri. të gatëshme për të vringëllitur jataganët! Hieja e Skënderbeut, lavdia e tij u jepte krahël

Shpesh herë kalonte buzë Bosforit: I kënaqej shpirti, kur shihte ujërat e detit të shkëlqenin aqë mrrekullisht nga rrezet e diellit, ose nga drita e hënës. Dhe, kur hidhte sytë në thellësi të valëve, ngazëllohej dhe ja merrte këngës pleqërishte duke ndjellë ujërat e kaltëra të Adriatikut tonë. Në fund të këngës thërriste me forcë të re e të përtëritur:

«— Eeee! Jam Sokol Torviolli! Jam nga Torviolli! —

Dhe atëhere nëpër praqet e shtëpive të fukarenjve zgjatnin krye gra të mbështjella me çarçafe si korba, kurse përmes grillave të sarajeve xixëllonin sy të ndezur të hanëmeve, por... sytë e nënës së tij nuk dukeshin gjekundi!

Por ata sy e përgjonin pa ditur ai, pa ditur ajo: një grua me një çarçaf të zi hedhur mbi fytyrën, me sy të zez të mëdhenj e të shuar, gjysmë e kërrusur, me një bohçë në dorë, dilte prej një shtëpize përdhese të Gjyrylidi Sokakut dhe me hapa të shpejta kalonte e druajtur pranë tij, bënte sikur do të blente ndonjë gjë, shkonte tutje, kthehej përsëri e... pastaj zhdukej prapa derës së shtëpisë së saj.

Zhdukej! Kjo është një fjalë! Ajo vinte faqet mbi grillat e kalbëzuara të dritares, dhe me sytë e zez e të venitur përgjonte me orë të tëra, që të kalonte përsëri ai djaloshi i ri e t'ja merrte këngëve pleqërishte! Oh, këngëve pleqërishte, këngës shqipëtare! Ajo e priste dhe e përcillte duke derdhur lot prapa grillave!

Por një ditë, në Gjyrylidi Sokak, u dynd një mizëri njerëzish: prapa grillave të shtëpive, nëpër ballkone e nëpër mure, nëpër degët e pemëve buzë rrugës, nëpër dyer e nëpër sofate ishin grumbulluar tërë kërshëri mijëra e mijëra osmanllinj, që duartrokisnin, që brohorisnin e që valavitnin flamuj të ve-

gjël të mëndafshhtë me gjysmë hëne në mes. Sokoli nuk arriti të kapërcente rrugën e të shkonte të zinte qoshkun përballë për të shitur sherbetin e tij të famshëm! U detyrua të strukej nën dritaren e shtëpisë së asaj gruas. Ajo e pa dhe nuk ja shqiti sytë. Kur... ja, papandehur, gjëmuan zurna dhe daulle:

«— Po vijinë! Po vijinë! — kjo fjalë kaloi gojë më gojë dhe pëshpërma e tyre u mbyt nga gjëmimi i topave dhe nga fluturimi i pëllumbave. Turma, që ishte prapa, u shty, u shty dhe u ngatërruan e u përzien niëri me tietrin hamaj e tregëtarë, lypës e dervishlerë, hoxhallarë e hanëme, burra e gra!

«— Po vijinë! Po vijinë! — fjala mori dhenë dhe turma u përkund si një dallgë e madhe. Sokoli, duke shtrënguar midis duarve e kraharorit ibrikun e gjatë prej teneqeje, të zbukuruar me ato zinxhirka e me ato ornamente, e që shkëlqente aq fort në atë diell, vështronte në të diathtë nga kishin filluar të dukeshin pashallarë, ministra, princër veshur me uniforma tërë salltanete.

«— Ja ku është... — kaloi valë-valë kjo fjalë dhe Gjyrrulldi Sokaku u tund nga brohoria:

«— Jashasën Padishah, Jashasën! Rroftë padishahu ynë! Rroftë!»

Sulltan Bajaziti i dytë po kthehej me salltanetet e tija të zakonshme nga xhamia e Mehmet Fatiut, ku kishte vaitur të falej për Kurban-Bajram. I rrethuar me një numur të madh eunukësh të veshur me kadife ngiyrë kafeje edhe me adiutantë me pëndë palloi mbi turbanet e tyre e me jataganë në duar, Sulltan Bajaziti i dytë shkonte kaluar mbi një kalë të bardhë, duke tundur kryet djathtas e majtas me gjithë piskulet e festes.

Turma dendësohej e shtyhej, dhe sa kaloi sulltani, muret e njerëzve zbërthyen si rrëkëllima orti-

gesh e ranë njeri mbi tjetrin. Sokoli, që ishte në radhët e prapme, u përplas mbi disa dervishlerë, sherbeti i derdh mbi çallmat e dy hoxhallarëve e mbi çarçafet e ca hanëmeve, ndërsa po në atë kohë një dorë e butë e tërhoqi pas e ai, si i shastisur, u ndodh në një oborr të vogël.

«— Shpëtova! — ja bëri në mënyrë të vetvetishme Sokoli në gjuhën shqipe.

«— Shpëtove! Po, po, shpëtove! — i përgjegj po në gjuhë shqipe hanëmeja që e kishte tërhequr.

«— Si? Mos folët arnautçe? — pyeti i habitur duke mos iu besuar veshëve.

«— Arnautçe!.. Arnautçe.. — Këto fjalë ajo i theksoi me aq lektisje e me aq afsh sa sikur i nxirrte nga një kraharor i ndezur furrë.

«— Jam arnaut! Jam Sokol Torviolli! — i përsëriti këto fjalë të magjishme me melodinë, që i ishte bërë zakon ato tre vjet, duke u endur poshtë e lart nëpër Edrene, nëpër Izmir e sidomos nëpër Stamboll.

«— Sokol Torviolli! Sokol Torviolli! — përsëriti ajo me një ankth sikur po i përvëlohej kraharori i ndezur furrë. Ngriti perçen e zbuloi dy sy të zez, të mëdhenj, me një ballë të gjërë, me dy faqe të zbeta, me dy buzë të fishkura.

«— Kërkoj nënën! — vazhdoi djaloshi sikur po i rrëfehej perëndisë. — Sa mirë që ditke shqip! Më ndihmo të gjej nënën! As emrin s'ja di, vendin s'ja di! Tetëmbëdhjetë vjet më parë kaloi si skllave nga fusha e Torviollit; atje më lindi, atje më pagëzoi Sokol, atje më la. . .

«— Edhe unë kam njëzet vjet që kërkoj djalin e vajzën, që kërkoj burrin e zi! Po jam skllave e shitur si nëna jote! — i hapi ajo zemrën dhe shtoi: «— Ne të dy jemi shqipëtarë, Ti nuk je djali im i vër-

tetë, po zemra ma do të të kem djalë! Zëre se ti je im bir e unë nëna jote, bir! — u shkri ajo në vaj dhe u hodh në krahët e tij.

«— Shpërmë në vatan! Ah, vatan, vatan! — shtoi ajo me ngashërim. Pastaj, e vendosur, i mëshoi zërit: «— Atje do të vdes duke luftuar kundra qenit turk! —

Këto fjalë e tronditën Sokolin! Mund të kërkoj kështu edhe tridhjetë vjet nënën e të mos e gjej kurrë! Unë duhet të hakmerrem ashtu si thotë kjo e vojtura, duke luftuar qenin turk mu në malet e Shqipërisë!

Ajo ja ndërpreu mendimet.

«— Dëgjomë, eja të shkojmë në Shqipëri të hakmerrem duke luftuar kundra qenit turk!

«— Edhe pse nuk je nëna ime e vërtetë, ti më shpëtove! Më shpëtove! Ti je nëna ime! — i tha Sokoli i ndezur prush.

• • •

Dhe, që atë çast, duke çarë përmes gjurulldisë së Gjyryllidi Sokakut, që të dy muarën arratinë.

Pas një rruge të gjatë e plot mundime u kthyen në Shqipërinë - mëmë. Ajri i Torviollit e i Malësisë, ajri i Shqipërisë e dashuria për vatanin menjëherë e përtërinë nënën e cfilitur. Ajo u bë krahu i djathtë i çetës kryengritëse me kapedan Sokol Torviollin. Atje, ku diku pat lindur e u pat braktisur Sokoli, ngritën kullën e tyre. Ajo kullë nuk u bë vetëm vatër e ngrohtë për shqiptarët, që merrnin malet nga të zezat e pushtonjësve turq, por u bë edhe kala, një nga kalatë më të forta e më të tmershme për qenin turk.

Shpata e Sokol Torviollit, e forcuar edhe nga krahu i nënës së panjohur, u bë tmeri i armikut dhe shpresë shpëtimi për malësorët tanë...

Mësuesi plak Mentor Agimi na vështroi krenar dhe përsëri i mëshoi zërit:

— *Këto gërmadha këtu, ku jemi ulur ne, janë përkëdhelur nga duart e Sokolit, nga duart e nënës shqiptare e nga duart e mijëra luftëtarëve të tjerë të lirisë! Këta gurë janë dëshmitarë të gjallë të trimërive të tyre! —*

Dhe neve na u duk se kënga e pistoletave të luanëve tanë të minierës u bashkua e u shkri me jehonën e këngës shekullore të vringëllimës së shpatave për liri dhe të melodisë së vjetër:

«— Eeee! Jam arnaut! Jam shqiptar! Jam Sokol Torviollil!»

DIVI I MALIT TË THATË

*Ty, o Bendo Shapërdani,
Shtatë okë të vjen dajlani,
Gjer Stamboll të vajti nami...*

(Këngë Popullore)

Me kërrabe në dorë e me gunë në krahë, i nxirë e i hakarritur, u ndal mbi kufomën e t'et, të cilën sa e kishin sjellë fshatarët dhe e kishin shtrirë në mes të oborrit. Bariu djalosh i nguli sytë të vdekurit. Vija, gjaku i çanin ballin e fytyrën, ndërsa dora e djabatë i kishte ngecë mu në kraharor, sikur desh ta mbyllte plagën e vdekjes, që i kishin hapur plumbat e turkut. Përbri i kishin vënë dajlanin e rëndë, ndërsa në silah kishte të ngulur një çift koburesh dhe vezmet plot me fishekë e me barut. Kindat e fustanellës nuk i dalloheshin nga vijat e gjakut.

Përpara asaj kufome me armaturë, Bendua njëzetvjeçar shtrëngonte vetëm kërrabën në dorën e majtë, kurse me të djathtën sakaturën. Kraharori i regëtinte nga gjëma e madhe, që e kishte pllakosur familjen e tij; sytë iu ndezën prush dhe mezi e mbante vehten. Kërkonte të hakmerrej, patjetër të hakmerrej sa më shumë, sa më parë.

Hodhi vështrimin rreth e rrotull; mbi kryet e të vrarit ligjëronin graria. Midis tyre edhe e ëma.

Në këmbë a ndenjor rrinin fshatarët pikë e vrer. Përballë nxinin muret e shtëpisë së djegur të Shapërdanëve dhe kutërbimi i piskuleve e i plaçkave të shkuosura ndehoj anëmbanë fshatit bashkë me llahtarinë, që kishte pllakosur.: «Ç'fat na pret ne? Ç'fat i pret vajzat tona?, fëmijët tanë?» — pyesnin tërë ankth nënat dhe etërit, vëllezërit dhe motrat; pyesnin edhe fëmijët në bark të nënës.

— Pse ma vranë babanë? Pse ma bënë shkumb e hi shtëpinë? Pse më rrëmbyen haraç motrën e vetme Marën? — Pse? — pyeste edhe Bendua tërë ankth e tërbim, tërë urrejtje duke vështruar kufomën e t'et.

Kujet dhe ligjet e grarisë ngriheshin si një mallëkim kundra atyre, që u shkaktinin këto të zeza e që u sillnin këto lemeri.

Bendua rrotulloi sytë anëmbanë: ndeshi me vështrimin e heshtur dhe të pikëlluar të fshatarëve, me ballin e tyre rrudha-rrudha, me buzët e përthara, me flokët e thinjur par kohe.

— Ti ende s'i ke lëshuar kërrabën, sakaturën dhe gunën e më endesh «i lirë» maleve! Mirëpo a e pe sot se ç'ngjau? Jeniçerët jo vetëm, që na muerën haraç njëqind qese asprash, por, si çdo mot, na rrëmbyen nga gjiri i nënave pesë foshnje djepi, na rrëmbyen nga gjiri i familjeve mu në lule të rinisë tri vashëza! Atë fat të zi pati edhe motra jote, Mara. Edhe babai yt u vra, ja, për t'u hakmarrë për këto turpe e ukubete të llahtarëshme!

As Bendua nuk e kuptonte se nga i vinin këto fjalë: mos regëtinin nga kraharori i nënës së zezë e të grave të tjera, që ligjëronin? Mos regëtinin nga kraharori i atyre burrave të heshtur e të vrerosur? Apo mos dilnin nga thellësitë e tokës së mbytur në gjak e në lot? Ishte një regëtimë sheku-

llore, një rënkim i mëmës — tokë dhe çdo «ah» si hell i skuqur i shponte kraharorin, i ndiste zemrën, i bënte sytë flakë, i forconte krahun për... hakmarrje!

Ra mëgjunjëzi në këmbët e babait një herë, dy herë, tri herë. U përul dhe i puthi ballin e gjakosur; pastaj i puthi me afsh dorën, atë dorë, që kishte hequr këmbëzën e dajlanit kushedi sa herë e që kishte vërvitur jataganin për të mbrojtur nderin e mallin, atë dorë, që dukej tani sikur shtërngonte zemrën se mos i fluturonte nga kraharori.

Napa e mugëtirës së mbrëmjes po zvarrisej e po ndërej anembanë fshatit. Mali i Thatë, si një murtajë e heshtur, nxinte mbi krye të çatave; liqeni tej e tej sikur regëtinte nga një dhimbje pa shërim: e tillë ishte zhurma e tij. Yjtë në qiell ishin strukur prapa reve. Mbi kryet e të vrrarit digjeshin tre qirinj, flakët e të cilëve herë zvogëloheshin, herë shtoheshin dhe ravijëzonin në oborr siluetat e fshatarëve, që kishin pirë helmin e atyre ukubeteve.

Në atë heshtje kaq të rëndë kumboi zëri i Bendo Shapërdanit:

— Burra! Babanë nuk do ta shtijem në dhe' pa marrë gjakun pa shpëtuar motrën time, vajzat e tjera dhe foshnjat. Po s'ja muarëm gjakun, me mirë të tretet mbi dhe, se nën dhe: kush prej jush do të më ndjekë? Ja gjallë, ja vdekur!

Të gjithë e panë se si flaku tej kërrabën e gu-nën, se si u përkul e mori armët e t'et e se si i ngjeshi. Ngjeshi dy pishqolla e dy kama në brez, i mbushshi vezmet me barut e silahun me fishekë dhe hodhi në sup dajlanin e rëndë:

— Burra! — kumboi përsëri zëri i tij. — Pas-këtaj për baba do të kem dajlanin, për nënë kamën

e mprehtë, për vëllezër çiftin e kobureve. Pa marrë gjakun e pa shpëtuar vajzat e foshnjat, unë nuk kthehem. Ju ruani kufomën e babait, po pa lajm mos e shtini në dhe:

Pastaj iu drejtua moshatarëve të tij:

— Cili prej jush do të rrëmbejë armët?

Ata sikur prisnin urdhërin e tij: rreth iu grumbullua një çetë e tërë, midis të cilëve edhe Gjini, i fejuari i së motrës, i Marës.

— Për hakmarrje!

— Për hakmarrje!

Buçitën këto fjalë kushtrimi në atë errësi të pus dhe përpara flakëve të qirinjve të të vdekurit u shkëlqenin tytat e dajlanëve e tehet e kamave.

Pas pak kushtrimin e hakmarrjes e rrëmbyen hiet e rënda të malit të Thatë e të Galiciçës: Çeta e Bendor, me kraharor të ndezur prush, mori shtigjet drejt Ohrit. Kishin kaluar katër orë, që kishte dalë nga fshati bylyku i jeniçerëve me haraçin. Prandaj çeta duhet të fluturonte për t'i arritur diku, pa hyrë në qytet. Hë-hë, kapërcenin shkëmbej, driza e përranj të thatë, çuka e gryka. Hë-hë, Secilit trim në kraharor i ziente diçka e urrejtëshme e madhështore, bashkë, diçka e neveritëshme dhe heroike bashkë. Dhe ata fluturonin përmes monopateve e shtigjeve, duke kërcyer mbi thepat e shkëmbinjve, mbi shkuret e mbi drizat, mbi përranjtë e mbi grykat me guxim të shtuar, me urrejtje të dyfishuar! Hë-hë, përpara mbi ta! Përpara! Përpara! Por... mbi kë? Ku?

Bendor në kokë i ishte ngulitur Ohri, — Ohri, qendra ku vriste e priste Ahmet Pashai, i dërguari i sulltanit, Ohri, ku nginjëshin e dëndëshin me tërë të mirat bejlerët e agallarët përqaftuar me afendikonjtë e me arhondët, të cilët dinin t'u hiqnin

njëqind fasha «rrjepacakëve», e «morracakëve», — si i quanin me përbuzje fshatarët, Ohri, ku dergjeshin nëpër hareme motrat e të fejuarat e fshatarëve, ku dergjeshin nëpër bodrume kaqë e kaqë fatzinj e hallexhinj, që kishin ngritur dorën për të mbrojtur nderin që u mirrej nëpër këmbë, për të mbrojtur mallin që u rrëmbehej! Ja, pa shih Peshkëpinë: dikur kish qënë fshat i lulëzuar, qendër e karvaneve, që lidhnin qytetin e Voskopojës me Ohrin, me Manastirin e me gjithë botën e huaj; tani ishte katandisur keq e mos më keq! Edhe kopetë, që fshiheshin nëpër grykat e nëpër shpellat e nëpër majat e Malit të Thatë, rrallë qëllonte të shpëtonin nga hajdutët. Po nderi? Haraçi i njëqind geseve me aspra në vit hahej e s'hahej. Por haraçi i vajzave, haraçi i fëmijëve për t'u bërë jeniçerë nuk durohej dot! Kishin qarë shumë nëna në fshat, por atje në mal, ku kalonte kohën natë e ditë Bendua me kopenë, lotët e kujet nuk i linin ndonjë vragë të madhe, se atje arrinin si një regëtimë e largët. Ai vetë atje në mal, medje edhe në stanin e strukur mu te Lisi i Divit, shpesh herë u pat kapur fytas me hajdutë kafshësh dhe kurdoherë pat dalë fitimtar. Ndeshjet e tija të përherëshme me hajdutët iu patën bërë si gjë e zakonshme. Medje mërzitej kur kalonte koha pa u ndeshur me ndonjë hajdut. Si armë kishte një çifte të vjetër, që e mbushte me strall, një sakature çeliku edhe një jatagan si drapër. Krahun e kishte të fortë dhe me jataganin bënte kërدينë. Pat dëgjuar edhe për turpin e haraçit! Por i besohej e s'i besohej. Por kur i erdhi radha së motrës Marë, kur pa t'anë të vrarë në oborr edhe shtëpinë shkumb, oh, se ç'dhimbje të madhe, që provoi Bendua, dhimbjen më të madhe në jetën e vet, furtunën më të tmershme, atë

furtunë, që s'e kishte provuar kurrë as në kërthizën e dimrit mbi majat e Malit të Thatë, ku ndesheshin e përlesheshin të ftohtit, gorenit, dëborës dhe ngricës. Kjo furtunë, në vend që t'i mpinte trupin, i ndezi kraharorin, i ndezi zemrën, i ndezi dejet flakë dhe tani e ndjente vehten jo më bari, por div, si divi i përrallave, që pat shkukur atë lirin e madh në koriet e Shënaumit dhe e pat ngulur, ja, atje mu në majë të Malit të Thatë, të cilit edhe sot i ka mbetur emri Lis i Divit.

Pranë Bendos fluturonte Gjini, djaloshi i ri, të cilit në kraharor i kllokotitnin dy urrejtje të mëdha: E para që për Marën që ja kishin rrëmbyer si haraç dhe tjetra për motrën Leni, e cila, kur i vajtën jeniçerët ta merrnin robinjë, s'e bëri të gjatë: Ata hynë nga dera e madhe, ajo u shpëtoi nga deriçka e vogël e shtëpisë dhe shpejt e shpejt u hodh nga Shkëmbi i Thikës e u bë copë e çikël!

Ja, tani edhe e fejuara e tij Mara, lidhur me vinarkën, se si përpilitej për të shpëtuar nga duart e jeniçerëve të... pashait, të... beut! E fejuara e tij në krahet e botës!

Ngrinte kamën dhe «fap e fap!» rrëzonte me një të rënë degët e ferrave e të shkurreve, që dilnin përpara, si të kishte armiq, jeniçerë!

E tillë urrejtje u ziente në kraharor edhe pjesëtarëve të tjerë të çetës, e cila shtyhej prapa tyre si një furtunë e tërbuar.

— Shshsh! — se kush dha shenjë.

— Sshshsh! — u përsërit kjo regëtimë nga të tridhjetë vetët.

Ç'të shihje? Aty në një lëndinë, rrethuar nga koria, digjeshin zjarre të mëdhenj... Në çdo zjarr piqeshin në hej nga dy tri mishra të majme. Një erë mishi të pjekur kundërmonte anembanë. Rreth

e rrotull zjarreve e mërshave ishin jeniçerët, disa duke u ngrohur, të tjerë të shtrirë barkas duke u çlodhur, ndonjë në këmbë duke u shkundur nga morrat.

Ishte mesnatë, një mesnatë vere e tulatur; nga ajo lëndinë, e strukur midis korieve, dukej vetëm një copë qiell me disa yje të shuar. As liqen, as fshat pranë. Ohri ndofta dergjej tej edhe tri orë larg më këmbë.

— Shshshsh! — u përsërit regëtima e fshatarëve.

Mos ishin jeniçerët, që shoqëronin karvanin me vashat e fëmijët e Peshkëpisë?» Përgjegjen ua dhanë disa rënkime të mbytura femrash, ca dënosa e të virra të këputura fëmijësh, që vinin nga lëndina e që treteshin në thellësitë e kories.

Me siguri që robinjat nuk ecnin dot dhe jeniçerët kishin vendosur ta kalonin natën në atë liqer aqë të strukur e të ngopeshin me mishra të pjekura, të rrëmbyera nga kopetë e fshatarëve.

Bendua dha udhëzimet e duhura. Pastaj pjesëmarrësit e çetës u shpërndanë me çape hajdutërishte dhe... fët e fët nga të gjitha anët e korieve, si një suferinë e tërbuar në flakërimën e zjarreve, ndritën tridhjetë jataganë e tridhjetë tyta dajlanësh.

Jeniçerët as e kuptuan se nga u kishin rënë këto shqiponja: rojet kafshuan dhenë që në sulmin e parë dhe s'patën kohë të bënin as gëk. Gëk nuk bën dot as gjithë ata, që ishin shtrirë sa për të marrë një sy gjumë, gjersa të piqeshin mishrat në hell. Një pjesë prej tyre u vranë, një pjesë murrën dhenë, të llahtaritur. Nga ata që u përleshën me armë, ca kafshuan dhenë, ndonjë u përplas përdehe i plagosur rëndë, të tjerë ua dhanë këmbëve!

Robinjat i gjetën të lidhura njera me tjetrën me zinxhirë nga ata që barinjtë lidhnin qentë. Fëmijët i gjetën kruspull, që po qanin me lemeri. Gjini, që ishte caktuar me kohë, për t'u kujdesur, në radhë të parë, për robinjat, u këputi zinxhirët dhe i nisi pa humbur kohë. Por në atë rrapëllimë u dëgjua klithma e llahtarëshme e një vajze. Bënda, si vetëtimë, sulmoi në drejtim të klithmës: u gjend përpara një skene, që i pikoi në zemër: një turk po e tërhiqte rrëshqanthi një robinjë përmes zgërbonjave e thepave. Bëndos sakaqë iu dha e ngriti jataganin, pastaj e lëshoi rëndë-rëndë: krahu i turkut u këput nga trupi si dega nga trugu. Jatagani rëndoi edhe më dhe u dëgjua ofshama e rënduar e vashës. Gabimisht ai plagosi edhe vajzën në sup.

I tërbuar, e zhvati jeneçerin dhe me një të rënë, ja ndau kokën nga trupi. Pastaj e ngriti vazhën në krahë e me vrap ja dorëzoi Gjinit.

— Kjo të dërgohet sa më parë në limer në Lis të Divit dhe për shërimin e saj të kujdeset vetë çoban Miti.

— Cila është kjo? — iu dha Gjinit të pyeste.

— Nuk e njoh! Po cilado qoftë, s'ka rëndësi. Porosite Marën t'i shërbejë vetë atje në stan. — shtoi dhe rendi përsëri në sheshin e betejës.

Dita e re çetën e gjeti në rrëzë të Malizonjës: ajo vuri re se bashkë me robinjat e Peshkëpisë, ishin edhe robinja të tjera nga fshatrat aty rrotull. E plagosura rëndë ishte një prej tyre. Të gjitha robinjat me gjithë fëmijët iu dorëzuan prindërve brenda ditës, me përjashtim të së plagosurës. Pesë trimat e plagosur i shpunë nëpër jatake të sigurta për t'u mjekuar.

Bataretë e fitores, që u dhanë nga rrëza e Ma-
lit të Thatë, ngritën peshë fshatarët. Fëmijët, që
iu kthyen shëndoshë e mirë, robinjat që u kthyen
gjallë e me nder në gjirin e familjeve, ishin sihari-
qi më i madh, që muarën fshatarët e Peshkëpisë
pas aqë e aqë fatkeqësirave. Pasdreke, kur zbritën,
trimat në fshat, oborrin e shtëpisë së Bendos e gje-
tën të dyndur me fshatarë, që ishin krenarë nga
hakmarrja. Në mes tyre ende qëndronte shtrirë
kufoma e të vvarit.

— E muarëm gjakun, baba! Marën me të tje-
rat i çliruem! Pushofsh në paqe! — tha Bendua du-
ke u përlur përpara kufomës sikur i dha sihariqin
e madh të vdekurit.

Pastaj u bë varrimi, një varrim i paparë në
këto anë: Pleqve e të rijve, grave dhe burrave, të
vegjëlve e të mëdhenjve, që shkonin pas të vde-
kurit, duke çarë atë mugëtirë të mbrëmjes me qi-
rinj të ndezur nër duar, u dukej sikur u ishte he-
qur nga kraharori ajo rrasë e rëndë, që i kish shtry-
dhur e i kish shtypur orë e çast. E hidhnin çapin
me kryet lart, se më në fund kishte ardhur ajo
ditë e bukur, kur edhe rajeja guxoi të ngrinte gru-
shtin kundra jeniçerit.

Breshërima e dajlanëve, e para breshërimë e
hedhur «lirisht» nga rajeja, — lajmëroi se të vde-
kurit iu dha lamtumira e fundit!

Çeta e Bendos nuk pat kohë të mblidhej maka-
ri një ditë nëpër shtëpitë, se beteja e betejave ish-
te të shpartallonin edhe taborin tjetër, që do të
dërgonte Ahmet Pashai nga Ohri për t'u hakmarrë
e për të shtruar këtë fshat «të rebeluar». Shumica
e fshatarëve tani mbanin anën e Bendos, por kur-

doherë me frikë për atë të papritur të llahtarëshme, që i priste. Prandaj çeta së pari vendosi t'u kallte tmerin Ahmet Pashait dhe bejlerëve mu brëndë në qytet. Por si mund të bëhej kjo?

Trimat zunë shtigjet, grykat dhe pritën një ditë, dy, tri. Nga maja e një thepe Bendua dhe Gjini shihnin nga ana e Ohrit shtëllunga tymi, që ngriheshin drejt majave të Galiçiqës. Me siguri ishin fshatra, që digjte rrugës hordhia duke ardhur për në Peshkëpi. Këto lajme të lemerishme arritën gjer te çeta: Pyjet rrëzë Malit të Thatë dhe Galiçiqës u mbushën me fshatarë të ikur për të shpëtuar nga hordhitë e jeniçerëve, që ishin dërguar nga Ahmet Pashai, për ndëshkim. Nga thepat, ku kishte zënë pritë një pjesë e çetës, zgjatej një grykë e thellë, të cilën armiku duhej ta kalonte për t'u hedhur nga ana e Shënaumit e tutje për në Peshkëpi e Allarup. Mirëpo edhe sikur të futeshin në këtë grykë jeniçerët, ishte fort e vështirë t'i shkatërrroje! Bendua dhe Gjini menduan e menduan e më në fund vendosën. Ajo grykë duhej të bëhej patjetër varri i hordhisë që vinte. Do të përdornin tërë zgjuarësinë, tërë forcat, tërë dredhitë, që kjo betejë të kurorëzohej me fitore, se ndryshe do ta kishin humbur. «Ja gjallë, ja vdekur! Rrugë tjetër s'ka!» — u betua Bendua dhe e rregulloi çetën nëpër prita dhe vuri dredhinë në veprim.

Kur çdo pregatitje ishte gati, më në fund, ditën e katërt pas dreke, u duk hordhia e jeniçerëve me flamuj ngjyra ngjyra, që valviteshin si lecka. Buritë dhe trumbetat oshëtinin anembanë e përhapnin vetëm llahtari e urrejtje ndër fshatarët, që kishin marrë malet. Hordhia ecte si një stuhi e dhur dhe e zijosur për një gjah të jashtëzakonshëm. Sa arritën nën këmbët e thepave, përpara u dolli

gryka e përtej grykës, në një çukë, iu çfaq një pamje e çuditëshme: një gardh fshatarësh arnautë. Komandari hodhi vështrimin më parë në grykët, pastaj përtej mbi çukat, ku nxinte një korie. Midis lisave shekullorë valaviteshin mëngët e gjëra dhe fustanellat kinda-kinda të toskëve. A ishte e mundur të kishin dalë arnautët për t'i pritur e për t'u kërkuar të falur e mëshirë?! Por nuk dukej asnjë lëvizje, asnjë shenjë për mikpritje. Megjithkëtë ç'të ishte vallë ajo e qëndruar mu në shesh pa armë, po me fustanellë e me jelekë, veshur si për dasmë? Shtabi i jeniçerëve fërkoi zverkun. Si t'ja bënin? Rruga kalonte nga ajo gryka, përmes asaj korie, pastaj dredhonte tutje për në Shënaum e Peshkëpi. Iu dha urdhër pararojës të zbriste e të kalonte grykën dhe të shkonte mu në çukë për të parë se ç'ishin ata fshatarë arnautë si gardh.

Pararoja zbriti tatëpjetën, kaloi grykën, pastaj, nëpër një monopat të vështirë, u ngjit në anën e çukës. Hë-hë, me hapa të dyshimta, me zemër të tronditur, por edhe me shpresë të tulatur, sepse mund të kishte patur të drejtë komandari i tyre, që u kish thënë se ata do të ishin patjetër fshatarë të Peshkëpisë, që kishin ardhur t'i prisnin me të mirë e t'u jepnin çfarë të kërkonin, veç t'i linin gjallë. Komandari zemërmadh e bujar i kishte siguruar se dorëzimi i fshatarëve më të mirë nuk do të ndikonte aspak në atë të drejtë që kishin jeniçerët e bashibozukët për të plaçkitur shtëpitë e për të çnderuar çdo femër, që do t'u binte në dorë. Kjo e drejtë për plaçkitje e për çnderim mezi e përmbante në vënd gjithë atë hordhi.

Nga rrëza e thepave, hordhia e jeniçerëve ndiqte pa marrë frymë lëvizjen e pararojës: edhe cazë, edhe cazë do të takoheshin me gardhin e fshatarëve.

Kur... u duk se po përqafoheshin, u dëgjuan të shtëna dajlanësh e tre nga pararoja kafshuan dhe-në, kurse dy të tjerë u çakërdisën dhe në vënd që të ktheheshin, ose të zinin pritë, u shtytën përpara. Pas disa hapash ra për tokë edhe i katërti, kurse i pestë me duart lart filloi të bërtasë për t'u dorë-zuar.

Hordhia e jeniçerëve i pa të gjitha dhe komandari, i inatosur, pa e menduar thellë, u dha urdhër jeniçerëve të sulmonin pa mëshirë, për të shkatërruar atë gardh fshatarësh, që më qëndronte aty vetëm duke valavitur mëngët e kindat e fustanellave të bardha. Hordhia me zemëratë të papërmbajtur ra tatëpjetë grykës. Kur filluan rreshtat e para të ngjiteshin nga gryka për në çukë e për në korien përtej, çeta e Bendos, e forcuar me fshatarë të tjerë vullnetarë, doli nga pritë e ndryshme. Jeniçerët nuk aritën të kuptonin si ishte pregatitur ky kurth aqë i ndërlikuar rreth tyre dhe filluan të sulmonin në të gjitha drejtimet pa rregull. U çakërdisën akoma më shumë, kur dëgjuan klithmën e llahtarëshme të komandarit të tyre të cilin që nga çuka ku kishte arritur, e kishin hedhur tatëpjetë greminës si një ortek dëbore! Atëhere i kapi paniku. Ata që mundën, ja dhanë me të katra. Por nga? Të gjitha shtigjet ishin të zëna.

Në të përnduar të diellit, kur pushoi beteja, gryka dukej si një varr i hapur jeniçerësh. Bendua dhe trimat e tij e fshatarët e tjerë u bënë huq.

* * *

Jo huq! Pas kësaj fitoreje Bendos i rëndonte përsëri një gjë fort e dhimbëshme në kraharor: as mendimi e as zemra nuk i hiqej nga ai gabim i rën-

dë që kishte bërë duke plagosur — vërtet pa dashje, — atë robinjë të panjohur. I ngjante sikur nuk do të gjente kurrë qetësi, për atë fatkeqësi, që i kishte shkaktuar asaj vajze. Edhe sikur të shërohej, nderi i saj ishte prekur; asaj nuk do t'i afrohej asnjë i ri, jo vetëm se u pat rrëmbyer si robinjë, por edhe se kishte ndenjtur kaq kohë fshehur... Tamam i shtyrë nga këto mendime që i rëndonin në zemër, Benda shkëmb më shkëmb e çukë më çukë, vajti në Malizonjë te Lisi i Divit. Nën degët e gjëra të lisit ishte strukur kasollja. E motra tërë ankth iu hodh në qafë.

— Si dualltë? — e pyeti me frikë.

— I shpartalluam! I varrosëm të gjithë në grykën e Gjarpërit! Apo s'i futmë në kurth me marifet: Te koria e çukës varëm fustanella e xhamadanë. Jeniçerët i pandehën si fshatarë dhe kujtuan se po i prisnin me bukë e kripë si miq, por... lere se ç'u bë! Po ju këtu si jeni? Ajo fatkeqja si është?

— Duket më mirë. Tani sa e zuri gjumi.

Sakaq nga koria doli çobani plak, Miti, me një krah shkarpa.

— O xha Miti!

— O trimi im! Duket se kini bërë kërdrinë! Të njoh në sy! — qeshi çobani plak, duke lëshuar shkarpat. E bëri «toka», e përqafoi e shtoi: — keni filluar një luftë të madhe. Të gjithë po çuditen me trimërinë e trimave tanë. Ta dijë jeziti se në kraharorin e rajesë rreh zemër burri! Ju lumtë!

Bendos i qeshi fytyra. Tundi pallën, që i varej në brez. «Edhe pleqtë tanë na çmojnë. E kemi nisur mirë». — i dha zemër vehtes.

— Ç'më lini këtu mua? Pse jam plak a? Jo, ore, jo! Unë dua të vi me ju. — mblodhi supet xha Miti.

— Ti na bën një punë, që s'e bën tjetër njeri: ti je «heqimi» ynë! Si ma ke atë të plagosurën? Po ata shokët e tjerë si të duken? — i foli Bendua me të butë.

Xha Miti buzëqeshi nën mustaqe dhe fërkoj zverkun me një farë fodullëk të fshehur.

— Ke të drejtë, ke të drejtë! Ashtu qoftë! Ata të rinjtë i nisa sot shëndoshë si molla. Këtë vajzën ende s'e kam mirë. O t'u mbylltë, me një të rënë, desh të këpusje dy krahë! Po mos, ki keq... do të shërohet, do të shërohet... I do edhe disa ditë!

Bendos edhe i erdhi mirë, që do të shërohej, edhe i erdhi keq, se duhej ta dërgonte në fshatin e saj. Atë e kishte kapulluar një ndjenjë e përzjerë: edhe sikur të shërohej, ai s'e lante dot fajin, që kishte bërë kundra saj. Pastaj në ato kohëra a do t'i gjente vallë njerëzit e saj? Hallexhinjtë ishin fshehur nëpër shpellat e nëpër pyjet e Galicicës e të Malit të Thatë. Halldupët nuk kishin lënë fshat pa shkromosur.

Këto i mendonte Bendua, kur Mara e ftoi të shkonte në kasolle brënda për të marrë një kafshatë bukë. Duke ngrënë bashkë me xha Mitin, me zë të ulët, i foli çobanit plak për betejën e madhe, për plaçkat e shumta, që kishin marrë, për halldupët e vrarë si miza. Pastaj sikur u kujtua për diçka:

— Marë, ke të fala nga Gjini! S'e ka shoqin për trimëri!

Mara u skuq.

— Sa të shërohet kjo motra këtu, do të zbresësh në fshat. Nëna ta ka nevojën. Po edhe Gjini kërkon që të martohet. Mua më duket se ka të drejtë: në këto kohëra të rrezikshme vajzat janë më të sigurta, kur martohen.

Faqet e Marës po merrnin ngjyrën e lulëkuqe-

ve. Kha Miti, duke buzëqeshur nën mustaqe, ja bëri:

— Mirë e ke! Po edhe ty të duhet një nuse! Ikën Mara te Gjini, po te nëna jote kush do të rrijë? Po këto poturet që m'i ke tërë gjak e baltë, kush do t'i lajë?

Bendua pa dashur hodhi vështrimin nga vendi, ku dergjej e sëmura, me fytyrë mbuluar me një lahuri të bardhë, të qendisur me xixina anësh.

Ai e njohu. Atë lahuri ja kishte dhuruar e ëma Marës ditën kur e patën rrëmbyer jeniçerët si robinjë.

— Në këto luftime jemi hakmarrë për të gjitha të këqiat, që na kanë punuar halldupët kohët e fundit! Edhe babait ja muarëm gjakun! Sikur ta dinte se ti shpëtove nga haraci. Sikur ta dinte!...

Ai nxori një psherëtimë të thellë. Pastaj shtoi:

— Tani duhet të jetojmë me dajlan e me jatagan në dorë, se turku do të bëjë çmos, që të na vrasë e të na çnderojë. Por... do t'ua shtypim kokën qenërve!... — tundi grushtin dhe i ra me shkelma tokës: — Të këqiat e tyre s'kanë të sosur! — i mëshoi zërit fort e fort.

E plagosura u trondit dhe hodhi tej lahurin e fytyrës:

— Marë, motër — klithi.

Mara, si e kishte zakon, i vajti pranë me buçelën me ujë: piu dy gllënjka dhe u përmend mirë. Bendua po e shihte për herë të parë aq afër e aq mirë: iu duk perri me ato vetulla të zeza katran, me ata flokë të tërë derdhur mbi supe e mbi kraharor, me atë hundë qiri e me ata sy, ngjyrën e të cilave nuk e dallonte në u ngjante burimeve të Shënaumit atje poshtë buzë liqenit, apo kaltërsisë së qiellit atje mbi majat e Malit të Thatë. Ngjyra e atyre syve sikur ja lbyri mendjen Bendos, kur dëgjoi t'i thotë:

— Vëlla! Vëlla!

Dashur pa dashur të dy si me një gojë pëshpëritën:

— Marika!

— Bendo!

Një ngashërim i thellë u ndeh në kasolle.

— Marika!

— Bendo!

— As prindërit, as vëllezërit s'ma kanë bërë këtë të mirë, që më bëre ti! — pëshpëriti vasha dhe me një ngashërim të thellë shtoi: — Shpëtimtari im!

Përsëri u veshtruan të lektisur. Vështrimi i Bendos u tret në kaltërsinë e syve të Marikës; ai i saj u mbyt në ngjyrën e kadifenjtë të syvet të Bendos. Marika e bija e Petro Zarçes, vetëm me vështrimin e saj i besoi e i dorëzoi zemrën. Bendos së Shapërdanëve nga Peshkëpia.

Mirëpo... nuk kishin kohë për lektisje: Bendua kontrolloi limeret, dha porositë e fundit dhe për një hop ja bëri gjer në fshat. Pa t'ëmën dhe u dha zëmër grarisë e pleqve të fshatit. Veçse rrugën ja pengoi arhondi i fshatit, Qir Llaqi.

— Ehe, o biri i Shapërdanëve, sikur nuk e ke nisur mirë! Nuk bëhet dyfek me një mbretëri të madhe si kjo e Baba Dovletit! Do të na bëjnë copë. Më mirë të japim haraç, më mirë të shkojnë robinja vajza e fëmijë, të paktën të tjerat të shikojnë punën e rehatinë!

Qir Llaqi i fliste me bindje të plotë e me zë të fortë duke ëndëruar kurdoherë tregëtinë, dallaveret, xhambazllëket edhe atë allishverishin e madh, që bënte me hanin, që kishte në të dalë të fshatit me qiraxhinjtë, që çanin rrugën Manastir-Ohër-Voskopojë e anasjelltas e që shpenzonin paratë për sa-

në, për tagji e për ushqime të ndryshme, sidomos për verë, për raki, për fasule e për ullinj!

Bendua e vështroi dhe nuk i erdhi aspak mirë; zjeu përbrënda, po e mbajti vehten. Me gjithë këtë ja preu shkurt:

— Edhe pula që është pulë, kur ja rrëmben zoçkën, të sulmon e t'i nxjerr sytë, po ne që jemi njerëz, si mund të durojmë?! Ja gjallë, ja vdekur! ... Ti shiko punën e tregëtisë, veçse... po dëgjova se bën ndonjë tradhëti, ta dish, hi e shkrumb do të të bëjmë me gjithë pasuri e katandi! As mos u fut fite njerëzve! Edhe kjo është tradhëti!

Kaq i foli dhe iku tutje. Qir Llaqi mbeti në mes të rrugës duke u dridhur edhe nga inati, edhe nga frika.

* * *

Pas katastrofës së Grykës së Gjarpërit qeveritarët turq u alarmuan tmerësisht, kurse rajeja u gëzua pa masë edhe mori frymë lirisht.

Në Ohër asnjë nuk e ndjente vehten të sigurtë. Ahmet Pashai me lepurin në bark e kishte shtuar nargjilenë; nën dollomanë e rëndë i dridhej i tërë trupi nga urrejtja, që i ziente kundra jeniçerëve, të cilët e kishin turpëruar; sidomos nuk i zinte këmba vend, kur kujtonte se nën qeverimin e tij rajeja kishte guxuar të ngrinte dorë kundra Dovletit.

...Sa shumë në qejf ishte ato ditë, kur priste t'i vinin të bukurat e dheut, ato arnautka të egra, që do t'i zbukuronin haremin atij në Ohër, Valiut në Manastir, Vezirit e Sulltanit në Stamboll. Mirëpo, duke pritur e duke pirë cazë raki të fortë me meze — vetëm palcë viçi e të brendëshme pule, — aty nga mesi i natës u bë çakërcejf: bëri të ngrihej e të shkonte në harem, që të kalonte kusurin e natës. Mirëpo... tëk! hyri komandari i kalasë (ai kishte

të drejtë të hynte në çdo kohë) dhe e lajmëroi se tabori i jeniçerëve ishte shpartalluar dhe se «hanëmet» kishin marrë aratinë me gjithë fëmijë.

Ishte plumbi i parë i rëndë, që merrte Ahmet Pashai gjatë qeverisjes së tij në Ohër. Brofi në këmbë dhe, si i tërbuar, u end poshtë e lart dhomës. Kërkoj hollësira dhe hollësitat i mori vesh vetëm të nesërmen: Një farë Bendo Shaperdan Arnauti me çetën e tij, në befasi, e kishte bërë fërtele tërë taborin.

Ahmet Pashanë nuk e mbante vendi. Por edhe të gjithë bejlerët e bejlurçinët me arhondët i venin në konak e i luteshin t'ja priste krahët rajesë, se ndryshe të gjithë do t'i pinte e zeza.

U dhanë urdhërat njeri pas tjetrit, që të nisej vetë komandari i garnizonit të qytetit me një tabor tjetër jeniçerësh të zgjedhur të bënte shkumb e hi Peshkëpinë, të shtronte rajenë dhe t'ja sillte, në mos jo gjallë Bendon, të pakën kokën e tij shkuar në hu.

Dhe tabori u nis. Nisi edhe ajo pritje tërë ankth e Ahmet Pashait: natë për natë aty në konak pinte, pastaj, si një bishë e tërbuar, sulmonte haremin. Herë-herë pas mesit të natës i afrohej dritares dhe hidhte vështrimin tej e tej: liqeni dremiste çuditërisht, sikur gjithë dallgët t'i kishte përpirë krahërori i shqetësuar i vetë Pashait; edhe hëna sikur s'kishte guxim të llamburiste në atë errësirë pus të shpirtit të Pashait. Veçse malet e Galiçicës e të Malit të Thatë me ato të Mokrës thellë e thellë vetëm i nxinin. Këto vargje malesh Pashait i dukeshin si varge zinxhirësh, që po ja vinte rajeja në duar e në këmbë.

I tronditur, tërhijej zvarë nga dritarja dhe shkonte ulejné shiltënë e shtruar me pupla e sixha-

dera hindie. Pinte nargjilenë, shtrëngonte grushtin duke u kërcënuar:

— Do ta shuaj rajenë fare!

Mirëpo grushtit të tij iu përgjegj grushti i rajesë: i erdhi edhe lajmi tjetër më i zi se i pari: edhe këtë tabor Bendo Arnauti me trimat e tij ja paskëshin shpartalluar keq e mos më keq mu në grykën e Gjarpërit! Pashajt sa s'i ra pika. Bejlerët me bejlurçinët e arhondët e qytetit i zuri tmeri. Të gjithë derdhnin florinjte e alltunet, që të shtypej rajeja e ta shihnin kokën e Bendo Arnautit shkuar në hu mu në pazar të qytetit. Filloi një përgatitje e madhe: në qytet u derdhën bashibozukët nga të katër anët. Këta bashkë me jeniçerët po përgatiteshin të sulmonin rajenë; paria e vendit ditë për ditë i dërgonin pashait në konak dhurata për t'i shprehur mirënjohjen për ato masa shpëtimtare që merrte. Mbas shumë e shumë orvatjesh, më në fund, çdo gjë u vu në rregull: hordhia e madhe, si një furtunë, do të kalonte që nga Ohri drejt brigjeve të liqenit rrëzë Galiçicës e Malit të Thatë gjer në Mokër.

Në prakun e kësaj nisme natën, Pashai ja shtroi në konak me disa nga paria e vëndit e me kumandaret e garnizonit e të kalasë. Hëngrën yftarin me tërë të mirat. Xhamet e dritareve rriheshin nga pikat e shiut, të cilat u dukeshin miqve si lotët e rajesë, që do të derdhte të nesërmen nga ndëshkimi. Veçse ato vargjet e maleve të Galiçicës e të Malit të Thatë e të Mokrës ende i dukeshin Pashait si zinxhirë, që përpiqej t'ja hidhte rajeja në këmbë e në duar. Por... «stajfulla! Çok Padishah! — Allahu në qiell e Padishahu në tokë! S'kishte fuqi t'i dilte atij përpara!» — Ky besim i jepte krahë Pashait. Për të larguar mendimet e liga, urdhëroi të fillonin kë-

gët e vallet. Kërcimtaret me të mira të haremit dilnin në thellësinë e selamllëkut gjysmëlakuriqe, njëra më e bukur se tjetra me ato lëvizje lozonjare e të shkathëta, sa të dukej sikur xheneti fillonte në ato saraje këtej. në kala të Ohrit dhe s'mbaronte kurrë! Mirëpo, tamam aty mbas mesit të natës, kur përjashta shiu vazhdonte të binte e ku sipërfaqja e liqenit dukej si një pus i zi, në kundërshtim me shpirtin e çelur e të gëzuar të Pashait e të miqve, — në mes të qytetit u dëgjuan batare pushkësh, klithma, lebeti e... përsëri batare pushkësh, klithma e lebeti! Batare! Batare! Batare!

Komandarët brofën në këmbë. Brofën edhe paria! Brofi edhe vetë Pashai, Ahmet Pashai!

Bataretë vazhduan e ... vazhduan të dëgjoeshin më të forta e më të forta! Klithmat e piskamat u shtuan dhe një rrapëllimë sikur ra nga qielli:

— Selam, o Ahmet Pashai, nga Bendo Arnauti!

— Si?! Të jetë e vërtetë?

— Si?! Vërtet kështu?! — pyetën të llahtarisur njeri tjetrin Pashai e të ftuarit.

Sakaqë u erdhi lajmi më i tmershëm, që mund të prisnin: Rajeja me Bendo Arnautin kishin hyrë në qytet, kishin hedhur bataretë në mes të çarçisë, u kishin vënë zjarrin kazermave të garnizonit dhe... ishin bërë erë! Çudia ishte se nuk u gjëndeje as gjurmë: gjithë gjurmat e opingave të tyre tregonin se rajetë rrebelë kishin hyrë në qytet e kishin mbetur fshehur po në qytet, sepse asnjë gjurmë opinge nuk dilte jashtë qytetit.

Llahtari! Lemer! Priti tani kur të hedhin në erë edhe kalanë me gjithë sarajet e Pashait.

Llahtaria, si një qefin vdekjeje, mbuloi tërë bejlerët, bejlurçinët e arhondët dhe pllakosi shpirtin e tyre sa s'gjenin vrimë ku të futeshin!

Vërtet çeta e Bendo Shaperdanit kishte hyrë në qytet, mu në çerdhen e gjakësisë. Nga kallauzë të ndryshëm ajo kishte marrë vesh se po përgatitej një hordhi e madhe për të bërë shkumb e hi tërë fshatrat rrëzë Galiçicës e Malit të Thatë gjer në Mokër. Veç robinjave e fëmijëve, do t'i sillnin Pashait kokën e prerë të Bendo Arnautit. Kishin marrë vesh se edhe bashibuzukë nga vende të ndryshme ishin mbledhur nëpër kazermat e prisnin me thasë krahëve e me litarë brezit të sulmonin për të plaçkitur.

Kjo e detyroi Bendon me shokë, që të merrnin një masë tjetër më të rrezikshme, por të domosdoshme për të tmeruar bashibuzukët e për të shkatërruar planin e sulmit. Një ditë para fillimit të sulmit, hyri në qytet fshehurazi Gjini me një grup shokësh të tjerë: Të maskuar si bashibuzukë, mundën të futeshin mu brënda në kazerma. Natën hyri Bendua me pjesën tjetër të çetës. Sa iu afruan kazermave, krisën bataretë. Me të dëgjuar këto, Gjini dhe shokët që nga brenda hodhën nëpër dhoma pepellashkat e ndezura me hi e me vajguri. Sakaqë kazermat muarën zjarr dhe filloi alarmi e rrëmuja ndër bashibuzukët e jeniçerët. Përmes asaj rrëmuje ata mundën të shpëtonin; u takuan me çetën mu në çarshi, ku i shtuan bataretë më shumë. Pastaj mbathën opingat së prapthi, në mënyrë që gjurma të mbetej e të dukej sikur shkonte vetëm e vetëm në qytet e se asnjë s'kishte dalë jashtë.

Dhe vërtet qyteti i Ohrit u gdhi me frikë, me rrëmujë, në panik. Qepenat e dyqaneve atë ditë nuk u ngritën; rrugët mbetën të shkreta se asnjë qytetar nuk guxonte të dilte jashtë. Vetëm këmbët e

rënda të jeniçerëve dëgjoheshin poshtë e lart kall-
drëmeve. Jeniçerët bastisnin shtëpitë e zanaçinjve
e të fukarenjve duke i zhdëpur banorët me të rra-
hura për të marrë vesh se ku i kishin fshehur «ra-
jetë rrebelë» të padinë e të paiman! Jeniçerëve u
ishte mbushur mendja top se «rajete rrebelë» ishin
fshehur diku në qytet e. . ., sa të ngrysej, do t'ja
bënin bef për të vrarë e për të prerë jeniçerë e bej-
lerë e agallarë! Bashibuzukët të tmeruar shkuan
nga kishin ardhur! Ahmet Pashait plani i sulmit
i mbeti në dorë. Çeta e Bendos që atë natë kishte
zënë limeret e pritrat e saja.

Ohri ngrysej e gdhihej me ankth e me lemeri
me ditë, me javë, me muaj. Ahmet Pashai, kur e
mori vesh të vërtetën, filloi të dërgonte përsëri
bylyke-bylyke jeniçerësh për të shtruar rajonë e për
të sjellë kokën e prerë të Bendo Arnautit. Mirëpo
të gjitha bylyket pësonin disfatë një më një dhe
komandarët, si kërminj, zvariseshin e i lëpiheshin
Pashait duke i treguar gjëmat e njëpasnjëshme edhe
duke shtuar se ai, Bendo Arnauti, që as kapej e as
shihej, por që vetëm vriste e priste jeniçerë, nuk na
qënkish njeri si gjithë të tjerët, por na qënkish një
div i maleve e në vend të këmbëve na paskish
krahë!

Kjo legjendë na mori dhenë, se vërtet Bendo
Shapërdani na paskish krahë dhe krahë u ishte
bërë gjithë fukarenjve shqiptarë, atyre anëve. Dhe le-
gjenda shtonte se ai, Bendua, na paskej pasur për grua
një perri, që vërtet krahun e majtë e kishte më të
shkurtër; por ishte perri e sokoleshë, që s'i ndahej
të shoqit në asnjë betejë. Marika na e paskish em-
rin! Bendua atë grua na e paskish zgjedhur nga

orët e maleve aty në majën më të lartë të Malit të Thatë një ditë pranvere, kur na paskish bërë mend të martohej. Atje lart në majë të Malit të Thatë na paskishin dalë bylyke-bylyke tërë zërat, njera me e bukura se tjera e na paskeshin rrethuar Bendo trimin: «Zgjdh e merr për nuse atë më të bukurën, atë më trimen! — I paskish thënë ajo më e madhja. Dhe Bendua na mori nishan me dogra dhe «pam!» qëllon atë që ja zuri syri për më të bukurën. Mirëpo a do të ishte edhe trime se?! Kur... ajo Marika e qëlluar për vdekje me dogra mu në krahun e majtë, i afrohet serbes-serbes e prapa saj gjaku si solinar rrihte nga krahu dhe linte vazhdë mbi lëndinkë. «Të lumtë! As u trembe, as u tute! Më qënke perri e perrive, po edhe trime mbi trimet!» — na i paskësh thënë trimi ynë dhe na qenkësh martuar.

Me atë grua përkrah e me trimat e tjerë si njëri tjetri, Bendua nuk u binte vetëm jeniçerëve e bashibozukëve turq, por çfaroste edhe kusarët, që mbinin si këpurdhat e që nuk e linin fukaranë të merrte frymë. Fama e tij mori dhenë. Kudo pritej si shpëtimtar i hallexhinjve. Dajlani i Bendos ndihej edhe më larg se Peshkëpia e Alarupi, edhe më larg se Pogradeci, se Starova e Mokra. Sa të ngrinte Bendua jataganin ose allën, jeniçerit e kusarit i mbetej zemra në vend. Fukarenjtë e hallexhinjtë në Devoll edhe në Prespë, në Dibër edhe më thellë gjer në Bitolje e në Rumeli bëheshin me krahë sa të dëgjonin emrin e Bendo Arnautit. Krahinat e Galicës e të Malit të Thatë — rrëzë gjer në Mokër e Kolonjë u bënë zona të lira dhe filluan ta merrnin veten ekonomikisht. Qiraxhinjtë, që e kishin qendrën e tyre në Peshkëpi, filluan të shtegtonin lirisht: karvanet ngarkuar me mall të kushtueshëm

shkonin nga Voskopoja e lulëzuar, në Ohër e Bitolje e anasjelltas duke pasur si qendër sigurimi Peshkëpinë dhe emrin e Bendo Shapërdanit. Njëpër arat bujqit e bujkeshat punonin tërë ditën pa frikë se mos i prekte ndonjë kusar a se mos i rrëmbente ndonjë jeniçer. Kopetë e dhënve u shtuan pyjeve e maleve dhe bulmetrat e këtyre anëve fituan emër gjer në Bitolje. Kurse Bendo Arnauti vetë ditë e natë, i dukur e i padukur, i njohur e i panjohur, herë me katër pesë shokë, u binte anëmbanë krahinave për të parë me sytë e vet në shkonin mbarë punët e hallexhinjve, në zgjidheshin mosmarrëveshjet, sipas kanuneve të pashkruara por të vendosura nëpër kuvendet e burrave. Të gjitha shenjat ishin se punët shkonin vërtet mbarë.

Një herë Bendos iu mbush mendja, që çdo gjë ta shihte e ta provonte vetë pa u kuptuar fare prej të tjerëve. Si bashkudhëtare mori vetëm të shoqen, Marikën. Ngarkuan gomarkën me thëngjill, i fshehën brenda në thasë dajlanet, ndërsa nën rroba fshehën koburet e kamat. U nisën, duke vajtur fshat më fshat, si dy hallexhinj, burrë e grua, që kërkonin krodhën e përditëshme. Në Mokër dëgjuan se Bendo Shapërdani qënkësh jo njeri, po dragua nga ata të përrallave dhe na paskish për shoqe një shtojzovalle të arratisur nga logu i zërave të Malit të Thatë. Rrugës gjetën dy gra, njëra prej të cilave mbante në prehër një foshnjë:

— Nga udh'e mbarë kështu?

— Sa pagëzuaam këtë foshnjë në kishë. — iu përgjegj ajo, që e mbante foshnjën në prehër.

— Ç'emër i vutë? — e pyeti Marika.

— Bendo, motër, Bendo!, që të bëhet kapedan si Bendo Shapërdani! — ja dha përgjegjen ajo grua-ja tjetër. — Unë jam nunja dhe e kam gjetur mirë emrin. S'kishte ku të vente më bukur.

Çifti i uroi tërë të mirat foshnjës së porsalin-
dur edhe bëri tutje me një hare e krenari të fshe-
hur.

Rrugës për në Voskopojë udhëtuan me qira-
xhinj:

— Çudi-o, sa pa frikë bëki punën e qiraxhillë-
kut? Si nuk ju rrëmbejnë mallin hajdutët e jeniçer-
rët? — i pat ngacmuar Bendua.

— Asnjë kusar s'na prek dot, kur i themi se
jemi vëllamë të Bendo Arnautit. S'e kemi fjalën
për këto anë, ku i ka qeruar Bendua hajdutët, por
për qafën e Dhiavatit, të Pisoderit e të Peristerit:
edhe atje tartakuti i ka zënë kusarët, ja, ashtu si i
ka zënë jeniçerët nëpër strofkat e tyre! —

Kështu i folën qiraxhinjtë.

Në një fshat po bëhej dasmë e madhe. I tërë
fshati ishte ngritur në këmbë. Këngë e valle. I ftuan
edhe këta burr' e grua, fukarenj të panjohur. Edhe
këta deshën, s'deshën, u përziën me ta, kënduan,
hodhën valle, u dëfryen sa s'ka. Kur fët nga kreu
i sofrës u ngrit një plak mustaqemadh, mori pagur-
kën prej bushi e ngriti zërin.

— Të pimë nga një dolli për Bendo Shapërda-
nin, për mbrojtësin e madh të hallexhinjvet!

— Po si, jo! Të pimë jo nga një, po nga dhjetë
dollit për Bendo Kapedanin, se prej tij ne e bëjmë
këtë dasmë kaq të madhe! — shtoi një fshatar tje-
tër mustaqekuq.

Bashkë me dasmorët edhe këta të dy fakir-fuka-
rejtë ngritën dollinë për Bendo Kapedanin, që më
ndenjkish pa gjumë nat' e ditë maleve e shtigjeve
për t'i ruajtur fshatarët hallexhinj nga jeniçerët e
nga hajdutët.

Kur po ktheheshin i ranë rrëzë Çeraves e ku-
do panë bujq vërtet të këputur, por të lirë, nëpër

arat: korrnin në zhegun e vapës dhe këndonin, këndonin me një zë të fortë, me një zë plot shpresë.

— Pa dëgjo, Bendo, se ç'këngë këndojnë! — i tërhoqi vëmendjen Marika. Bendua vuri veshin e dëgjoji me habi:

— ...*Ty, o Bendo Shapërdani,
Shtatë okë të vjen dajlani!
Gjer Stamboll të vajti nami...*

Bendua hodhi vështrimin anembanë arave dhe pa burra e gra duke korrur e duke kënduar këngën e tij. Iu bë zemra mal dhe mendoj se nuk i kishte shkuar më kot lufta e tij dhe e shokëve të tij. U mbështet mbi supin e plagosur të së shoqes, të Marikës, dhe foli si me vehte:

— A ka gjë më të madhe për një trim, se sa të vdesë për të mirën e fukarenjve e të hallexhinjve?!

Marika e vështroi me ata sy, që u ngjanin burimeve të Shënaumit e qiellit të kaltërt të majës së Malit të Thatë dhe i buzëqeshi me shumë dashuri:

— A dëgjon se sa mirënjohës janë fukarenjtë?

Atij iu duk sikur me gojën e Marikës së tij kishte shprehur mirënjohjen e vet tërë nënat e tërë motrat fshatare, të cilavet u kishte shpëtuar fëmijët nga haraçi e familjet nga tmeri e nga llahtaria e jeniçerëve e të hajdutëve.

Çifti vazhdoi udhëtimin me zemër të përtrirë, rrugë e pa rrugë, shtigjeve e monopateve, duke i shoqëruar oshëtima e melodisë së fshatarëve:

«*Ty, o Bendo Shapërdani,
... Gjer Stamboll të vajti nami!*»

* * *

Vërtet Bendos gjer në Stamboll i kishte vajtur nami. Tmeri dhe llahtaria e kishte gllabëruar Ahmet Pashanë në Ohër dhe valiun në Manastir; e kishte tronditur edhe sundimtarin e madh të Rumelisë në Selanik, madje edhe Vezirin e madh e vetë Sulltanin mu në Stamboll.

— Ç'është ajo gjëmë e madhe, që na pllakosi nga një farë Bendo Arnauti! Dërgoni sa më shumë jeniçerë e asqerë, jepni edhe rushfet e shpërblim për kokën e Bendos një shinik aspra nga hazna e Dovletit e ma sillni këtu në Dollma Bahçe kokën e tij të shkuar në hu. Ta shoh vetë me sy këtë arnaut-qafir me krahë!

Të tillë urdhër dha vetë Sulltani dhe me dorën e tij nxori një ferman sa një rrogos Pendavini. U nisën nga Stambolli suvarinj të veçantë me fermanin e Sulltanit e ja dorëzuan të madhit të Rumelisë në Selanik. Ky ja dorëzoi Valiut të Manastirit dhe ky i fundit Pashait të Ohrit.

Fermani u shpall anembanë Rumelisë e vilajetit të Manastirit e të Janinës: «— *Një shinik aspra shpërblim nga hazna e Sulltanit i jepet atij, që do të sjellë kokën e prerë të Bendo Shapërdan Arnautit.*»

Njëkohësisht me një ferman të dytë të Sulltanit u mblodh një ushtri tjetër e madhe jeniçerësh e bashibuzukësh nën komandën e vetë Ahmet Pashait për të nënshtruar këto malësi të papërkulura dhe për të shpartalluar një herë e mirë çetën e Bendo Arnautit. Asqeri i madh, si një ciklon, përlau çdo pëllëmbë vend, preu e dogji pyjet e fshatrat, plaçkiti ç'gjete dhe rrëmbeu ç'vajza e ç'fëmijë munda. Lufta ishte e ashpër dhe e rëndë si askurrë. Hakmarrja e turkut ishte e tmershme. Ky ciklon hor-

dhish në shtigjet e Mokrës mori grushtin më të rëndë: nëpër grykat e nëpër thepat e kësaj ane buçitën daullet, krisën timpanet dhe zurnatë; klithma të lemerishme dhe ulërime të llahtarëshme muarën dhenë dhe si të kishin mbirë nga toka u dukën gjithandej palla, kama, thika, cfurqe, sëpata, tyta dajlanesh e dogrash. Çeta e Bendos, e shumuar me fshatarë të tjerë, me gjoks përpara i doli ciklonit. Fshatarët që nga shkëmbenjtë e që nga thepat, që nga degët e pemëve e që nga shpellat hidheshin mbi hordhitë si shqiponja të tërbuara dhe vrisnin e prisnin djathtas e majtas, majtas e djathtas. Shtigjet u bënë të pakalueshme nga stivat e kufomave të bashi-bozukeve e të jeniçerëve. Aty sa s'e la kokën edhe vet Ahmet Pashai. Hordhitë, që shpëtuan nga vrasjet, u tërhoqën me panik drejt fushës së Strugës e të Ohrit.

Por në këtë betejë të përgjakëshme, ku u vranë dhe shumë fshatarë, u plagos rëndë edhe vetë Bendua.

Ahmet Pashai, si një lingua me bisht nër shalë, u kthye në Ohër i turpëruar, i zvetënuar, i rras-kapitur. Iu mbush mendja së me «dyfek» nuk e mundte dot Bendo Shapërdan Arnautin. Përsëri thirri hafijet dhe u premtoi një shinik e gjysmë aspra rushvet për kokën e prerë të Bendos. Hafijet u shpërndanë anëmbanë vendit me veshje e me zanate të ndryshme. Njeri prej tyre, ai më i sprovuari, me kalin ngarkuar me bakëre, që bënin rrugës trangër-trungër, u ndal te hani i Qir Llaqit në Peshkëpi. Hani tani dukej si një saraj përpara mureve të shkrumosura të shtëpive të fshatit, që ishte aq i lulëzuar para disa javëve. Hanxhiu e priti mysafirin me tërë të mirat, se e kish pasur mik të vjetër. Qir

Llaqi tërë jetën e vet i falej vetëm parasë dhe... Shënaumit. Kohët e fundit Shënaumin e zëvendësoi me Shën Bendon, se, helbete, në saje të Bendos përsëri kishin filluar karvanet të venin e të vinin dhe dyert e hanit nuk mbylleshin kurrë as ditën, as natën... Mirëpo ja... pësh-pësh! Pësh-pësh! — edhe Qir Llaqi na merr vesh se Shën Bendua na ishte plagosur rëndë.

— Pësh-pësh!

— Pësh-pësh! — ja tha në vesh edhe tregëtarit të ri me atë dori të ngarkuar me enë bakëri.

— Ohoho, sihariq i madh! — buzëqeshi qiraxhiu, dhe, duke hequr i etuar verë nga kana, seç i pëshpëriti në vesh Qir Llaqit. — Pësh-pësh! Një shinik e gjysmë aspra! Një shinik e gjysmë! — filloi të belbëzojë Qir Llaqi si t'i kishte bërë njeri vërtet magji. U kthye nga ikona e Shënaumit dhe bëri kryq.

— Pësh-pësh!

— Një shinik e gjysmë aspra rrushvet!

— Një shinik e gjysmë aspra rrushvet! — oshëtimën e magjishme të këtyre fjalëve të magjishme Qir Llaqi pas kësaj filloi ta dëgjojë orë e çast, natë e ditë: këto fjalë të magjishme sikur ja pëshpërisnin edhe vozet me verë, edhe tamzanet me raki, edhe kadet me bylmetra; madje sikur ja pëshpëriste edhe ikona e Shënaumit vënë aty në krye të vendit e ndriçuar, kësaj here, me një polielej.

Për herë të parë mbas atë kohe iu lut shenjtorit të tij.

Dhe Qir Llaqi, si në kllapi, jetoi ditë e javë me këtë shinik e gjysmë aspra! Dhe qiraxhiu fisnik nuk harronte çdo javë ta nomaiste e ta yshte atë për fitimin e këtyre një shinik e gjysmë asprave... rrushvet!

— Pësh-pësh! E... pësh-pësh! me njerin e me

tjetrin! Më në fund Qir Llaqi i mori erë punës. Por i ndritën sytë, i ndriti edhe shpirti, iu mbush kraharori me gëzim atë natë, kur qiraxhiu hovarda mu brënda në dhomën më të fshehtë të hanit të tij i derdhi përpara gjysmë shinik aspra si paradhënie.

E bënë «toka», u përçafuan, i dhanë besa-besë njeri tjetrit: vetë Qir Llaqi do të bëhej kallauzi.

— Dhe pësh-pësh vesh më vesh! Pësh-pësh aty. pësh-pësh atje...

— Shënaum-Shënaum, ti më ndihmo mua, pa unë jam gati të të bëj kurorën të tërë vetëm prej sermi e të larë me flori! Më ndih, o Shënaum! Jam shërbëtori yt! Një shinik e gjysmë aspra rrushvet! — bënte lutje me gjithë shpirt orë e çast Qir Llaqi.

* * *

Bendo Shapërdani, i plagosur rëndë, po dergjej e po kurohej në kasollet e Lisit të Divit, në Mal të Thatë. Marika dhe çobani plak Miti, ose heqimi, si e quanin, i rrinin në krye orë e çast.

Atë mëngjes, kur «heqimi» e kishte kaluar tërë natën në Malizonjë duke kërkuar ilaçet më të forta për mjekim, Marika u ngrit më heret se çdo herë tjetër dhe dolli nga kasollja për t'u bërë gati për ndrimin e plagëve të Bendos së saj. Fërkoj sytë, hapi krahët dhe mori frymë thellë, sikur desh të thithte tërë ajrin e pastër të atij mëngjesi pranveror. Degët e Lisit të Divit kishin çelur gjethet e tyre. Kishin çelur rreth e rrotull e ishin veshur me një gjelbërim të freskët koriet e mezhdat. Lëndinka, që shtrihej përpara kasolles, dukej si një pelenë e madhe e gjelbër e mbi të cilën kishin çelur luleshqerrat e verdha, që dukeshin si foshnje buzëqeshur. Buzëqeshi edhe Marika me gjithë shpirt: «Sot


do ta gëzoj Bendon e do t'ia tregoj se jam shtatzënë prej tre muajsh! Patjetër do guxoj ta gëzoj!» — mendoi ajo plot shpresa. Me lumtërinë e fshehur të nuses së re, që pret të bëhet nënë për herë të parë, përkëdheli përsëri luleshqerrat. «— Do ta gëzoj sot, patjetër do t'i tregoj...!» — përsëriti e lumtur.

Këtë lumtëri ja mbytën britmat, klithmat e zurnatë e llahtarëshme, që u dëgjuan nga të gjitha anët e pyllit, mes degëve e kories, u dhanë tyta pushkësh dhe maja kamash e thikash. Përmes këtyre iu duk sikur dalloi edhe Qir Llaqin duke ua bërë me dorë drejt kasolles, drejt saj.

— Bendo, na vranë në besë! — iu cfilit zemra Marikës dhe sakaq hyri në kasolle për të lajmëruar trimin e plagosur.

Bendua kafshoi buzët aq fort sa i nxorën gjak, i kafshoi nga dhimbja e plagëve dhe nga... tradhëtia! Por s'kishte kohë as për të ndruar plagët, as për ta pushuar gjakun. Me përpjekje të mëdha u ngrit nga shtrati, rrëmbeu armët dhe të dy, burr' e grua, zunë pritë mu në trungun e Lisit të Divit. Jeniçerët shtinin nga të gjitha anët. Ata e panë se ishin rrethuar e s'u kishte mbetur asnjë shteg shpëtimi. Nga heshtja e tyre, jeniçerët muarën zemër e duallën në lëndinë e... sulmuan drejt kasolles, që mbulohej si me një çadëre nga degët e lisit shekullor. Atëhere ata panë të dilnin nga trungu i lisit e t'u hidheshin rrufe burrë e grua si dy xhinde, me palla zveshur e duke shtrënguar në gojë midis dy buzëve nga një kamë çeliku: ajo flokëlëshura mbi supe, me sy fajkua; ai sa lisi vetë, i mvrejtur nga fytyra si ditë shëndreu, me dy sy si ushtë tërë zjarr e shpuzë. Jeniçerët u tmeruan e u ngurosën në vend.

— Hyrrysh! Hyrrysh! bré! Një shinik e gjysmë



aspra! Një shirik e gjysmë aspra! Hyrrysh! Hyrrysh!
— regëtinte e këlthiste kumandari i tyre nga prapa
e përsëri u dëgjuan si rrapëllimë egërsirash timpanet
e zurnat e urratë. — Përsëri jeniçerët, si gjarpërinj
u përpëlitën e rrëshqitën grumbull e muarën zemër
e u shtytën përpara kush me pallë, kush me dajlan.
Ata, të mahnitur e të tmeruar panë se si ajo xhindja
u dolli përpara e sesi i priti me trupin e saj gjithë
ata plumba, që i ishin drejtuar Bendo Arnautit e
pastaj se si u shtri sikur përqafoi këmbët e tij e ato
luleshqerra të verdha, që buzëqeshnin me miturinë
foshnjarake. Atëhere jeniçerët panë llahtarinë e
llahtarive: panë Bendon që u sul si dragua i plago-
sur e i harbuar me nga një pallë në çdo dorë duke i
vërvitur e duke i goditur e prerë krerë jeniçerësh
djathtas e majtas si të kosiste drutë e kories, ndërsa
në gojë shëndrisnin tehet e dy kamave, që shtrën-
gonte midis dhëmbëve!..

* * *

Kur arriti çeta, me Gjinin në krye, për ndih-
më, e gjetën Bendon me tridhjetë plagë të reja në
trup, të shtrirë mbi kufomën e Marikës, kishin dhë-
në shpirt të dy të përqaftuar atje te trungu i Lisit
të Divit; ndërsa mbi lëndinkën ishin shpërndarë kokat
e prera të jeniçerëvet; midis të cilave edhe koka e
Qir Llaqit. Kurse luleshqerrat e verdha dremitnin
të përgjakura!

B E S A D H E B E S T A R I

BESA dhe BESTARI ishin barinj. Ajo këmbë-zbathur, ai këmbë zbathur, ajo zhele-zhele, ai zhele-zhele; ajo me kërrabë, ai me kërrabë e shkonin ditën duke kullotur bravaret. Natën mbyllnin bagëtinë në vath ose në zimnicë dhe ndaheshin:

— Natën e mirë, Bestar!

— Natën e mirë, Besë!

Ai duke i rënë fyellit, ajo duke tjerrë lesh me furkë, shkonin nëpër shtëpi.

Të nesërmen takoheshin përsëri e përsëri u binin mezhdave, korieve dhe lëndinave me kopetë e vogla përpara e përsëri ai fillonte t'i binte fyellit dhe ajo ta shoqëronte duke kënduar e duke tjerrë lesh; përsëri ja shtronin buzë burimit që të freskoheshin me ujin akull dhe përsëri gurgullima e ujërave i rrëmbente e i shpinte në një botë tjetër, në botën e përrallave: ... Na ish se ç'na ish... Na ishin se ç'na ishin... E na ishin Zërë e Orë, Shtojzavalle e Perri, Dragonj e Asllanë, Kuçedra e Lubi, Gjoka e Atkina e... të gjithë këta venin e vinin, takoheshin e kuvendonin e ndesheshin për jetë e për vdekje, sulmonin e fluturonin e ndizeshin qiejt lart e digjej toka poshtë... Pastaj, nga e tërë kjo botë ishte dashuria e dlirë midis njerëzve, ishte dashuria e pastër për njeri tjetrin, ishte flijimi i vetes për të mirën e tjetrit, ishte fjala e nderit, e besa e dhënë.

Bota e përrallave vërtet ishte e bukur, po më e bukur ishte jeta e tyre e lirë maleve; më të bukur se çdo zërë e se çdo dragua ishin ata vetë; më i bukur se çdo argëtim ishte argëtimi i tyre me fyellin e me furkën, me kërrabën e me bucelën, më e bukura këngë e fëmijërisë së tyre ishte kënga, për të ndihmuar të pafuqishmit; më e bukur se çdo ëndër ishte ëndra e tyre që të jetonin bashkë, që të punonin bashkë.

Por dalngadalë u rritën! Ai u bë katërmbëdhjetë vjeç, ajo dymbëdhjetë. Bestari vazhdoi të kullosojë dhëntë. Besën e mbajti i ati në shtëpi, se, sipas zakonisht të vendit, ajo ishte rritur e nuk i kishte më hie të dilte nga dera jashtë! Ajo iu bind zakonisht dhe kënaqej duke dëgjuar që nga larg këngën e fyellit të Bestarit.

Veçse erdhi edhe një kohë tjetër: ai u bë tetëmbëdhjetë vjeç, ajo gjashtëmbëdhjetë!

Bestari me shkesë kërkoi dorën e Besës, të cilën s'e kishte parë me sy katër vjet me radhë. Shkeshi vajti me torbën plot me dhurata nga ana e djallit dhe u kthye me torbën plot dhurata nga ana e vajzës.

Në fshat lajmi mori dhenë: Besa e Bestari ishin fejuar!

— Çift më të bukur nuk ka në fshatin tonë! — pohuan të gjithë.

Mirëpo, zullumqarët të fshatit, Dushman beut, nuk i pëlqeu kjo fejesë: ai urrente për vdekje Bestarin, se nuk i punonte argat, se nuk i paguante as sa deshte ai për tokat, se nuk i jepte as bulmetra për kullota, e, më e keqja, sepse nxiste edhe fshatarët e tjerë të bënin si ai vetë! Një ditë Dushman beu ja ngriti Bestarit partallet! Fshatari i ri u shpër-

ngul në një fshat të afërtë ku fitonte kafshatën e gojës përsëri me mundim.

Besës i pikoi në zemër, por nuk e lëshoi vehten. E mbante shpresa, se Bestari i saj dinte se ç'bënte.

Bestari u dha përsëri pas punës, përsëri pas bagëtisë. Veçse dy herë në javë dilte me bravaren nu te Gurrat e Bardha, ku ndaheshin kufijt e të dy fshatrave. Ulej aty majë shkëmbit dhe i binte fyellit. Besa e kuptonte se Bestari i saj ishte shëndoshë e mirë. Nuk ngopej së dëgjuari orë të tëra, ndenjtur në selishte duke qendisur këmishën e nusërisë. Zemra i rrihte me ankth e me gëzim. Qendiste këmishën dhe e shoqëronte Bestarin duke kënduar me zë të ulët.

*Kur do të më marrësh,
O zambak i prillit...*

Vërtet këndonte me zë të ulët, por asaj i dukej sikur melodinë e saj e rrëmbente flladi i mëngjesit a i mbrëmjes dhe e shpinte atje larg te Gurrat e Bardha.

I shtohej gazi për ditën e madhe, për ditën e martesës.

Dushman beu e ndiqte kudo Bestarin. Sa dëgjonte fyellin, bëhej si bishë: i ngjante sikur i krekoj Bestari me anën e fyellit:

— Ja, ore bej, gjallë jam! Përsëri i bie fyellit, dhe Besa kurdoherë imja do të jetë! Edhe fshatarët kurdoherë do të ta punojnë si ta kam punuar unë!

Kjo gjë e tërbonte zullumqarin. Mendoj e mendoj dhe i përgatiti kurthin Bestarit. I vajti shtrigës e i mbushi prehërin me florinj: — Më lyej tre jastaganë, me tri helme të ndryshme nga tre gjarpërinj

me ngjyra, se dua ta vras bishën në mal!» — i tha asaj.

Shtriga ja plotësoi dëshirën, veçse e këshilloi: — Ruaju, bej, se po të çiku pakëz helmi në trup, kurrë nuk të shërohet plaga, kurrë nuk të ndahen gjarpërinjtë.

Beu, i krekosur e i ngazëlluar, mori sejmenët me vete dhe te Gurrat e Bardha e rrethoi Bestarin. Bariu u mbrojt me sëpatë e me kërrabë, me kërcunj e me shkëmbinj. Tre nga sejmenët e beut kafshuan dhenë! Por ata ishin shumë, ky ishte i vetëm, fare vetëm! I ngjante sikur luftonte si dragua kundra kuçedrave, ashtu si në përrallat! Dhe në fillim mori nëntë plagë nga nëntë jataganë! Në fund, kur ishte i lodhur dhe i zhytur në gjak, mori edhe tri plagë të tjera nga tre jataganët e helmetuar!

U zvarris e u zvarris mbi gurë e mbi shkëmbinj, mbi lëndina e mbi korie, mbi përrenj e mbi hendeqe, duke lënë prapa tij një vazhdë të trashë gjaku! Mezi arriti në shtëpi dhe ra në jatak gjysmë i vdekur!

Lajmi mori dhenë kudo në krahinë: «Zullumqar Dushman beu plagosi për vdekje Bestarin, të cilit i hapi dymbëdhjetë plagë nga dymbëdhjetë jataganë!» Këtë gjë vetëm Besa nuk e mori vesh. Ajo, si kurdoherë, në ato dy ditët e javës, shkonte e ulej në selishte, fillonte të qëndiste këmishën e nusërisë, fillonte edhe të këndonte me zë të ulët «Kur do të më marrësh, o zambak i prillit!» dhe priste të dëgjonte këngën e fyellit që nga Gurrat e Bardha.

Por Bestari nuk dukej, fyelli i tij nuk dëgjohej.

Një javë e dy, një muaj e dy, një vit e dy! Ajo vetëm priste, ajo vetëm qante dhe lotët e saj lagnin çdo ditë qëndismat e këmishës së nusërisë. Por

as qendismat mbaroheshin, as lotët shterroheshin!
Qëndis aty e prish aty, fshi lotët tani e qaj përsëri pastaj... Kështu vazhdoi Besa jo një javë e dy, jo një muaj e dy, jo një vit e dy, po shtatë vjet të tëra!

Shtatë vjet kjo duke pritur e duke vajtuar e duke qëndisur, shtatë vjet ai atje duke lënguar e duke rënkuar!

Pas shtatë vjetve, Bestari i dërgoi fjalë:

— Martohu, Besë, se unë nuk jam për ty! Martohu e paç fat të bardhë e jetë të lumtur! Unë jam me të dy këmbët në varr!

Besa u bë pikë e vrer! Si të braktiste Bestarin? Si të harronte kujtimet e fëmijërisë, sytë e tij, zërin e tij, këngët e tija?

Në derë të saj sakaq trokitën shkuesit njëri pas tjetrit: Të gjithë e kërkonin për djem të mirë, për fshatarë punëtorë, për barinj azganë! Ajo nguli këmbë një herë jo, dy herë jo, njëqind herë jo!

Mirëpo prindët me kokë të vet e fejuan Besën me të birin, e një pasaniku të një fshati të afërt. Dëshia s'deshi Besa u nis nuse, veshi atë këmishë e ato çitjane, që i kishte qëndisur me duart e saja duke endur aq e aq shpresa të bukura, kur dëgjonte Bestarin t'i binte fyellit me atë melodi të magjishme, që i ndillte vetëm gëzim.

Besa vërtet kurmin e saj e kish zbukuruar me rrobat e nusërisë, por edhe kraharorin e kish të mbushur me neveri e me urrejtje nga këto zakone të pamëshirshme, dhe me dashuri e me mall të zhuritur për Bestarin. I lindi dëshira për ta parë edhe një herë me sy Bestarin, për t'i dhënë makari një gllënkë ujë me dorën e saj, për t'iu falur edhe një herë, gjersa qënkish me të dy këmbët në varr!

U nis nuse! U nis nuse me një mori dasmorësh,
me zurna e gërneta!

Ajo për herë të parë mbas kaq vjetve po dilte nga shtëpia, për herë të parë kapërcente kufitë e fshatit, për herë të parë po kalonte përmes fshatit të afërt, ku ishte shpërngulur Bestari i saj.

— Eh, i shkreti Bestar! Ja, kjo është shtëpia e tij!

— Shtatë vjet fillikat në shtëpi! E ëma i vdiq. I ati i vdiq.

— E fejuara po martohet; e motra u tret si qiriri në këmbët e tij.

— Dymbëdhjetë plagë nga dymbëdhjetë jata-ganë dhe, thonë, të gjithë të helmuar!

— Fatziu Bestar, asnjë ilaç nuk e shëroi.

— I vdekur i pambuluar.

Kështu kuvendonin dasmorët, duke iu afruar shtëpisë së Bestarit, aty në të dalë të fshatit të afërt.

Duke i dëgjuar fjalët e dasmorëve, Besës i ngjante sikur po e përvëlonin hej të skuqur. Kraharori zuri t'i hidhej si dallgë deti.

Ooo, vite fëmijërie! Ooo, vite lumturie të paharruara! Besa, as brumët nuk e ngjeshte, as gjilpërën nuk e prekte, as fshesën nuk e merrte pa kujtuar emrin e tij, këngën e tij, fyellin e tij, të ardhmen e tyre!

T'ardhmen e tyre? Ah, kjo e ardhme, ç'doli sterrë e zezë!

Kurse kjo vetë, Besa, e pabesë, e pacipë!

Nuk mjaftoi që nuk e pa një herë, por edhe më kalon nisur nuse pranë shtëpisë së tij, përballë syve të tij!

... Të gjitha këto fjalë ja përplaste në surat një zë, që ishte fshehur në kraharorin e saj që në çastin

kur kishte veshur këmishën e nusërisë. Ky zë ja ndezi tërë nervat e tërë pejzat e trupit e të trurit, dhe ajo nuk duroi më: jo si nuse fshati, po si fajkua, kërcëu nga kali i bardhë:

— Dasmorë, ndaluni këtu! Unë do të vete të falem me Bestarin — u tha me guxim.

Dasmorëve sikur u ra rrufeja nga qielli i kthjellët!

— Hej, hej, një vashë, sidomos një nuse e nisur me duvak, po prishte zakonin!

Sa çel e mbyll sytë, ajo, pa pritur përgjegje, bëri tutje me të katra dhe kapërceu derën e shtëpisë. Bestarin e gjeti kockë e lëkurë.

Vërtet ishte i vdekur e i pakallur!

— Hej, Bestar! — pëshpëriti ajo me ngashërim.

Bestari fërkoi sytë se mos shihte ëndër, se mos i bënin sytë ashtu nga kllapia!

— Besë! Besë! Besë! — e shqiptoi këtë emër me aq dliresi, me aq ngazëllim, me aq mall!...

Nuk qeshte dot, nuk ngrihej dot, nuk lëvizte dot! Pranë kresë kishte fyellin, të cilin s'e kishte prekur me dorë shtatë vjet me radhë.

— Vërtet zëri i Besës është ky që po dëgjoj? — pyeti ai i habitur dhe i mallëngjyer e u mundua të hapte krahët.

— Po Bestar, po Bestari im, unë jam vetë Besa jote. — dëgjoji edhe një herë zërin tërë melodi dhe ndjeu sakaq se ata dy krahë të tij, që s'i ngrinte dot, i përkëdhelën dy duar femre, dy duar që zundërmonin erën e çumricave e të lëndinave, dy duar, për të cilat ai vinte bast kokën se ishin të sajta, të Besës!

— Të falem, Besë! Të falem!...

Për një copë herë në atë dhomë ndihej vetëm

frymëmarja e dy të rinjve, që kishin kryqëzuar vështrimet e tyre me aq mall, me aq ngazëllim.

— Shërbimet kush t'i bën? — e pyeti Besa me dhëmbshuri, pasi kishte parë shumë gjëra jo në vendin e tyre.

— Me mua u tret si qiriri edhe motërzeza! Veçse natën nuk ka fuqi më të bëjë shërbime dhe gdhihem fill i vetëm!

— Ndofta ilaçet natën të bëjnë më mirë! Do të rri sonte të të shërbej unë vetë! — i tha ajo.

Bestari nuk u besonte veshëve e syve të vet.

— Jashtë të presin dasmorët. Si do të rrish sonte këtu? — iu dha të pyesë.

— T'u japim të hanë e të pinë! Nesër shohim e bëjmë! — e këshilloi ajo. Pastaj me shpirt të vrrarë, por me vendim të prerë, u tha dasmorëve:

— Bestari po heq shpirt! Unë do ta ruaj sonte! Ju hani e pini ç'ju do zemra.

Ata u mahnitën, u zemëruan, prishën gojën, ngritën grushtin, ngritën zërin për këtë «turp» të madh, që po u bënte! Mirëpo sytë e saj xixë, zëri i saj i vendosur i magjepsën dhe, deshën, s'deshën, ashtu bënë. Ja shtruan me të ngrëna e me të pira!

Besa u mbyll në dhomë me Bestarin. E vuri dhomën në rregull e pastaj ndënji ta ruajë. Ai dergej në shtresa në kllapi. Besa, pranë saj kishte vetëm strajcën e nusërisë, ku i kishte venë e ëma, sipas zakonit, një gërshërë të madhe, një thikë, të pesë shtizat, gjëlpërat, shatën pa bisht dhe furkën, — tërë takëmet e një amvise të mirë.

Bestari mernte frymë thellë dhe nuk gjente prehje duke u rrotulluar djathtas e majtas. Edhe ajo vetë digjej si furrë për fatkeqësinë e Bestarit dhe ziente nga urrejtja për ata që e kishin katandi-

sur Bestarin kockë e lëkurë. Dihaste rëndë Bestari nga dhimbjet e plagëve, dihaste rëndë edhe Besa nga dhimbjet e zemrës!

Në mesnatë dëgjoi të kërciste çatia, të kërcisnin trarët e tavanit, sikur po shkelte mbi to ndonjë lubi. Pastaj dëgjoi një fërshëllimë të llahtarëshme. Besa, në mënyrë të vetvetishme, shtrëngoi pranë saj strajcen me takëmet e amvises dhe rrëmbeu gërshërën e madhe për t'u mbrojtur. Kur ngriti sytë, pa të zvaritej përmes trarëve të tavanit një gjarpër i zi si pënda e korbit. Iu drejua Bestarit, që t'i lëpinte plagën, që kullonte qelb si katran! Besa u spraps e tromaksur, pastaj sakaq e mblodhi vehten, zgjati dorën me guxim dhe fap... ja preu kokën me gërshërë! Ai u mblodh kulaç në këmbët e Bestarit, u përpëlit sa u përpëlit dhe pastaj ngriu në vend! Besa me majën e furkës e hodhi në këndin përballë!

Pas ndonjë ore përsëri kërciti çatia, përsëri kërcitën trarët dhe në dhomën u dëgjua një fërshëllimë tjetër e llahtarëshme. Besa pa të rrëshqiste nga një vrimë e dritares një gjarpër me ngjyrë të verdhë limon, që u sul drejt Bestarit për t'i lëpirë plagën, që kullonte qelb të verdhë dyllë! Besës i ishte shtuar guximi; fap, me gërshërë ja preu kokën edhe këtij gjarpëri dhe e hodhi kulaç te këndi!

Një fërshëllimë tjetër e tronditi dhomën, dhe Besa pa një gjarpër të bardhë, që zvarisej nga oxhaku dhe sulmoi Bestarin për t'i lëpirë plagën, që nxirrte vetëm qelb të bardhë!

Frap e frap! — Besa nuk i dha kohë dhe ja preu kokën me guxim dhe, pa ngordhur ende, e përplasi te këndi përballë!

Besa kishte harruar frikën, kishte harruar lla-

tarinë. Vehtja i dukej si ai dragoi i përrallave, që kishte vrarë kuçedrën. E lodhur e tërë djersë, por e lehtësuar nga që kishte marrë gjakun për vojtyet e Bestarit, ajo përgjoi gjer në mëngjes me gërshërën gati për t'i prerë kokën çdo gjarpëri tjetër! Gjithë natën i kishte rënë në të se Zullumqari Dushman beu do të kishte lyer jataganët me vrerin e atyre tre lloj gjarpërinjve. Një plagë e shkaktuar nga një helm i tillë nuk mbyllej kurrë me asnjë ilaç, po të mos i pritej koka gjarpërit vetë. Sepse, i kishin thënë pleqtë, sidomos gjyshja, një helm i tillë në trupin e njeriut e ndillte gjarpërin, i cili pas erës, kudo që të ndodhej, do të shkonte një herë në njëzet e katër orë, që t'i lëpinte plagën të plagosurit e t'i shtonte helmin! Përralla ishin këto, të vërteta ishin këto, Besa s'kishte si t'i dallonte në ato çaste! Veçse ja, i pa me sy! dhe i vrau vetë gjarpërinjtë me dorën e saj! Ajo e shpëtoi nga vdekja Bestarin!

Sa shkrepiti dielli majave e sa ranë rrezet mu në dhomë, Bestari hapi sytë, sikur u zgjua nga një gjumë i thellë, nga një gjumë shumë i rëndë.

— Sa paskam fjetur! Sa mirë e ndjej vehten! Sa uri që kam! — thirri me një farë gëzimi të papërmbajtur, duke fërkuar sytë e duke u munduar të kujtonte tërë ato që i kishin ngjarë, tërë ato që kishte hequr.

Hodhi rrobat mënjanë dhe hapi krahët për të matur muskujt, kur... sytë e tij ndeshën sytë e Besës, e cila i buzëqeshte që nga carani i vatrës.

— Besë! Besa ime! Hë —, u kujtova! Besë, ti më shpëtove! brohoriti tërë gëzim.

Besa buzëgas ja tregoi të tre gjarpërinjtë e ngordhur te këndi përballë:

— Këta të tre gjarpërinj të kanë ardhur natë

për natë e të kanë helmuar plagët më keq! Pa i vrarë ata ti nuk mund të shëroheshe kurrë!

Bestari u hodh në këmbë shëndoshë si lis, i lehtë si pendë:

— Më rrofsh, o Besë, ç'paske bërë! A të kujtohet kur e vramë bashkë me gurë te gryka e Lin-it atë gjarpërin e zi? Atëhere ti më pate thënë. «Bestar, unë edhe jetën do të ta fal, po të jesh ti në rrezik!» Dhe ashtu bëre vërtet! Të lumtë, e më rrofsh sa malet! Po unë... si të ta shpërblej tërë këtë mirësi?... — Bestari i fliste Besës tërë gëzim dhe vinte rrotull dhomës si një njeri që i kishte gjetur përsëri gjithë ato që kishte humbur: jetën, të dashurit, mallin!

— Lum unë! lum unë, që paskam një Besë të besës! — vazhdonte të përsëriste këto fjalë tërë mall e ngazëllim.

Pastaj u vesh e u ngjesh si dhëndër dhe të dy, të kapur për dore, u duallën dasmorëve përpara. Ata panë një çift tërë nur! Një çift të tillë s'kishin parë kurrë në jetën e tyre.

— Më shihni mua, o dasmorë! Unë jam Bestar bariu, që kam lënguar shtatë vjet nga të dymbëdhjetë plagët e Zullumqar Dushman beut! Sonte Besa ma ktheu jetën! Më shëroi, më shpëtoi! Mirëpo... kam edhe një plagë tjetër për të shëruar, një plagë që qelbte tërë vendin nga një murtajë! Kjo murtajë është Zullumqar Dushman beu! T'ja presim kokën kësaj murtaje të gjithë bashkë, po të doni të gjejmë paqe e qetësi!

— Kokën Zullumqar Dushmanit! Kokën! — thirrën dasmorët.

— Të sulmojmë të gjithë bashkë! Kokën Zullumqar Dushmanit! — dhe u prinë përpara Bestari e Besa.

Dasmorët rrëmbyen cfurqe e shata, lopata e sëpata. U turrën të egërsuar në sarajet e Zullumqar Dushmanit: flaka e tymi i sarajeve u ngrit në qiell, ndërsa gjaku i Zullumqarit vaditi tokën e lagur me djersën e me mundimin e fshatarëve!

— U hakmorëm kundra katilit: u hakmorëm!
— bërtisnin dasmorët me urrejtje.

— Unë edhe Besa ishim fejuar. Unë edhe Besa tani do të martohemi. Na urdhëroni ta bëjmë dasmën bashkë mbi hirin e sarajeve të Zullumqar Dushmanit! u tha pastaj Bestari.

Sakaq u dëgjua fyelli, të cilit po i binte Bestari; u dëgjua kënga që po këndonte Besa:

*...Kanë dalë fshati,
të bëjnë sehir,
O guri xhevahir!
...Ngreu, moj nusia jonë,
Hapna penxherenë,
Se të vjen bandilli
Me treqind trima...*

Dhe të gjithë bashkë ua nisën valleve, ngritën dollitë për lumturinë e Bestarit e të Besës e për fitoren kundra Dushman beut.

N E L U G I N A T E V E R D H A

Kalonim pranë kories së Logut të Orëve. Koria ishte një pyll borigash shekullorë me maja, që shpoinin qiellin e me degë të mpleksura, të kryqëzuara e të ngjeshura njera me tjetrën sa as rrezet e diellit nuk depërtonin dot brënda, njeriu jo se jo. Përpara pyllit shtrihej një lëndinë, që bleronte e që zverdhonte nga luleshqerrat, të cilat na dukeshin si mijëra flakë qirinjsh të ngulura në dhé. Veriu i hollë na ledhatonte faqet, ndërsa gurgullima e një burimi ujëshkumë na kënaqte shpirtin. Ujërat e këtij burimi, të pastra kristal, rridhnin tatëpjetë barishteve, lëmyshkave e zajeve të bardhë dhe na dukej sikur po na ndilte melodinë e një kënge të mrekullueshme, që na kujtonte tërë madhërinë e freskinë e maleve dhe gjelbërimin e lëndinave e të fushave, kthjelltësinë e qiellit e të liqejeve, këngën e bilbilave e të barinjve, buzëgazin e të rinjve. Rreth burimit ishin tre shkëmbinj si tri sofa pranë dyerve. Ndejtëm mbi këta gurë dhe filluam të freskoheshim me ujin e ftohtë të burimit.

— A e shikoni këtë vend? Quhet Logu i Zërave. — na foli Demo Skëndi, një bari plak që u ndodh atje. — Në atë pyll atje zërat kishin folen e tyre. Në këtë burim këtu freskoheshin e pinin ujë. Mbi këta gurë uleshin e çlodheshin, kurse nëpër këtë lëndinë shtruar me bar e me luleshqerra hidhnin valle dhe dëfreheshin.

Pastaj, pasi ndezi çibukun, shtoi:

— Thonë se zërat na paskëshin qënë qënie të perëndisë, gra të bukura me leshra të lëshuara gjer në thembrat, dhe me një forcë mbinjerëzore. Asnjë trim s'kish mundur t'ua dilte. Një herë në kohëra, që s'mbahen mend, në këtë luginë banonin tri zëra të bukura si njera tjetra, të shkathëta e të fuqishme si ato s'kish tjetër. Por na ishin edhe ugurzeza! S'guxonte bari të kalonte këtezaj, s'guxonte njeri të freskohej në këto burime a të çlodhej nën hien e atyre borigave, se do t'u ngjante patjetër një e keqe! Mirëpo... njeriu është njeri! Ai shpesh herë matet edhe me perënditë vetë! Apo jo?! — Ngriti vetullat, ngriti sytë, përdrodhi mustaqet dhe i ra gjurit me pëllëmbë të dorës:

— Apo jo?! — përsëriti. — Njeriu është njeri! Ai matet edhe me perënditë!... Jo vetëm sot, që e kemi mbyllur shejtanin mu në shishe, por edhe atëhere, në kohë që s'mbahen mend ai ishte i fortë!

Pastaj hodhi vështrimin nga kopeja e deleve, që kullosnin lëndinave dhe rrëzë kories.

— Ooorrr! Ooorrr! Eee-oooo! — thirri njady herë duke tundur kërrabën e vazhdoi:

— Në këto anë më i fortë na dolli një bari që e quanin Gjergj Kuka. Ishte nga katundi ynë. Jetën e kalonte nëpër pyje e nëpër male, nëpër çuka e nëpër lëndina, duke kullotur jo bagëtinë e kooperativës si unë, po bravaret e fshatarëve. Miqtë më të ngushtë të tij ishin fyelli dhe balashi, stopani besnik. Ulej atyre bjeshkëve e çukave, majë një shkëmbi, e i binte fyellit... «O zot, jepna vesh e të dëgjojmë!» ja bënëin fshatarët dhe bujqit linin parmendën, druvarët sopatën, gratë furkën, vajzat gjël-

përën e gjergjefin dhe të gjithë, si të magjepsur, dëgjonin fyellin e Gjergj Kukës.

Ky Gjergj Kuka një ditë na u fejua me vajzën më të varfër e më të bukur të fshatit të afërt. As ai e kishte parë, as ajo e kishte parë! Fejesa ishte bërë sipas zakonit, me shkesë. Na erdhi dita e dasmës. Edhe dasmën e bëri sipas zakonit: ai vetë nuk shkoi për të marrë nusen, po dërgoi tridhjetë fshatarë nga ata më azganët, më këngëtarët, më qeflinjtë kaluar me tridhjetë mushka, me samarët shtruar me velenxa të kuqe tërë push! Tridhjetë dasmorë! Ai i përcolli duke i rënë fyellit, i nisur tamam dhëndër me atë fustanellë kinda-kinda të ngrira, me qelshen të bardhë borë mbi kokë, me ato kallce e jellek tërë kllapodan e gajtan, dhe me ato opinga të mpleksura me retina e me xhufka në majë.

Të tridhjetë dasmorët muarën rrugën kodrës përprjetë, kapërcyen këtë lëndinë e këtë burim këtu, aty pyll atje e tërë këtë vend, që e quajnë Logu i zërave; kapërcyen edhe atë bjeshkën atje, edhe ato thepa më tutje e u varën poshtë në fshatin e afërt. Krushqit i pritën me gjithë të mirat, u nxuarën nusen, një nuse, që t'ja prisje kokën e ta pije në kupë!

«— Oho, lum ai, nuse që paska marrë! — ja bënë të tridhjetë dasmorët. Nga gëzimi ata hoqën pagurkën me raki një herë e dy, katër e pesë e t'u bënë xurxull e të filluan këngët e vallet! Këngë e valle te krushku, këngë e valle rrugës! Po, po! Me këngë e valle kaluan ato thepa-thepa, atë bjeshkë atje dhe arritën te kjo lëndinë këtu, ku më parë vallëzonin manushaqet e luleshqerrat, zorkadhet e bilbilat, shtojzavallet e orët! Në krye u printe nusja tërë gas e nur, e nisur dhe e stolisur punë e madhe, hipur mbi kalë të bardhë.

Në mes të kësaj lëndine, mu përpara këtij pylli, ja shtruan si te krushku: këndo e hiq valle, freskohu e hiq pagurkën me raki! Oshëtinë pyjet e bjeshkët, u shkelën luleshqerrat e lëndinës, u prish qetësia e pyjeve! Andejpari kishin qëlluar të tri zërat ugrzeza duke mrizuar e duke u freskuar hieve të pyllit e gurrave të kristalta. Ndërsa dasmorët tanë patën guxim e u prishën nurin, u prishën rehatinë, i prekën në sedër! Ugrzezat janë ugrzeza! Të tri zërat t'u frynë e t'u frynë e t'u bënë furtunë: Ky pylli këtu filloi të dihaste e të buçiste nga fryma e zërave zemërake, pishat e ahishtet filluan të përkulnin majat e tyre, barishtet e luleshqerrat filluan të dridheshin e të veniteshin, uji i burimeve filloi të kllokoçitej sikur po çahej dheu, kur... fët të tridhjetë dasmorët panë të dilnin nga pylli i borigave të tri zërat nursëze duke skërmitur dhëmbët e duke nxjerrë flakë nga goja. Sa çel e mbyll sytë të gjithë këta dasmorë na u bënë gurë, si këta gurët këtu; të gjithë ato mushka na u bënë kërcunj, si ata kërcunj atje. Dhe kjo lëndinë veç gurë e kërcunj t'u bë! Në mes vazhdonte të gurgullonte uji i burimeve! Ugrzezat patën mëshirë vetëm për nusen: atë e muarën me vete dhe e shpunë në shpellën e tyre, që t'u shërbente e të mos çlodhej kurrë.

* * *

Bariu Gjergj Kuka, duke i rënë fyellit, i priste dasmorët me nusen mu në prak të derës, rrethuar nga tërë fshatarët e tërë fshatarkat. Dita u thye e dielli perëndoi, por dasmorët s'po dukeshin. Hëna fjeti dhe Ylli i Karvanit mori rrugën e tij, por asnjë lajm nga dasmorët nuk erdhi. U gdhi e nesërmja.

Dielli përsëri puthi majat e maleve e pastaj zuri kupën e qiellit, mirëpo... përsëri s'u dukën as dasmorë, as nuse! Në fshat ra një heshtje që të mbyste, një heshtje varri!

Gjergj Kuka nguli fyellin në njerën anë të silahut, nguli thikën në anën tjetër, mori sopatën e madhe në dorë, u ngjit gërxeve e korieve malit përpjetë dhe arriti, ja, mu këtu ku jemi ne, te Logu i Zërave. Fërkoj sytë se mos ishte në ëndër, por jo: lëndina s'kishte, lulëshqerra s'kishte, veçse... , veçse... njerëz të ngurosur e mushka të bëra dru! Qëndronin si kishin qëlluar kush duke hedhur valle, kush duke dredhur shaminë në dorë, kush duke hedhur këmbët e duke dredhur belin, kush duke kënduar e duke pirë raki nga pagurkat! I njohu: ishin të tridhjetë dasmorët e tij! Si kishte ndodhur një mynxyrë e tillë, një gjëmë e tillë? Këtë s'e kuptoi në fillim, por pastaj i ra në të: aty kishin gisht zërat ugurzeza!

U pikëllua fort e fort sa nuk u çmend! Kraharori po i fryhej e po i vlonte nga zemërimi kundra zërave si një kazan katrani në zjarr.

Gjergj Kuka sa e sa herë e kishte dëgjuar forcën e jashtëzakonëshme të zërave. Ndonjëherë, kur i binte fyellit magjik, — si e quanin fshatarët fyellin e tij të thjeshtë prej bushi të kories së fshatit, — i ngjante sikur i çfaqeshin edhe disa vajza belholla, leshralëshuara, me gji të hedhur, me sy xixë. Por nuk e ndante dot në ishin vajza vërtet, apo zëra, apo ashtu e gënjente syri, sepse ai i tëri, duke i rënë fyellit, mendonte vetëm për vajza e për trimat të tillë të pashëm e të fortë. Dhe vetëm atyre u këndonte.

Pleqtë thoshnin se zërat na qenkishin vasha të bukura, na paskishin forca të jashtëzakonëshme.

Por Gjergj Kukës nuk i kishte qëlluar të matej me to. Veçse tani, ah, tani, që ja kishin punuar këtë të zezë, tani ja ky, ja ato!

Sa e mori këtë vendim, u fut menjëherë në pyll, ku nuk hynte as drita e diellit. Atje thellë gjeti një burim me ujë të kulluar. U ndal dhe hodhi vështrimin rreth e rrotull: asnjë monopati nuk çante përmes ahishtes. Përmbi burim ngrihej një shkëmb maja-maja si thika majamprehta drejtuar qiellit. Nën të shtrihej një hon tërë gurë e shkëmbinj, një rrëgallë e vërtetë. Degët e ahishtes ishin kryqëzuar e mbërthyer njëra me tjetrën.

«Me siguri këtu duhet të jetë Logu i zërave.» — mendoi me vete. E ndau shkurt: «Këtu, buzë këtij burimi, do të pres të vijnë zërat të pinë ujë: Do të matem sheshazi me to! Ja gjallë, ja vdekur! Rrugë tjetër s'ka!»


Priti një ditë, pritë dy ditë, pritë tri ditë! Kur një mëngjes u hapën degët e mbërthyer, rëshpëruan gjethet, u çel një monopati e nga thellësia e ahishtes u duk një nuse ngarkuar me bucelë. Bariu u mahnit: Vallë, kështu si nuset e fshatrave tona u veshkan edhe zërat? — tha me vete me çudi. Atë ças, nusja me bucelë e përshëndeti:

«— Mirë se të gjej! —

«— Mirë se të pruri e mira! — ja ktheu bariu dhe vazhdoi: — Si, gjer këtu vini të mbushni ujë, moj motër?

Ajo kryqëzoi vështrimin me atë të bariut, u bë flakë e kuqe në fytyrë dhe foli:

«— Se mos e di se ku jam unë! Erdhën krushqit e më muarën. Kur dolën në një lëndinë plot barishte e luleshqerra, dasmorët ja nisën këngës, valles e pijes. Kur fët e fët, atje na duallën tri zëra



ugurzeza, na u zemëruan se dasmorët u paskishin shkelur tryezën, u paskishin prishur rehatinë e mrizeve e t'u frynë e t'u frynë nga zemërimi sa që nxuarën flakë nga goja dhe i hukatën të gjithë mu në vend! Dasmorët u bënë gurë, mushkat u bënë kërcunj! Mua më muarën me vehte, që t'u gatuaj e t'u mbush ujë!

Gjergj Kuka sakaq i ra në të se kjo ishte nusja e tij, por e mbajti veten:

«— Te kush të martonin, moj nuse? — e pyeti duke u shtënë si njeri krejt i huaj.

«— Te kush? Unë me sy s'e kisha parë, veçse me veshë e kisha dëgjuar që ishte nga fshati i afërt, quhej Gjergj Kuka dhe ka lënë emër se i bie fyllit magjik, sa edhe zërat shastisen pas tij.

«— Hahaha! — qeshi djaloshi papritur, ndërsa nusja edhe një herë u bë si lulëkuqe!

«— Pse qesh? — e pyeti e druajtur.

— Mos u druaj, Tanë! Unë jam Gjergj Kuka, dora vetë! — iu rrëfye trimi.

Vajza padashur u habit dhe bucela i ra në burim dhe turbulloi ujërat e qehlibarta.

«— Ma thoshte zemra se ti do të ishe! — belbëzoi tërë ngashërim. «— Po tani? — i shpëtoi kjo pyetje.

«— Tani?! — përsëriti pyetjen me dyshim edhe bariu. «— Tani ti e ke në dorë. Po të dëgjosh fjalën time, kam shpresë të madhe të shpëtosh edhe ti, edhe dasmorët!

«— Folë! Të betohem për ç'kam më të dashur, për nënë e babë, për vëlla e motër, për sytë e ballit e për bukën e gojës, se fjalën tënde unë do ta çoj në vend, edhe sikur ta di se mund të humbas kokën — iu betua Tana dhe për herë të parë i qeshi buza, për herë të parë i lindi shpresa.

Gjergj Kukës i erdhi t'i binte fyellit e të magjepste tërë atë luginë të zërave, se jo vetëm kishte gjetur nusen, po edhe kjo na qënkish nuse për kokë të nuses! Na qënkish sa e bukur aq edhe trimë! Mirëpo mendoj për dasmorët, mendoj për fatkeqësinë e tyre.

«— Ti, Tanë, bëj si të bësh dhe ua mëso atyre tri zërave se ku e kanë fuqinë dhe ku i kanë fshehur ushqimet. Po e zbulove këtë, kusurin ma lerë mua. — e këshilloi trimi. «— Unë nesër do të të pres përsëri këtu.

Tana mbushi bucelën me ujë dhe u zhduk në mes të degëve të kryqëzuara e të mbërthyera të ahishtes, duke i dhënë fjalën e nderit se do të bënte çmos për të kryer porosinë e tij.

Vajti te Mrizi i Zërave, një vend, që ishte në thellësi të pyllit midis lëndinave, luleve ngjyranjyra e bilbilave. Atje gërshetohej kundërmimi i erëkëndshëm i barishteve e i çumricave me magjinë e këngës së bilbilave e me shkëlqimin e rrezeve të diellit. Nusja e shtroi sofrën me tërë të mirat mbi lulëkuqet e mbi manushaqet. Të tri zërat u ulën për të ngrënë. Ç'nuk kishin në sofër, qumëshfin e dallëndysheve! Nusja rrinte në këmbë e u shtinte verë e mjaltë, kurse vetë as hante, as pinte.

«— Ç'ke, moj nuse, që as ha e as pi?— e pyeti zëra më e vogël.

Nusja u shti e prekur në sedër, dhe e pikëlluar:

«— Moj motër — zërë, si të ha e si të pi bashkë me ju, kurse kam kaq ditë midis jush e s'më besoni as vozet e verës, as qypat me mjaltë, as magjet me bukë, as kadet me bulmet, as burimin e forcës suaj?! Ju më kini në dorë dhe mund të më ngurosni kur të doni! —

Zërat e mëdha, me të dëgjuar këto fjalë, u bënë vrer! U bënë gati ta hukatnin e ta yshtnin, por e vogla, ajo më shpirtmaira, i përmbajti:

«— Ka të drejtë nusja! Ajo ha e pi bashkë me ne e asgjë nuk di! Ka të drejtë! — u tha, por nuses nuk i rrëfeu asgjë.

Dita u thye. Dielli u prir nga perëndimi, bilbilat u mblodhën nëpër foletë, veçse era e këndëshme e luleve ngjyra-ngjyra u mpleks me rrezet e arta të hënës. Të tri zërat u shtruan për darkë në dritë të hënës mu pranë burimit të kristaltë, që gurgullonte duke përsëritur këngën e bilbilave, që flinin. Nusja përsëri u rrinte në këmbë duke u shtënë verë e mjaltë, por asnjë kafshatë nuk vinte në gojë.

Zërës së vogël iu dhimbs: e zuri për dore, e mëkoi duke i shtënë në gojë një lugë mjaltë e një gllënjë verë; e përsëriti këtë edhe dy herë, edhe tri herë. Pastaj mbështeti faqen mbi të sajën, buzët mbi veshët e saja dhe i pëshpëriti:

«— Ushqimin e kemi treqind pash nën dhe, kurse forcën e kemi në brirët e arta të tri dhive të egra, që kullosin në Lugjet e Verdha. Asnjeri nuk i shtie dot në dorë! Se po i zuri, ne sharruam sa-kaq!

Paf-paf! u ra lehtë faqeve te nuses me pëllëmbën e saj të bardhë borë.

«— Tani ulu e na zbukuro sofrën! — e ftoi.

Nusja, tërë gas e tërë nur, u ul dhe hëngri darkën me shije të madhe. Ashtu si qeshte hëna në qiell, ashtu i qeshte edhe zemra Tanës në kraharor.

Të nesërmen herët, me bucelën mbi shpinë u gjend te burimi. Atje gjeti Gjergj Kukën, që po e priste me padurim. Ajo ja tha të gjitha. Ai e këshilloi përsëri:

«— Shko te zërat dhe t'u shërbesh si gjer më tani. Mos u tut për asgjë. Shumë shpejt do të shpëtosh edhe ti, do të shpëtojnë edhe dasmorët! — shtoi me besim.

Ajo buzëqeshi. Ai buzëqeshi. Ajo e vështroi me sytë xixë, ai e vështroi me sytë zjarr dhe u ndanë. Ajo humbi në thellësitë e ahishtes, ai ra tatë-pjetë Lugjeve të Verdha për në fshat.

Gjergj Kuka dha kushtrimin anembanë, që të grumbulloheshin të gjithë fshatarët nga ishin e nga s'ishin bashkë me qentë, me sëpatat, me thikat, me litarët e me cfurqet e të dilnin të zinin gjallë të tri dhitë e egra të Zërave, dhe të prisnin qerestenë e ndaluar për të bërë kulla në vend të kasolleve.

T'u mblodhën mizëri fshatarësh, mizëri zagarrësh dhe sulmuar Lugjet e Verdha. Përpara u printe Gjergj Kuka me Balashin e vet. Zunë shtigjet e t'u futën thellë e më thellë korieve e pyjeve, u ranë prozhmeve e luginave, thepave e çukave shtatë ditë e shtatë net. Prenë qerëste sa mundën dhe koriet e pyjet i sheshuan. Në të tetën ditë, kur u shtri të flinte syri i qiellit, i zunë gjallë të tri dhitë e egra me brirë të arta dhe i shpunë në fshat. Gjergj Kuka i mbylli në shtatë zëndane, kurse fshatarët filluan të ngrenin kulla të reja me qerestenë e Lugjeve të Verdha.

Të tri zërat filluan të dobësoheshin e të zverdheshin. S'u mbeti gjak në fytyrë. Nuk u shkonte as buka e grurët, as vera e kuqe, as mjalti i ëmbël. Nuk u gëzohej as zemra për gjithë ato rreze të diellit, për tërë atë dritë argjëndore të hënës, për gjithë ato lule ngjyra-ngjyra, për tërë ata bilbila që

më këndonin aq ëmbël dhe, as për gjithë ato hiesira e burime të ftohta, për gjithë ato bukuri të bleri-meve, të pyjeve e të korieve e për gjithë ato madhështi të thepave e të lëndinave.

I ndillin dhitë, por ato nuk u venin. I kërkuan e ku nuk i kërkuan! Përsëri s'i gjetën dot!

Nuses Tanë iu dhimbs zëra e vogël, e cila dalngadalë po hollohej e po tretej si qiri, si ta kishte zënë ajo sëmundja e keqe, që i thoshin në fshat oftikë! S'm'i kishte më ato duar të buta si pambuku e të bardhë si bora, s'më kishte më atë zë të ëmbël e përkëdhelës! Iu dhimbs, iu dhimbs shumë, prandaj i tregoi të vërtetën:

«— Mos i kërkoni dhitë më kot, mos i ndillni më kot! Ato i ka zënë bariu Gjergj Kuka, sepse ju i keni ngurosur të tridhjetë dasmorët me të tridhjetë mushkat! Sepse ju i kini rrëmbyer nusen! Gjergji dhitë jua ka marrë peng!

Zërave sa s'u ra pika, kur i dëgjuan këto fjalë! Po ç'të bënin? Bariu i kishte mundur!

Duallën nga mrizat e tyre, duallën nga koriet e nga lëndinat, u larguan nga burimet e nga hiesirat e tyre shekullore, e ranë tatëpjetë fshatit të rraskapitura, të stipsosura, të turpëruara, pa nur e pa gas!

«— Olele, e mjera unë! — rënkonte e vogla.

«— Olele, fatkeqja unë! — ankohej e mesmja.

«— Olele, të zezat ne! Njeriu na mundi, dolli më i fuqishëm! — skërminte dhëmbët më e madhja, ajo që quhej Zëra e Thepave.

Mu në bjeshkën përballë u dolli një bari, — vërtet i pashëm e shpatullgjërë, por nuk ishte dragua, ishte vetëm njeri! Veçse ai i vështroi me ata sytë — xixë, sikur i përvëloi.

«— A mos je ti Gjergj Kuka? — e pyetën ato.

«— A mos jeni ju zërat ugurzeza? — ja priti ai huerëndë.

Të tri perëndeshat panë ç'panë dhe i ranë më gjunjë Gjergj Kukës, bariut që kulloste bravaret e fshatit:

— Aman, derman! Na ke në dorë! Po na lëshove dhinë e egra brirëarta, ne zëra do të mbetemi! Po na i there, edhe ne vdesim bashkë me to! Në dorë na ke! E pranojmë se të kemi bërë keq, se kemi qenë shumë cmirzeza! Por, — tani të japim fjalën e nderit se, po na i ktheve dhinë brirëarta, ne do t'i bëjmë ashtu si ishin të tridhjetë dasmorët e të tridhjetë mushkat; edhe nusen do të ta kthejmë shëndoshë si molla! Në Logun e Zërave le të hedhin valle të gjithë fshatarët, le të kullosin bagëtitë! — iu lutën të tri perëndeshat duke dërdhur lotët sa një kokër arre e duke i puthur këmbë e duar fshatarit të varfër.

Gjergj Kuka u ngrit në këmbë shtatmadh e shpatullgjerë, i pashëm dhe azgan! Ishte vërtet njeri, por «edhe njeriu qënka dragua» — menduan zërat të drojtura e të tmeruara.

«— Më parë më paguani borxhin, që më keni! M'i ktheni dasmorët me nusen, pastaj shohim e bëjmë! — iu përgjegj bariu. Të tri zërave iu duk sikur vulosi vetë i madhi zot, që ish kudo e që s'ish gjëkund!

Deshën s'deshën, ashtu bënë:

Në Lugjet e Verdha u ngjallën lëndina dhe korie: ata njerëz të ngurosur përsëri filluan vallet, përsëri filluan këngët, përsëri filluan pijet edhe gëzimi mbushi qiell e dhe! Ndërsa nga fshati për-

sëri u përhap kënga e magjishme e fyellit, që mbu-
shi me gëzim tërë fshatarsinë anembanë.

Dhëndri i ri Gjergj Kuka, duke i rënë fyellit
të magjishëm, bashkë me fshatarët, burra, gra, pleq,
të rinj e kalamanj, doli t'i priste krushqit me nu-
sen, që zbrisin nga Luginat e Verdha.

Të tri zërat përmes ahishteve që kishin mbetur
pa prerë, nxuarën syrin dhe përgjuan me zemër
të vrarë kullat e reja, që ngrinin fshatarët me qe-
restenë e prerë nga pyjet e tyre; përgjuan gëzi-
min e përbashkët të fshatarësisë për dasmën e
Gjergj Kukës edhe u pushoi zemra në vend, kur
panë se tri dhitë, që muarën gërxhet përpjetë,
ishin të handakosura e gadi të ngordhura.

Nuk patën kohë as të thoshin:

«Kaq e patëm edhe ne!»

SHQIPONJA E VOGËL

Sikurse ja ndjente zemra Mujit ashtu u bë: nusja i fali një djalë me yll në ballë! Që në djep e pagëzuan Shqiponjë e Vogël, se me të vërtetë lindi i fortë si shqiponjë, guximtar si shqiponjë, i shpejtë si shqiponjë.

Pa mbushur as shtatë vjet, e ëma e dërgoi të kulloste dhitë në mal. Një ditë, në mes të dhive, u ngatërrua edhe një si keci ngjyrë hiri. Sa bënte të ikte keci, djali fap me një të hedhur e kapte. Mbrëmanet bashkë me dhitë e futi në qilar edhe kecin ngjyrë hiri. U ngjit lart në konak dhe i tha s'ëmës i zemëruar:

— Moj nënë, ai keci ngjyrë hiri ma ka sjellë shpirtin në majë të hundës! Më lodhi shumë!

— Ne s'kemi keci ngjyrë hiri, mor bir! — iu përgjegj e ëma.

Për t'u siguruar, mori kandilin dhe zbriti poshtë në qilar. U habit fort, kur pa se keci ngjyrë hiri ishte një lepur! U gëzua fort zemra e nënës!

— Ai nuk është keci, mor bir! S'e kanë zënë dot gjahtarët me zagarë, e paske zënë ti me duar! Sa i shpejtë që je! Lum nëna! — e përgëzoi.

Kur mbushi të nëntë vjetët, vogëlushi pyeti t'ëmën:

— Moj nënë, si s'më ke thënë një herë se ç'është bërë babai im?

E ëma kafshoi buzët dhe u bë dyllë e verdhë:

si t'i tregonte se i ati me xhaxhanë, pas aq e aq luftërash heroike, kishin rënë në burgjet e armikut? Si t'ja thoshte këtë të vërtetë kaq të hidhur?

— Eh, mor bir, ti ke pasur baba Gjeto Bashë Mujin, kreshnik mbi kreshnikë! Ke pasur edhe një xhaxha, që e quanin Halil. Edhe ai si babai, trim mbi trima ishte! Kanë pasur armë, kanë pasur pajime kreshnikësh edhe gjokë, e ua kishin frikën të shtatë krajlitë! Por për fat të zi, një ditë para se të lindje ti, mbaruan që të dy nga sëmundja e keqe!

Nëna kafshoi buzët, kafshoi gjuhën dhe një gehre tjetër e verdhë ja mbuloi fytyrën.

Djali nëntëvjeçar u bë me krahë; ai e ndjeu vehten kreshnik përmbi kreshnikë, që paskish pasur një baba të tillë, një xhaxha të tillë.

— Mos u pikëllo, nënë e dashur! Hidhe tej vellon e zisë! Në logun e kuvendit unë do të nderoj kujtimin e babait e të xhaxhait. Veçse m'i jep armët e babait e gjokun e tij!

Nëna, përmes buzëgazit krenar dhe dhimbjes që e kishte brejtur nëntë vjet me radhë, u mundua ta mbante të birin:

— Mos, bir, mos! Ti je ende kërthinjë, qumështin e nënës ende ma ke në buzë! Mos! Gjokun e babait tënd kam nëntë vjet që po e ushqej vetëm me verë e me oriz. Tani është bërë aq i hazdisur e aq i gjallë, sa edhe vetë babai yt sikur të ishte, nuk e zaptonte dot!

Por, vogëlushi nëntëvjeçar rrëmbeu armët pa lejen e s'ëmës, ngjeshi jataganin, shaloi gjokun dhe «fërr!» u gjënd mbi të! Ai i vogël, i vogël si gogël, gjoku vigan nën këmbët e tij.

— Nëno, më jep bekimin! — thirri në majë të doriut, duke tundur jataganin e rëndë.

«Kurmin ma ka të vogël, fare, por... zemrën ma ka të madhe, fort!» — mendoi ajo me krenari.

— Paç bekimin tim, mor bir! Kurdoherë më dalsh faqebardhë! Kurrë mos na koritsh.

Kështu e uroi e ëma, por në kraharor zemra e saj përpëlitej si një zog i therur.

Të parët e vendit i gjeti këmbëkryq, me çibukët e gjatë ndezur e duke nxjerrë shtëllunga tymi nga hunda e nga goja.

— Puna mbarë, o xhaxhallarë! — i përshëndeti.

Asnjë nuk ngriti sytë, asnjë nuk lëvizi nga vendi.

— Jam i biri i Gjeto Basho Mujit. Vendin e të ndjerit baba po e zë unë! — shtoi rëndë-rëndë.

Përsëri asnjë nuk ngriti sytë, përsëri asnjë nuk lëvizi nga vendi.

Ai pritë majë doriut dhe veshi i zuri fjalët që thanë: një armik po i turrej vendit të Arbërit, dhe asnjë nga të parët nuk vendoste t'i dilte përpara!

— Mos u tutni, bre xhaxhallarë! Ja, unë jam gati të matem në shesh të burrave me armikun. Apo s'kam edhe gjokun të mirë!


Kësaj here, të parët e vendit ngritën sytë, ngritën kryet dhe e vështruan. Njëri nga ata ja pat:

Pa ulu prej fikut një herë, ti bir i Mujit! Të ishe ti aq trim sa thua, do të kishe shpëtuar babanë dhe xhaxhanë, që të dergjen prej nëntë vjetësh në burgun e Krajlit!

Shqiponjës së vogël nuk iu desh më tepër. Pikkë e vrer, u kthye në shtëpi!

— U korita! U korita nënë! Nuk më mban toka as qielli. Vetëm me gjak lahet ky turp! — i tha nënës.

E ëma i shtrëngoi duart me duart e saja, i mo-



ri kokën në prehër, i përkëdheli flokët e faqet, i puthi ballin e syrin, i foli urt' e butë, me duf të tulatur, me krenari të tulatur, dhe i rrëfeu të vërtetën ashtu si kishte ngjarë.

Kraharori i Shqiponjës së Vogël u ndez furrë për hakmarrje. Ngjeshi armët, rrëmbeu jataganin dhe shaloi gjokun:

— Ja do të shpëtoj babanë dhe xhaxhanë, ja gjallë nuk kthehem! — bëri bë përpara s'ëmës.

— Hallall sisën, që të kam dhënë! — e uroi e ëma e ndezur kësaj here nga krenaria. — Paç uratën time, mor bir. Kurrë mos na korit as përpara miqve! Kreshnik i ashpër dhe fisnik qofsh kurdoherë!

Vocrraku u përkul dhe i puthi dorën.

— Mos harro: yt atë ka pasur një motërma, një grua të varfër të vegjëlisë, që e quanin Maro. Shko fill në shtëpi të saj dhe hapja zemrën. Ajo me siguri do të të ndihmojë, — e këshilloi e ëma.

Shqiponja e Vogël i vuri në xhep fjalët e nënës dhe u bë ërë: kaptoi male e kaptoi fusha, kaptoi gryka e kaptoi lumenj e t'u gjënd në qytetin e Krajlit, në portën e shtëpisë së motërmasë Maro.

Marua, një grua gjysmë e thyer, me një shtat si çetinë e me sy si kokrra ulliri, u habit për atë kalorës kërthinjë veshur e ngjeshur si kreshnik, kaluar mbi atë dori të harlisur. Dorinë e njohu, por kreshnikun e vogël jo.

- Ai u paraqit:

— A je ti teto Maro, motrëmaja e Gjeto Basho Mujit? Unë jam i biri!

Motërma Marua hapi krahët dhe e shtrëngoi në gji trimin e vëllamit arnaut. Pastaj e gostiti me gjithë të mirat.

— Të lumtë! Nuk vdes kurrë ai baba që ka një

djalë si ti, jo vetëm trim, po edhe të besës! — e përgëzoi!

— Motërmaja e urtë dhe besnike, pasi e dëgjoi mirë e mirë kreshnikun e vogël, i tha:

— Të gjithë krajlët një turi kanë! Të gjithë krajlët janë armiq të rajesë. Edhe Krajli ynë kështu është. Unë nuk do të kursej asgjë për të shpëtuar nga kthetrat e Krajlit vëllamin tim, Mujin.

Pastaj e këshilloi:

— Po të vesh si djalë maxhari e po të nis drejt e te Krajli. T'i thuash Krajlit: «Të falem, o Krajl i madh, unë biri i vetëm i oxhakut të Moresë së Zezë! Gjithë njerëzit më vdiqën, dhe babai i shkretë, para se të jepte shpirt, më la amanet të ta sjell si dhuratë tërë Morenë e Zezë edhe mua të më rritësh në pallatin tënd». Kështu t'i thuash. Kur të vijë dita për të çliruar Mujin unë do t'i zbukuroj dritaret e shtëpisë sime dhe rrugicën me flamurë të bardhë. Këta flamurë të bardhë do të të tregojnë drejtimin, që duhet të marrësh për të dalë jashtë qytetit e për të ikur në vendin e Arbërit.

Si e këshilloi Mara, ashtu bëri edhe Shqiponja e Vogël.

Krajlit, kur e pa vogëlushin, iu bë zemra mal!

— Eh, ç'mik me kokë që e kam pasur kreshnikun e Moresë së Zezë, ndjesë pastë! Zot, o Zot, ki mëshirë për robin tënd, që të prehet i qetë në parajsë! Amin! — u lut Krajli kur dëgjoi se në dorë të tij i kish lënë tërë atë trevë të Moresë së Zezë! Pastaj, i ngazëllyer nga dhurata e paçmuar, shtoi:

— Ti do të jesh krahu im i djathtë! Unë kam dy binjakë, ti do të jesh i treti me të drejta të barabarta! Do të rritesh si princ e shkuar princit.

Pastaj Krajli porositi që të bëhej në pallat një

gosti e madhe për kujtim të ndjerit të madh dhe për nder të birit të tij, që e mbajti amanetin e t'et e ja solli Krajlit si dhuratë tërë atë trevë!

Princi i vogël i Moresë së Zezë i hyri në zemër shumë shpejt Krajlit. Filluan të kuvendonin për punë trimërie, për miq e për armiq e sulme të reja. Një mëngjes, Krajli krenar i tha:

— Po përgatitem tani të sulmoj përsëri vendin e Arbërit! Dy arnautët më të rrezikshëm të këtij vendi, Gjeto Basho Muji dhe Halili, po dergjen në burg që këtu e nëntë vjet. Po para se të sulmoj vendin e tyre, duhet të qëroj hesapet me këta të dy, se këta janë aq të fuqishëm e aq të rrezikshëm, sa edhe nga burgu mund të ma punojnë qindin, ja, mu këtu, në vatrën time, kur unë të jem në ballë të sulmit. Prandaj kësaj jave do t'u pritët koka! Kam ftuar të vijnë miq nga të Shtatë Krajlitë për të parë se si u pritët koka edhe kreshnikëve më të mëdhenj, siç janë këta të dy arnautët!

Shqiponja e Vogël u drodh i tëri: edhe një javë, edhe një javë e mbaronte babai me xhaxhanë! «Edhe një javë!» psherëtiti rëndë, por nuk u dha.

— Po, po, edhe një javë, o bir i mikut tim — shtoi Krajli. Tamam ditën e diel do të kemi festë të madhe!

Shqiponja e Vogël mblodhi veten. Kuvendoi me të rëndë-rëndë:

— Armiqtë e tu ishin edhe armiqtë e babait tim! Të lutem shumë, Krajl, më bëj një nder, më lejo mua t'ua pres kokën me jataganin, që e kam trashëguar nga sundimtari i Moresë së Zezë, se ndryshe nuk prëhet shpirti i të ndjerit baba, i mikut tënd të ngushtë!

— Të lumtë, bre kreshnik i vogël nga mosha, po i madh nga zemra, — u ngut ta lavdëronte Kraj-

li. — Të lumtë! Le të bëhet ashtu si thua ti, të çuditet i madh e i vogël!

— Veçse, më parë, më lejo të vete t'i shoh me sy në burg e të prëhem duke i parë në ato vuajtje! — ndërhyri princi dhe shtoi gjoja me dhimbje: — Ah, baba, të ishe gjallë, ti vetë do t'ua pije gjakun me grushte armiqve të tu!

Tundi jataganin në ajr duke u shtirë si i tërbuar:

— Deh, o jatagan, gëzohu, se do të ngopesh me gjak arnauti!

Të dy princërit binjakë u mahnitën nga ato që thoshte miku i tyre moshatar. Ata iu lutën t'et që të shkonin me kreshnikun e Moresë së Zezë të shihnin arnautët e burgosur.

Krajli nuk ua prishi: të nesërmen i dërgoi që të tre në burg. Ç'i panë sytë Shqiponjës së Vogël! Zbritën e zbritën kush e di sa pash nën dhé me fener në dorë. Sa u hap dera e qelisë, u vrau hundët era e mykut dhe e lagështirës! Pranë njeri tjetrit, lidhur këmbë e duar me pranga, gjetën dy njerëz zhytur në llucë gjer në gju, veshur me lecka të kalbura e tërë lëmyshk, me mjekra të lëshuara gjer përdhe, me flokë të rëna, me lëkurën e trupit që po iu zhvoshkesh! Ata ishin Muji dhe Halili! Nëndë vjet pa u ndërruar, nëndë vjet pa u larë, nëndë vjet pa u rruar! Ishin bërë kockë e lëkurë, veçse sytë i kishin prush të ndezur:

— A jeni, si jeni, o burra! — i përshëndeti Shqiponja e Vogël në gjuhën shqipe, fjalë këto që s'i kuptuan fare as të dy binjakët e as roja. Bëri toka me ta duke u shtrenguar duart fort e duke i vështruar drejt në sy me një mprehtësi të mahnitëshme. Muji dhe Halili, në forcën e duarve edhe në

vështrimin e mprehtë të syve njohën veten e tyre.

— Ti je biri im! — bëlbëzoi i ngashëryer Muji.

— Ti je nipi im! — pëshpëriti Halili.

— Po unë vet, jam! Bëhuni gati, që të fluturojmë ditën e diel së bashku që nga sheshi i qytetit! — u dha zemër dhe sakaq vrëri vetullat, mblo-dhi grushtet dhe u kërcënua në gjuhën e Krajlit:

— Kështu e pësojnë të gjithë armiqtë tanë!

E mbyllën derën e hekurt të qelisë me tërsëllëmë e me përbuzje.

— Im bir!

— Im nipi!

Këto dy fjalë oshëtinë në atë qeli, pasi u mbyll dera. Të dy kreshnikëve, që kishin ndenjtur në burg aq vjet, filloi t'u vijë çehreja në fytyrë, filluan t'u forcohen muskujt, filloi t'u përtërihet forca e humbur! Mendimi se biri e nipi i tyre ishte aq i fuqishëm, më i fuqishëm se një kreshnik i vërtetë në moshë, i bënte që të krenoheshin.

Të dy princërit e vegjël i folën Krajlit me urrejtje për të dy arnautët, që ishin katandisur aq keq! Binjakët iu lutën atit të tyre t'i lejonte të dilnin bashkë me princin e Moresë së Zezë në shesh të qytetit.

Krajli u krekos me këtë kërkesë të binjakëve të tij. Ai kujtoi se edhe piçirrukët e tij ishin shqiponja të vërteta!

— Bukur fort! — u tha. — Por bëni ca ushtri-me me gjokë e me jataganë!

Të tre princërit filluan ushtrimet në shesh të qytetit. Sa fort që rëndonte jatagani në dorë të binjakëve e sa i lehtë që dukej në dorë të Shqiponjës së Vogël! Po edhe gjoku i Shqiponjës së Vogël fluturonte, ndërsa dorinjtë e binjakëve mezi merrnin vrapin!

Shqiponja e Vogël e dinte se edhe gjokët e Krajlit fluturonin, por binjakët nuk dinin as t'i ngisnin e as t'i nagasin. I lindi një mendim dinak:

— A e dini ç'të bëjmë? — Kërkoj mendimin e Krajlit, si burrë me katërqind drehem mend. — Është mirë t'i mbaj frerët e gjokëve të princërve lidhur në shalën e gjokut tim. Sa herë të vij rrotull unë, aq herë të vijnë edhe ata. Sa herë të ngre shpatën unë, aq herë ta ngrenë edhe ata! Në sytë e turmës të tre njësorj do të dukemi!

Krajlit i erdhi mirë.

Dhe ashtu u bë.

Erdhi e diela, dita e shumëpëritur. Gjëmuan timpanet e ranë boritë e këmbanat, e t'u mblodhën në shesh të qytetit i madh e i vogël, kamës e varfanjakë! Mbi një tribunë veshur tërë mëndafshe, sixhade dhe lëkura kunadheje, zunë vend Krajli dhe Krajllica me soj e sorollop, e me tërë rrethin e tyre ugurzi, veshur e ngjeshur me shpata e me jataganë, me thika e me topuze, krekosur me mustaqe gjer te veshi, me jelekë e shallvare prej cohe të kuqe të ngarkuar me sërma e kllapodonë, gajtanë e hoja, me pisqolla e zinxhirka ari e argjëndi varur në kraharor!

Kështu ishin krekosur edhe miqtë e ardhur nga të Shtatë Krajlitë.

Të dy princërit binjakë me princin e Moresë së Zezë hynë në sheshin e qytetit kaluar.

— Tak-tak! Tak-tak! — u rrihte zemra edhe trimave mustaqemëdhënj, që u shushatën, kur dëgjuan, që ata piçirrukë ishin aq të fortë sa do të rrezonin për tokë kreshnikët më të mëdhënj të vendit të Arbërit.

— Tak-tak! Tak-tak! — i rrihte zemra edhe Shqiponjës së Vogël nga ankthi se si do të përfundonte kjo punë e madhe!

Gjokët e princërve të vegjël lodronin duke iu afruar qëndrës së sheshit. Trok e trokthi, gallop, e gallopti rëndte e rëndte gjoku i Shqiponjës së Vogël. Trok e trokthi, gallop e gallopti rëndnin e rëndnin pas tij të dy gjokët e princërve binjakë! Çukërmonthe dheun gjoku i Moresë së Zezë, çukërmonin dhënë edhe gjokët e princërve binjakë!

Ngrihej kas në këmbët e para gjoku i Moresë së Zezë, ngriheshin kas në këmbët e para edhe gjokët e Krajlit të madh! Shqiponja e Vogël dukej si një krushkëmadhe, që shoqëronte nusen dhe dhëndrin duke u hequr kuajt pa frerit!

Përsëri ranë trumbetat e timpanët, përsëri gjëman buritë edhe këmbanët: të dy kreshnikët e vendit të Arbërit i suallën në shesh të qytetit me duar e këmbë lidhur në pranga. Nëndë vjet pa parë dritën e diellit, nëndë vjet pa shkelur bar të njomë, nëndë vjet pa marrë ajr të pastër, nëndë vjet pa u larë pa u ndërruar!

Sa e madhe ishte zhurma e trumbetave dhe këmbanave të Krajlit, trefish më e madhe ishte zhurma e vargonjve, që i kishin mbajtur kreshnikët në duar e në këmbë nëndë vjet dhe që i zvarisnin tani përmes sheshit të qytetit më të madh të Krajlit. Rëndë-rëndë i zvarisnin vargonjtë, rëndë-rëndë i hidhnin hapat në atë shesh, rëndë-rëndë ngrihej edhe oshëtima e tyre si rrufe në qiellin e të Shtatë Krajlëve!

Prapa kreshnikëve shkante xhelati, i mbështjellë me një rasë të zezë, që nga koka gjer të këmbët, ndërsa sytë i ndrinin, si dy thëngjij të ndezur! Me të dy duart përpara kraharorit mbante shpatën e vdekjes!

Kortezhi i vdekjes u ndal në mes të sheshit.

I tërë sheshi sikur mori frymë thellë; i tërë

qyteti sikur u mbyl nga agonia! Por ankthi i kishte kapluar edhe të dy kreshnikët me Shqiponjën e Vogël: ç'rrugë do të merrte jeta e tyre?

Gjoku i Shqiponjës së Vogël filloi të ngrihej kas të çukërmonte me forcë dheun e zi e të hingëllinte me dridhja, sa që filloi të gjëmojë gjithë qyteti, gjithë vendi! Ai kishte njohur të dy zotërinjtë e tij!

Shqiponja e Vogël me jataganin lart vështroi rreth e rrotull; pastaj e hodhi vështrimin përtej sheshit, përtej turmës dhe nga ana e lindjes, në mes të qytetit, dalloi një flamur të bardhë, dy, tre, pesë, dhjetë flamurë të bardhë, që valviteshin në disa dritare. E kuptoi sakaq: ata flamurë të bardhë i kishte varur motërma Mara.

Ankthi arriti kulmin:

Xhelati lajmëroi:

— Hej, hej, i madh e i vogël, kamës e harbutë, dëgjoni! Sipas urdhërit të Krajlit të madh, miku i vogël me zemër të madhe i Moresë së Zezë bashkë me të dy princërit binjakë do t'u presin kokën të dy kreshnikëve nga vendi i Arbërit, që janë armiqtë më të rrezikshëm të mbretërisë sonë!

Të gjithë hapën sytë, të gjithë ngritën veshët, të gjithë u mahnitën nga forca që paskeshin këta të tre princër biçirrukë! Ishte vetëtimë e rrufe, e vërtetë apo ëndër? Princi i Moresë së Zezë ngriti njëherë jataganin e rëndë dhe e hodhi tej kokën e djallit të zi! Ngriti jataganin herën e dytë e vanë tej prangat e Mujit! Ngriti jataganin herën e tretë dhe u përplasën tej prangat e Halilit. E, për çudi, të dy robërit, si me magji, u gjendën majë kuajve me jataganë zveshur dhe, duke shtrënguar në gji princërit binjakë, ja dhanë me të katra dhe si rrufe çanë she-shin, çanë rojën, çanë turmën e i ranë andej nga valviteshin flamurët e bardhë, nëpër rrugën dredha-dre-

dha të qytetit, pastaj përmes prozhmeve e lëndina-
ve, e fluturimthi, si zogj të lirë, kapërcyen shtigje
e hone, male e thepa, dhe arritën shëndoshë e mirë
në vendlindjen e tyre, në vendin e Arbërit!

Kur muarën vesh të vërtetën, u mahnitën e u
nemitën Krajli e Krajlica, gjithë ata «trima» musta-
qemëdhën si edhe të gjithë shtetasit e të Shtatë
Krajlive, e, me gjithë që, pas disa kohe ja kthyen
shëndoshë e mirë të dy princërit binjakë, Krajlit i
dështoi e i ra në pus gjithë ai plan i madh për të
sulmuar vendin e Arbërit.

MALLËKIMI I NENËS

Ju s'e kini parë Zaverin tonë se ç'vënd i mrrekullishëm është! Unë shkoja kurdoherë, kur isha i vogël. Harroja shqerrat dhe më rrëmbente bukuria e natyrës: liqeni, brigjet me atë gjelbërim të përherëshëm të dëllinjave; si ujdhesat dhe tumbat e gjiret dhe vargjet e maleve rreth e rrotull me atë ujdhesë të madhe në mes si një anije përrallore më mahnitnin e më kënaqnin shpirtin. Një ditë papritur e pakujtuar babagjyshi im më gjeti mu në majë të thepave të Zaverit: ishte trembur shumë se mos rrëzohesha, prandaj më hoqi veshët keq e më këshilloi për të njëmijtën herë, që të mos rrija tjetër herë nëpër vende të tilla të rrezikshme. Unë i kërkova të falur dhe i putha dorën. Atij iu bë qejfi shumë dhe më tregoi atëhere këtë legjendë të liqenit të Prespës:

— ..Kushedi sa kohë të shkuara, ndofta njëmijë vjet më parë, gojë pas goje tregojnë se ky liqen ka qenë i tëri fushë, një fushë pjellore, që e kishin zili të gjithë. Në të bëhej dardha naa, sa një shtëmbë uji, e molla naa, sa një plloskë verë. Kishte kullota dhe hiesira për bagëti, ku hazdiseshin plot hergjelera e koperë. Përmes fushës kalonte një lumë, me të cilin njerëzit vaditnin kopshtet, grunjat, misrat dhe pinin ujë e freskoheshin. Fshatrat, si tufa bërzi-
loku, ishin shpërndarë përmes fushës dhe rrëzë maleve. Çdo fshat kishte nga një krua me dhjetë solinarë

me ujë të pastër qehlibar e të ftohtë akull. Në këto kroje mbrëmjeve e ditëve të festave mbledheshin çupat e fshatit, mbushnin ujë, kuvendonin. sa kuvendonin e ja merrnin këngës, hidhnin edhe valle! Këto këngë e ky gaz dëgjoheshin gjer në mesnatë an'ëmbanë fushës.

E sheh atë vend atje, midis Belit dhe Tumbës? Atje prifti i fshatit tonë kishte kullotat e tija. Dimër e verë një kope e madhe me dele kullosnin në ato livadhe. Prifti, — papa Llambrua, — kishte marrë, si bari, një djalë, ja, në moshën tënde, dymbëdhjetëkatërbëdhjetë vjeç. Quhej Gjokë dhe ishte nga një fshat i Shën Naumit. Emri i fshatit s'më kujtohet. Bariu ishte aq i varfër sa të këpuste shpirtin! E ëma kishte mbetur e ve me pesë fëmijë. Djaloshit, si më i madh i fëmijëve, i binte barra të ushqente të vëllezërit e të motrat. U pajtua bari te papa Llambrua. E, që thua ti, Gjoka ishte bari me nishan: nga kujdesi i tij i përditshëm t'u bënë ato dele naa! t'i çaje më dysh! Po prifti, që i kishte gjithë të mirat e që i mbushte çdo të diel e çdo të kremte hejbetë me meshë, nuk dinte se ç'ishte uria! Si shpërblim Gjokës i paguante shumë pak, medje akoma më pak i jepte bukë për të ngrënë gjatë ditës. Bariu i shkretë ja hante, ja s'hante disa thërmia buke nga ajo që i jepte urata, se pjesën më të madhe e ruante në calikun prej lëkure. Kur shkonte në fshat, në fund të dy javëve, për të ndërruar rrobat e trupit, ato copa buke ua shpinte vëllezërve e motrave. Dhe kursente pothuajse tërë bukën, se ai gjatë ditës hante më shumë pemë e barishte të ndryshme. U dobësua djali, sa erdhi e u bë cirua! Një ditë, duke luajtur ja këtu buzë Zaverit, ra në lumë caliku e shkoi e vate nën mal. I shkreti Gjokë qau, i ra kokës me grushte e u bë pikë e vrer, por meazallah se e gjeti calikun! Pas

dy ditësh erdhi koha të shkonte në fshat për t'u ndër-
rruar. Ishte pikëlluar fort, se po shkonte me duar
bosh! Të vëllezërit e tij çfarë do të hanin? Kur vajti
në shtëpi, e ëma e priti buzëgas. Ky u habit. «Ç'e
bëre, bir, calikun me bukë?» e pyeti dhe e pushtoi
Gjokën në gjirin e vet. Gjoka u step dhe e mbytën
lotët. «Mos qaj, bir i nënës, mos qaj, se ja ku ta kam
calikun!» — i tha ajo.

Vërtet ishte caliku i tij. Atë calik që e kishte
trashëguar nga i ati, i cili e mbante kur shkonte si
bari në dyert e afendikonjve, ose kur shkonte kur-
betli në Anadoll. Caliku ishte prej lëkure dashi të
regjur dhe gryka e tij ishte qenditur me retna, si ato
qendismat e grykoreve të vajzave tona sot. E ëma i
tregoi Gjokës se si i kishte rënë caliku në dorë. Dy
ditë më parë, aty pasdreke, mund të kishte pasur nja
dy hostenë ditë, ajo lante levere te burimet e Shën
Naumit. Killo-killo! — bënin ujërat e burimeve duke
u përplasur mbi shkëmbenjtë e përpara nënës dilnin
shkuma-shkuma të bardha e vërtike-vërtike, që shko-
nin pastaj tatëpjetë. Kur, papritur e pakujtuar, nëpër
shkumën e bardhë i zuri syri një gjë si ngjyrë hiri.
Në fillim pati frikë, po pastaj guxoi dhe e kapi: Ç'të
shihte? Ishte caliku i Gjokës së saj, plot me bukë.
«Shpirti i nënës, ma paske dërguar bukën me valët
e ujit! — kish menduar nëna e uritur.

Gjokës i qeshi buza. Por natën në gjumë i kishte
vajtur ai Qoftëlargu dhe i kishte pëshpëritur në vesh:
«Gjokë, Gjokë i zi, çdo të shtunë ther nga një dash
të uratës, fute mishin brenda në lëkurë e dërgoja në-
nës nëpër grykën e Zaverit me valët e lumit, që
shkon nën male. Oho, oho, sa do t'i gëzosh vëllezë-
rit e vegjël, sa do ta gëzosh nënën! Dhe ata do të
shëndoshen shpejt e shpejt, do të rriten shpejt e
shpejt! Pastaj ti do të bëhesh, zot shtëpie, i madh

e i pasur si afendikoi i fshatit! Lum ti! Bëje këtë çdo të shtunë! Mos harro! Mos mëno!»

Gjoka në fillim e humbi: ç'ishte ky zë, tamam si zë njeriu të gjallë? U habit, por edhe u gëzua, që i shtiri në vesh një gjë të tillë. Pa menduar gjatë, kur iku nga fshati i tij, i tha s'ëmës:

«Nëne, shko çdo të shtunë pasdreke te burimet e Shën Naumit, se atje do të gjesh një dhuratë!»

Atë natë Qoftëlargu i kishte vajtur edhe uratës dhe i kishte pëshpëritur në vesh:

«Uratë, uratë, jam Shëngjergji e më dërgoi Zoti të të lajmëroj se Gjoka, bariu yt, të shtunën pasdreke do të therë dashin përçor e do t'ja dërgojë s'ëmës dhe të vëllezërve me valët e lumit të Zaverit. Hap sytë, hap sytë që të mos të ta hedhë ai copë bari!»

E shtuna erdhi: Nëna përsëri vajti te burimet e Shën Naumit për të larë lëveret e fëmijëve. Nuk priti shumë, kur ç'të shihte: nëpër shkumë po përpëlitej një si dele. E kapi: vërtet ishte dele! Jo, ishte dash, një dash i majmë i rjepur e mishi futur përsëri në lëkurë të tij e lidhur mirë në grykë. Ajo u kujtua se këtë dhuratë ja dërgonte Gjoka i saj. Sikur e therri diçka në kraharor: mos e kishte vjedhur vallë nga kopeja e priftit? E kush ishte aq shpirtmirë sa t'ja falte djalit të saj një dash të tillë? Bubu, sa punë të keqe që kishte bërë i biri! Të vjedhë?! Të rrëmbejë?! Të gënjejë?! Jo, jo! Me mish të tillë nuk dinte të ushqente fëmijët e saj! Do ta ngordhte në dru Gjokën, sa t'i vinte në shtëpi! Të vinte mend e të mos bënte marrëzira të tilla! Zemra e nënës u drodh, mornica i shkuan nëpër trup dhe u hakarrit kundra të birit, që kishte filluar një rrugë aq të turpëshme, aq të ndyrë!

Duke palosur rrobat e fëmijëve të lara e të thara në diell, dëgjoi përsëri gurgullimën dhe buçimën e

ujërave, përsëri pa ato rryma ujërash të përplasen mi shkëmbinjtë, përsëri pa ato shkuma-shkuma si qumësht deleje dhe, për habi të saj, përsëri në mes vërtikut pa të përpëlitej edhe një dele tjetër. «Dy mishra më një ditë!?» dyshoi nëna e vrerosur. Me gjysmë shpirti e me hakarri të madhe e nxori delen e therur nga vërtiku i ujërave dhe e shpuri atje në lëndinë nën degët kryevarur të shelgjishteve, të cilat i dukeshin nënës, kushedi pse, si qirinj të verdhë përmbys e me flakë të shuar! Me të druajtur e me kërsëri e zgjidhi grykën e lëkurës dhe. . . O zot! Mos i bënë sytë vallë?! . . . — brenda në lëkurë gjeti Gjokën e saj të therur!

«U bubu, e zeza unë, qyqja unë!» ja dha kujës me sa fuqi që kishte e sakaq plasi mi kufomën e të birit. Klithma, e saj mori dhenë, si ciklon u ngrit lart e lart nër qiej, e që andej si rrufe, — një rrufe që s'e kishin dëgjuar kurrë këto anë — ra mi Malin e Thatë e nga barku i malit u dëgjua një ulërimë e një ngulçimë si e ndonjë kuçedre të therur, por ende me shpirt ndër dhëmbë:

«Prifti, papa Llambrua, theri birin e nënës! Mallëkimi i nënës po bie kudo! . . .»

Ç'të shikoje atëhere: njerëz e kafshë, të tronditur e të shastisur, rendnin drejt maleve për t'u fshehur diku, ndërsa papa Llambrua rendte drejt fushës me raso të grisur, me kamillafin shtrembër, me flokë të shprishur, me sy të zgurdhulluar e me krahë të shtrira tamam si Qoftëlargu. E sa vajti ai mu në mes të fushës, e sa u përmbloodhën rrëzë maleve njerëzia, — t'u dhanë piskama e gurgullima ujërash e buçima të llahtarëshme nga gryka e këtij Zaverit tonë dhe hë-hë, hë-hë brenda çastit fusha e tërë t'u bë, ja, ash-tu si e sheh edhe sot: liqen! Përmbi liqen s'u pa gjë

tjetër, veç kamillafit të zi të papa Llambros, që e shtynin valët tutje e tëhu!

Mallëkimi i nënës, bir! Mallëkimi i nënës! E s'ka gjë më të rëndë se mallëkimi i nënës! Ja këtë ma ka treguar mua dikur gjyshja ime, asaj ja pat treguar gjyshja e saj, e, brez pas brezit e gojë më gojë, kështu do të rrëfejnë këtë mallëkim! — shtoi babagjyshi duke marrë frymë thellë.

TRYEZA E LËNDËS

	Faqe
Ë Bukura e Prespës	3
Sokolesha	47
Sokol Torviolli	61
Divi i Malit të Thaçë	77
Besa dhe Bestari	110
Në Luginat e Verdha	122
Shqiponja e Vogël	136
Mallëkimi i Nënës	149

Redaktor: Adhina Mamani
 Korëktor letrar: Ali Haxhovali
 Redaktor teknik: Adem Jala

Tirana 5000 kopje Formati 19 x 100/32 Shtyp: 2004-05

Shtyp N.128. Shqipërisë - Tiranë 1988